

mediaprint

FAQJA KRYESORE
fillo këtu

RRETH NESH
profili i kompanisë

SHTËPIA BOTUESE
librat tanë

SHTYPSHKRONJA
teknologja më e fundit




www.mediaprint.al

KLIKONI KËTU

Librat e mësuesit dhe planet mësimore
për të gjithë titujt që ne disponojmë,
mund t'i gjeni dhe t'i shkarkoni
pa pagesë nga faqja e internetit
www.mediaprint.al

Për më shumë informacion
mund të na shkruani në adresën e emailit:
botime@mediaprint.al

ose të na kontaktoni pranë redaksisë
në numrin e telefonit:
042251614



Laureta Shkoza

LIBËR MËSUESI

BIOLOGJI

7

Planifikimi mësimor vjetor

Planifikimi i orëve mësimore

Teste

Projekte

Titulli: Libër mësuesi Biologjia 7

Autore: Laureta Shkoza

Drejtoi botimin: Anila Bisha

Redaktore: Elona Çali

Design: Mirela Ndrita

Kopertina: Bledar Lame

Shtëpia Botuese Mediaprint

Botimi i parë, 2019

Shtypi: Shtypshkronja Mediaprint

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara 

Të gjitha të drejtat e autorit lidhur me këtë botim janë ekskluzivisht të zotëruara/rezervuara nga Shtëpia Botuese "Mediaprint" sh.p.k..

Ndalohet çdo prodhim, riprodhim, shitje, rishitje, shpërndarje, kopjim, fotokopjim, përkthim, përshtatje, huapërdorje, shfrytëzim dhe/ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, si dhe çdo veprim cënues me çfarëdo lloj mjeti apo forme, pjesërisht dhe/ose tërësisht, pa miratimin paraprak me shkrim nga Shtëpia Botuese "Mediaprint" sh.p.k..

Ky botim, në tërësi dhe/ose në pjesë të tij, ndalohet të transmetohet dhe/ose përhapet në çdo lloj forme dhe/ose një elektronik, mekanik, regjistruesh dhe/ose tjetër, të ruhet, depozitohet ose përdoret në sisteme ku mund të cënohen të drejtat e autorit, pa miratimin paraprak me shkrim nga Shtëpia Botuese "Mediaprint" sh.p.k.. Çdo cënim i të drejtave të autorit passjell përgjegjësi sipas legjisacionit në fuqi.

Kontaktet:

www.mediaprint.al

Shtëpia Botuese

Kutia Postare 7467 - Tiranë

Cel.: 069 40 44 443

botime@mediaprint.al

Sektori i Shpërndarjes dhe Marketingut:

Cel.: 067 50 05 001

Cel.: 069 40 20 201

distributor@mediaprint.al

Shtypshkronja:

Cel.: 069 40 50 380

Cel.: 069 20 79 021

print@mediaprint.al

Komente dhe sugjerime janë të mirëpritura në email: botime@mediaprint.al

Përbajtja

Planifikimi mësimor vjetor Biologjia 7	4
Tremujori i parë (Shtator - Dhjetor)	8
Tremujori i dytë (Janar – Mars)	10
Tremujori i tretë (Prill – Qershori)	11
Planifikimi i orëve mësimore	13
Teste për secilin tremujor	91
Projekt	103

PLANI MËSIMOR VJETOR

BIOLOGJI 7

Fusha: Shkencat e natyrës

TEMATIKA: DIVERSITETI

Kompetencat që duhet të fitojë nxënësësi

Përshkrimi i tematikës: REZULTATET E TË NXËNIT TË KOMPETENCAVE SIPAS TEMATIKAVE

TEMATIKA: NDËRVEPRIMET

Përshkrimi i tematikës:

Studimi i ndërveprimit midis dhe brenda sistemeve zhvillon të kuptuarit e mjedisit dhe rolit të njeriut në të. Ndërveprimet ndodhin brenda një organizmi, midis organizmave si dhe midis organizmave dhe mjedisit. Ndërveprimi i njeriut me mjedisin drejtón zhvillimin e shkencës dhe teknologjisë. Në të njëjtën kohë shkenca dhe teknologjia ndikojnë në mënyrën se si njeriu ndërvepron me mjedisin. Të kuptuarit e këtij ndërveprimi ndihmon nxënësin të kuptojë më mirë pasojat pozitive dhe negative të veprimeve të tij dhe të jetë përgjegjës për to. Tematika fokusohet te ndërveprimi brenda dhe ndërmjet bimëve, kafshëve, njeriut dhe mjedisit, mikroorganizmave, atmosferës, Sistemit Diellor dhe Tokës, forcave, shkencës dhe teknologjisë.

Rezultatet e të nxënët Ndërveprimet e gjallesave midis tyre dhe me mjedisin

Njohuritë/konceptet	Nxënësi: Shkathësitë dhe proceset	Nxënësi: Qëndrimet dhe vlerat
Gjallesat në mjediset e tyre	<ul style="list-style-type: none">përshkruan përmes shembujve nga mjedise lokale, se si organizmat janë përshtatur për të jetuar në habitatet e tyre;vizaton dhe <u>modelon</u> zinxhirë të thjeshtë ushqimor;diskuton ndikimin pozitiv dhe negativ të njeriut në mjedis p.sh.: ndikimin në zinxhirët ushqimorë, ndotjen dhe çarjen e ozonit;Vrima e ozonit	<ul style="list-style-type: none">tregon interes për të mbledhur informacione dhe kontribuar me përgjegjshmëri në kujdesin ndaj mjedisit;<u>demonstron bashkëpunim</u> dhe <u>qëndrim etik</u> gjatë punës në grup dhe diskutimeve.ndan me të tjerët përvojat dhe njoħuritë e përfputuara nga vëzhgimet individuale;

<ul style="list-style-type: none"> Burimet e energjisë diskuton për burimet e energjisë dhe bën dallimin midis burimeve të ripërtërishme dhe jo të ripërtërishme. 	<ul style="list-style-type: none"> vlerëson burimet e ndryshme të informacionit që mbështesin kërkimin e tij/saj rrith vepriptarisë së njeriut në mjesid. 											
<p>Kjo tematikë nënizon rëndësinë e ruajtjës së shumëllojshmërisë në natyrë. Për të kuptuar më mirë botën, në fë cilën jeton, njeriu përpigjet të organizojë botën e gjallë dhe jo të gjallë. Ka disa tipare të përbashkëta që lidhin të gjitha qenjet e gjalla dhe faktorë unikë në botën jo të gjallë që e ndihmojnë njeriun t'i klasifikojë ato. Ruajtja e shumëllojshmërisë siguron mbijetësën dhe vazhdëmësinë e jetës. Në fokus të kësaj tematike në këto shkallë është diversiteti i kafshëve, bimëve, mikroorganizmave, mjesdit natyror, lëndëve dhe veteve karakteristike të tyre.</p>												
<p>Njohuritë/Konceptet</p> <ul style="list-style-type: none"> Mikroskopi Qeliza bimore (muri qelizor, membrana qelizore, citoplazma, bërtama, kloroplasti, vakuola të mëdha); Qeliza shtazore Organizimi hierarkik i jetës (nga qeliza te organizmi). 	<p>Rezultatet e të nxënësit</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Njohuritë/Konceptet</th> <th>Diversiteti dhe klasifikimi i gjallesave</th> <th>Shkakhtësitetë dhe procedurat</th> <th>Qëndrimet dhe vlerat</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Qeliza</td> <td>Nxënësi:</td> <td>Nxënësi:</td> <td>Nxënësi:</td> </tr> <tr> <td> <ul style="list-style-type: none"> Mikroskopi Qeliza bimore (muri qelizor, membrana qelizore, citoplazma, bërtama, kloroplasti, vakuola të mëdha); Qeliza shtazore Organizimi hierarkik i jetës (nga qeliza te organizmi). </td> <td> <ul style="list-style-type: none"> <u>identifikon</u> strukturat e një qelize bimore dhe shtazore ashtu siç shihen në mikroskopin me drithë ose mikroskopin elektronik; <u>krahason</u> strukturën e qelizave bimore me qelizat shtazore; <u>përdor</u> burime dyfisore për të treguar lidhjen midis strukturës së disa qelizave të zakonshme me funksionet e tyre; <u>përdor</u> preparate të gatshme për të vëzhguar shumëllojshmërinë e qelizave me funksione të ndryshme; <u>tregon</u> se qelizat mund të grupohen për të formuar indet, organet dhe organizmat. </td> <td> <ul style="list-style-type: none"> <u>tregon</u> kuriozitet, kur eksploron botën mikroskopike dhe bën pyjetë rrith asaj që gjen; <u>vlerëson</u> përpjekjet individuale dhe punën në grup duke respektuar perspektiva të ndryshme. </td> </tr> </tbody> </table>	Njohuritë/Konceptet	Diversiteti dhe klasifikimi i gjallesave	Shkakhtësitetë dhe procedurat	Qëndrimet dhe vlerat	Qeliza	Nxënësi:	Nxënësi:	Nxënësi:	<ul style="list-style-type: none"> Mikroskopi Qeliza bimore (muri qelizor, membrana qelizore, citoplazma, bërtama, kloroplasti, vakuola të mëdha); Qeliza shtazore Organizimi hierarkik i jetës (nga qeliza te organizmi). 	<ul style="list-style-type: none"> <u>identifikon</u> strukturat e një qelize bimore dhe shtazore ashtu siç shihen në mikroskopin me drithë ose mikroskopin elektronik; <u>krahason</u> strukturën e qelizave bimore me qelizat shtazore; <u>përdor</u> burime dyfisore për të treguar lidhjen midis strukturës së disa qelizave të zakonshme me funksionet e tyre; <u>përdor</u> preparate të gatshme për të vëzhguar shumëllojshmërinë e qelizave me funksione të ndryshme; <u>tregon</u> se qelizat mund të grupohen për të formuar indet, organet dhe organizmat. 	<ul style="list-style-type: none"> <u>tregon</u> kuriozitet, kur eksploron botën mikroskopike dhe bën pyjetë rrith asaj që gjen; <u>vlerëson</u> përpjekjet individuale dhe punën në grup duke respektuar perspektiva të ndryshme.
Njohuritë/Konceptet	Diversiteti dhe klasifikimi i gjallesave	Shkakhtësitetë dhe procedurat	Qëndrimet dhe vlerat									
Qeliza	Nxënësi:	Nxënësi:	Nxënësi:									
<ul style="list-style-type: none"> Mikroskopi Qeliza bimore (muri qelizor, membrana qelizore, citoplazma, bërtama, kloroplasti, vakuola të mëdha); Qeliza shtazore Organizimi hierarkik i jetës (nga qeliza te organizmi). 	<ul style="list-style-type: none"> <u>identifikon</u> strukturat e një qelize bimore dhe shtazore ashtu siç shihen në mikroskopin me drithë ose mikroskopin elektronik; <u>krahason</u> strukturën e qelizave bimore me qelizat shtazore; <u>përdor</u> burime dyfisore për të treguar lidhjen midis strukturës së disa qelizave të zakonshme me funksionet e tyre; <u>përdor</u> preparate të gatshme për të vëzhguar shumëllojshmërinë e qelizave me funksione të ndryshme; <u>tregon</u> se qelizat mund të grupohen për të formuar indet, organet dhe organizmat. 	<ul style="list-style-type: none"> <u>tregon</u> kuriozitet, kur eksploron botën mikroskopike dhe bën pyjetë rrith asaj që gjen; <u>vlerëson</u> përpjekjet individuale dhe punën në grup duke respektuar perspektiva të ndryshme. 										

<p>Mikroorganizmat</p> <ul style="list-style-type: none"> Llojet e mikroorganizmave, roli i tyre në natyrë Rëndësia e mikroorganizmave për njeriun 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <u>identifikon</u> shtatë karakteristikat e qënieve të gjalla dhe i lidh ato me një numër të madh organizmash në mëdise lokale dhe më gjérë; <u>pëershkuaran</u> rolin e mikroorganizmave në zërthimin e lëndës organike, prodhimin e ushqimit dhe sëmundjeve përfshirë punën e Luiz Paster; planifikon një hetim duke përdorur njohuritë shkencore për mikroorganizmat. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <u>ylerëson</u> rëndësinë e mikroorganizmave për shëndetin dhe mirëqëni e njeriut. <u>tregon interes</u> dhe <u>përgjegjishmëri</u> për tu mbrojtur nga infekzionet e shkaktuar nga mikroorganizmat.
<p>Klasifikimi i bimëve dhe kafshëve</p> <ul style="list-style-type: none"> Specia, varacioni brenda species Klasifikimi i bimëve <ul style="list-style-type: none"> a) bimë pa lule b) bimë me lule Klasifikimi i kafshëve <ul style="list-style-type: none"> a) vertebrorët, grupet e vertebrorëve b) invertebrorët, grupet e invertebrorëve 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <u>përkufizzon</u> specien; <u>heton</u> ndryshimet brenda një specie duke përdorur burime dytësore; <u>paraqet</u> shembuj të ndryshimeve për një karakteristikë të caktuar, në një grup organizmash, duke përdorur diagramën e shpeshtësisë; <u>klasifikon</u> kafshët dhe bimët në grupe të mëdha duke përdorur disa shembuj nga mëdise lokale. 	

TEMATIKA: SISTEMET

<p>Përshtimi i tematikës: Një sistem përfaqëson një tërësi pjesësh të cilat punojnë së bashku për të kryer një funksion të caktuar. Ka sisteme në natyrë, si dhe sisteme të ndërtuara nga njeriu. Shembuj të sistemeve në natyrë janë sistemet e trupit të njeriut. Shembuj të sistemeve të ndërtuara nga njeriu janë sistemet elektrike. Njohja e sistemeve e lejon njeriun të kuptojë si funksionon secila pjesë e sistemit dhe si ndërvaprojnjë me njëra-tjetërën për të kryer një funksion të caktuar.</p> <p>Kjo temë përqendrohet tek studimi i sistemit të bimëve dhe kafshëve, sistemeve të trupave qellorë, sistemeve të matjës.</p>	
<p align="center">Rezultatet e të nxënësit</p> <p align="center">Sistemet te bimët dhe te njeriu</p>	<p align="center">Njohuritë/Konceptet</p>
<p align="center">Bimët</p> <ul style="list-style-type: none"> • Organet e bimëve me lule • Funkcionet e organeve kryesore të bimëve me lule <p align="center">Sistemet e trupit të njeriut</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sistemi muskular- skeletik <ul style="list-style-type: none"> a) skeleti, funksionet dhe pjesët kryesore të tij; b) muskujt, funksioni i muskujve antagonist; c) artikulacionet e lëvizshme dhe të palëvizzhme. 	<p align="center">Shkakthësiti dhe proceset</p> <p align="center">Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>dallon</u> vendosjen dhe tregon funksionet e organeve kryesore të bimëve me lule p.sh.: rrënjes, kërcellit, gjethes; <u>zbaton</u> proceduriën e përgatitjes së një herbari. <p align="center">Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>ekspoloron</u> rolin e skeletit dhe të nyjeve si dhe parimin e muskujve antagonist; • <u>dallon</u> vendosjen dhe tregon funksionet e sistemeve kryesore të trupit të njeriut; • <u>burime</u> dytësore për të diskutuan rrëth përdor <u>burime</u> dytësore për të trupit të njeriut; • <u>mbledh</u> dhe <u>përdor</u> të dhëna për të testuar një parashikim ose kryer një eksperiment; • përdor rezultatet për të formular konkluzionet e një eksperimenti ose për të bërë parashikime të mëtejshme; • përdor tabela ose <u>diagrama</u> për të sugjeruar ide ose paraqitur rezultate; • <u>kryen</u> <u>kërkime</u> për punën studimore që bëjnë shkencëtarë të ndryshëm për trupin e njeriut.

PLANIFIKIMI MËSIMOR VJETOR

TEMATIKA		SHËRNDARJA E PËRMBAJTJES SË LËNDËS		
		Shtator – Dhjetor 13 javë (24 orë)	Janar – Mars 11 javë (22 orë)	Prill – Qershori 11 javë (22 orë)
Plani vjetor i ndarë në tremujore Tremujori i parë (Shtator – Dhjetor)				
Kreu 1 Sistemet te bimetë dhe njeriu (7 javë – 14 orë)				
Nr	Tema mësimore	Situata e të nxënësit	Metodologja dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi
Sistemet				
1	1. Organet bimore 2. Organet bimore	Nxënësitet dallojnë: - vendosjen dhe tregojnë funktionet e organeve kryesore të bimëve me lule	Për të realizuar temat mund të zgjidhni një ose disa nga: Metoda e të nxënëtit aktiv: - Diskutime në grup - Sfidë individuale - konkurse me grupe - Veprimtari në çift	Për të realizuar vlerësimin në tema të ndryshme mund të zgjidhni një ose disa nga: Vlerësimi i vazhduar për: - Shumëlojshmërinë e përgjigjeve, përfshire vizatimet, punimet e shkruara, bisedat me njëritjetrin dhe paraqitjen e ideve - Plotësimin e fjalive në flotoren e punës dhe fletët e punës për të gjitha temat
2	3. Sistemet e organeve të njeriut 4. Sistemet e organeve të njeriut	- dallojnë vendosjen dhe tregojnë funksionet e organeve kryesore të trupit të njeriut.	- Kërkim në internet - eksploroni rolin e skeletit dhe në nyjeve - dallon vendndodhjen dhe tregon funksionet	- Vizatim Prezantime - Diskutim i rubrikave - Vizitë në terren
3	5. Skeleti i njeriut 6. Skeleti i njeriut			
4	7. Kyçet e kockave (artikulacionet) 8. Kyçet e kockave (artikulacionet)			
5	9. Muskujt, ndërtimi dhe funksioni i tyre			

	10. Muskujt, ndërtimi dhe funksioni i tyre	e organeve kryesore të trupit të njeriut.	- Trajtim i të dhënave me grafikë ose me tabelat mbledh dhe përdor të dhënët për të testuar një parashikim.	- Plotësimin e përgjigjeve në pyetjet dhe detyrat për qdo temë mësimore si dhe kryerja e veprimitarive në librin e nxënësit, tekstin mësimor	- Plotësimin e përgjigjeve në mënyrën se si mund të kryhen veprimitaritë sipas temave përkatëse të librit të nxënësit.
6	11. Studimi i trupit të njeriut				
7	12. Studimi i trupit të njeriut				
13. Di dhe praktikoj	14. Di dhe praktikoj				
Diversiteti					
Kreu 2 Qelizat dhe organizmat (6 javë – 10 orë)					
8	1. Vecoritë e qenieve të gjallë	Nxërësit identifikojnë:	Zgjidhje e kërkuesave në fletët e punës dhe fletoren e punës sipas temave përkatëse	Vetëvlerësimi	Kujdes duhet të tregohet për t'u përqendruar tek zhvillimi i temave mësimore pasardhëse
9	2. Vecoritë e qenieve të gjallë	- karakteristikat e qenieve të gjallë dhei i lidhin ato me një nr. Të madh organizmash në mëdise.	Regjistrome video dhe audio	Realizohet nga nxënësit për:	
	3. Mikroorganizmat dhe klasifikimi i tyre	- Përshtkuajnë rolin e mikroorganizmave në zërthimin e lëndës organike, prodhimin e ushqimit dhe sëmundjeve, përfshirë purjen e Luis Paster	Veprimitari në librin e nxënësit, të cilat janë në çdo temë mësimi	- Vlerësimin e punës rëndësishme nga njëri tjetri	
10	4. Mikroorganizmat dhe klasifikimi i tyre	- Planifikon një hetim duke përdorur njohuritë përmes mikroorganizmat	Veprimitari hulumtuese	- Prezantimi me gojë ose me shkrim i punimeve të bëra nga nxënësit	Pas çdo kapitulli gjenden fletët e punës të cilat mund të jepen si detyrë në fund të mësimit për të kontrolluar të nxënësit e nxënësve.
	5. Mikroorganizmat dhe Shpërberja	6. Mikroorganizmat dhe Shpërberja	- Diskutim	- Vlerësim përmblledhës për:	
	7. Mikroorganizmat dhe ushqimi		Pyetje- përgjigje	- Detyrë me shkrim ose me gojë	
11	8. Mikroorganizmat dhe ushqimi			- punë kërkimore në internet	
	9. Mikroorganizmat dhe sëmundjet				
12	10. Mikroorganizmat dhe sëmundjet				
13	1. Projekt				
	1. Test				

Tremujori i dytë (Janar – Mars)

Nr	Tema mësimore	Situata e të nxënësit	Metodologja dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burime/mjete
Kreu 2 Qelizat dhe organizmat (4 javë – 8 orë)					
14	11. Qeliza bimore 12. Qeliza bimore	Nxënësít identifikojnë strukturat e një qelize bimore	Për të realizuar temat mund të zgjidhni një ose disa nga: Metoda e të nxënënit aktiv: - Diskutime në grup - Sfidë individuale - konkurse me grupe - Veprimitari në qift - Veprimitari matëse	Për të realizuar vlerësimin në tema të ndryshme mund të zgjidhni një ose disa nga: Vlerësimi i vazhduar për: – Shumëellojshmërinë e përgjigjeve, përfishirë vizatimet, punimet e shkruara, bisedat me njëritjetrin dhe paraqiten e ideve	Tek libri i mësuesit gjenden të pëershkuara në mënyrë të hollësishme mijetet ndihmëse për realizimin e temave mësimore.
15	13. Qeliza shtazore 14. Qeliza shtazore	identifikojnë strukturat e një qelize shtazore krahasojnë strukturat e qelizeve bimore me ato shtazore.			
16	15. Qelizat, indet dhe organet 16. Qelizat, indet dhe organet	Tregojnë se qelizat mund të grupohen për të formuar inde organe.			
17	17. Di dhe praktikoj 18. Di dhe praktikoj				
Diversiteti					
18	1. Përshtatja e organizmave të gjalla 2. Përshtatja e organizmave të gjalla	Nxënësít përshtkuaran përmes shembujve nga mëdise lokale se si organizmat janë përshtatur për të jetuar në habitatet e tyre.	Kërkim në internet – Vizatim Prezantime	- Plotësimin e fjalive në fletoren e punës dhe fletët e punës për të gjitha temat	Po aty gjenden dhe idetë përmësimdhënien si dhe udhëzimet kryesore përmënyrën se si mund të kryhen veprimitarië sipas temave përkatëse të librit të nxënësit.
19	3. Zinxhirët ushqimore		Diskutim i rubrikave	- Plotësimin e përgjigjeve në pyetjet dhe detyrat për çdo temë mësimore si dhe kryerja e veprimitarive në librin e nxënësit, tekstin mësimor	
20	4. Zinxhirët ushqimore 5. Njerëzit dhe zinxhirët ushqimore	Vizatot dhe modelon zinxhirë të thjeshtë ushqimor.	- Vizitë në terren – Trajtim i të dhënave me grafikë ose me tabelë – Zgjidhje e kërkuesave në fletet e punës dhe	- Trajtim i të dhënave me grafikë ose me tabelë – Zgjidhje e kërkuesave në fletet e punës dhe	
Kreu 3 Mjedisi ku jetojnë gjallesat (7 javë – 14 orë)					
18					
19					
20					

	6. Njerëzit dhe zinxhirët ushqimore	Diskuton veprimin negativ të njeriut në mjeshtë:	fletoren e punës sipas temave përkatëse	Vetëvlerësimi
21	7. Ndotja 8. Ndotja	p.sh. ndikimin : në zinxhirët ushqimore në ndotjen dhe në çarjen e Ozonit.	- Regjistrome video dhe audio	Realizohet nga nxënësit për: – Vlerësimin në çift – Vlerësimin e punës në grup
22	9. Pakësimi i ozonit 10. Pakësimi i ozonit	Diskuton për burimet e energjisë dhe bën dallimin mes burimeve të ripërtëritshme dhe jo.	Veprimitari në librin e nxënësit, të cilat janë në qdo temë mësimi	- Vlerësimin e detyrave të shtëpisë nga njëri tjetri – Prezantimi me gojë ose me shkrim i punimeve të bëra nga nxënësit
23	11. Ruajtja (konservimi) 12. Ruajtja (konservimi)		- Veprimitari me shkrim hulumtuese	Vlerësim përmbledhës për: Detyrë me shkrim ose me gojë punë kërkimore në internet
24	3. Di dhe praktikoj 2. Test		- Diskutim – Pyetje- përgjigje	

Tremujori i tretë (Prill – Qershori)

Nr	Tema mësimore	Situata e të nxënësit	Metodologjia dhe veprimitarë e nxënësve	Vlerësimi	Burime/mjetë
Kreu 3 Mjedisi ku jetojnë gjallesat (1 javë – 2 orë)					
25	13. Burimet e energjisë 14. Burimet e energjisë	Diskuton bën dallimin mes burimeve të ripërtëritshme dhe jo.			
Diversiteti					
Kreu 4 Llojshmëria dhe klasifikimi i bimëve (10 javë - 20 orë)					
26	1. Çfarë është lloji? 2. Çfarë është lloji?				Tek libri i mësuesit gjenden

		Për të realizuar vlerësimin në tema të ndryshme mund të zgjidhni një ose disa nga: Metoda e të nxënësit aktiv: - Diskutime në grup - Sfida individuale - Konkurse me grupe - Veprimitari në çift - Veprimitari matëse	Për të realizuar vlerësimin në tema të zgjidhni një ose disa nga: Vlerësimi i vazduar për: - Shumëlojshmërinë e përgjigjeve, përfshirë vizatimet, punimet e shkrara, bisedat me njëri-tjetrin dhe paraqitjen e ideve
27	3. Llojet dhe llojshmëria e tyre 4. Llojet dhe llojshmëria e tyre	Nxënësit përkufizojnë specien. Hetojnë ndryshimet brenda një specie duke përdorur burime dytësore.	- Plotësimin e fjalive në fletoren e punës dhe fletët e punës për të gjitha temat Plotësimin e përgjigjeve në pyetjet dhe detyrat për çdo temë mësimore si dhe kryerja e veprimitarive në librin e nxënësit, tekstin mësimor
28	5. Kërkime për llojshmërinë 6. Kërkime për llojshmërinë	Paraqesin shembuj të ndryshëm për një karakteristikë të caktuar	- Prezantime - Diskutim i rubrikave - Vizitë në terren - Trajtim i të dhënave me grafikë ose me tabelat - Zgjidhje e kërkuesave në fletët e punës dhe fletoren e punës sipas temave përkatëse
29	7. Klasifikimi i bimëve 8. Klasifikimi i bimëve	Hetojnë ndryshimet brenda një specie duke përdorur burime dytësore.	- Regjistrome video dhe audio - Veprimitari në librin e nxënësit, të cilat janë në çdo temë mësimi - Veprimitari hulumtuese
30	9. Klasifikimi i rruazorëve (vertebrorve) 10. Klasifikimi i rruazorëve (vertebrorve)	Karakteristikë të caktuar në një grup organizmash duke përdorur diagramin e shpeshësisë	- Veprimitimi me gojë ose me shkrim i punimeve të bëra nga nxënësit - Vlerësimi përmblledhës për: - Vlerësimin në çift - Vlerësimin e punës në grup
31	11. Klasifikimi i jorr uazorëve 12. Klasifikimi i jorr uazorëve	Klasifikojnë kafshët dhe bimët në grupe të mëdha duke përdorur disa shembuj nga mijediset lokale	- Vlerësimi përmblledhës për: - Detyrë me shkrim ose me gojë - punë kërkimore në internet
32	13. Di dhe praktikoj 14. Di dhe praktikoj		
33	15. Ekskursion 16. Ekskursion		
34	17. Album 18. Herbarium		
35	19. Projekt 20. Test		

Situata e të nxënит nr. 1

Tematika: Sistemet

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: 1-Organet bimore 2-Organet bimore			
Situata e të nxënит: Rëndësia e bimëve për jetën e gjallesave			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçë			
<p>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Nxënësi shpreh me fjalë mendimin e tij për ndërtimin bimëve.</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Nxënësi analizon, në mënyrë të pavarur, informacionet e marra nga burimet e ndryshme për ndërtimin e bimëve dhe vlerëson rëndësinë e tyre për jetën e njeriut.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Identifikon dhe krahason informacionet e njohura me ato të panjohura për organet bimore dhe përdor teknika të ndryshme për zgjidhjen e problemit.</p> <p>Kompetenca personale: Merr pjesë ose udhëheq një grup pune, bashkëpunon me shokët që kanë nevojë gjatë orës së mësimit dhe raporton me gojë ose me shkrim zgjidhjen e situatës së dhënë.</p>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> Evidenton organet kryesore të bimës; Përshkruan ndërtimin e bimës; Tregon funksionet e organeve bimore; Dallon midis koncepteve organe bimore dhe organizëm; Argumenton rëndësinë e bimëve për jetën e gjallesave në planetin Tokë. 		Fjalët kyçë: Bimë, klorofil, organe; rrënje, kërcell, gjethë, lule	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: <p>Gjuha dhe komunikimi: Ndihmon nxënësit për zhvillimin e kompetencës së komunikimit duke përdorur gjuhën dhe terminologjinë e shkencës.</p> <p>Teknologjia dhe TIK: Nxënësi përdor sistemet e duhura kompjuterike përgatitjen e prezantimeve të detyrate duke zbatuar në mënyrë krijuese njohuritë që përbajnjë shkencat kompjuterike për ndërtimin e tabelave dhe përgatitjen e detyrate të ndryshme gjatë orës së biologjisë.</p> <p>Arti pamor: Nxënësi, duke shfrytëzuar programet e arteve pamore bëhet një njohës më i mirë i ndërtimit të bimëve dhe organeve përbërëse në hapësirë dhe në plan.</p>		Burimet: Libri i nxënësit, fletore pune, enë me bimë të ndryshme, figura dhe pamje me bimë të rralla, enciklopedi ose revista shkencore	

Metodologja dhe veprimtaritë e nxënësve

Stuhi mendimesh

Punë në dyshe/grupe

Bashkëbisedim

Tabela e koncepteve

Harta e koncepteve

Përshkrimi kontekstual i situatës

Bimët e gjelbra përbajnë pigmentin klorofil. Ky pigment u jep ngjyrën e gjelbër bimëve dhe përthith energjinë e rrezeve të diellit që nevojitet për përgatitjen e ushqimit nga bimët.

Gjithashtu bimët prodhojnë oksigjenin e ajrit që e thihin gjallesat gjatë procesit të frymëmarrjes.

Po si munden bimët të kryejnë këto procese? Si janë ndërtuar bimët? Cila është rëndësia e tyre për jetën e gjallesave në planetin Tokë?

Veprimet e kryera për trajtimin e situatës


1-Parashikimi i njohurive - Stuhi mendimesh

Mësuesi nxit nxënësit të lidhin njohuritë që kanë për bimët me njohuritë e reja. Drejton pyetje që nxënësit shprehin mendimet e tyre për ndërtimin e bimëve dhe rëndësinë e tyre për gjallesat. Mësuesi ndan klasën në grupe:

Grupi i parë, udhëzohet të vëzhgojnë bimët e mbjella në enë të ndryshme.



Grupit të dytë i jepen disa pamje me bimë të rralla si bimët mishngrënëse.



Grupit të tretë i jepen pamje me bimë të ndjeshme ndaj prekjes apo dritës si lulja mos më prek, lulja e diellit, e mimozës etj.



Mësuesi u drejton nxënësve pyetjet: Çfarë vëreni nga këto pamje? Çfarë cilësish të përbashkëta kanë bimët? A dallojnë ato nga njëra-tjetra?

Mësuesi dëgjon mendimet e nxënësve dhe përbledh njohuritë kryesore në tabelë.

2-Ndërtimi i njohurive - Tabela e koncepteve


a. Punë në dyshe

Mësuesi udhëzon nxënësit të lexojnë tekstin me kujdes që t`a kuptojnë atë dhe të përshkruajnë funksionet përkatëse për organet bimore:

Konceptet kyçë	Shpjegime përkatëse për konceptet
1. Bimë	1. Bimë është çdo gjallesë që e përgatit vet ushqimin.
2. Organe	2. Pjesët e një organizmi quhen organe.
3. Rrënje	3. Rrënja: <ul style="list-style-type: none"> • është organi që e fikson bimën në tokë; • thith ujin dhe kripërat minerale të cilat i nevojiten bimës për të prodhuar ushqimin.
4. Kërcell	4. Kërcelli: <ul style="list-style-type: none"> • është organi bimor që transporton ushqimet dhe ujin; • mban gjethet dhe lulet;
5. Gjethet	5. Gjethet - janë organet ku përgatiten ushqimet e bimëve.
6. Lule	6. Lulja - është organi riprodhues i bimëve.

3-Përforcimi i njohurive: Harta e koncepteve

Nxënësi plotëson hartën e koncepteve, për ndërtimin e bimëve dhe shpjegon funksionet e organeve bimore.



Vlerësimi i situatës:

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi:

- Përshkruan ndërtimin e bimës;
- Shpjegon funksionet e organeve bimore;
- Dallon konceptet organ dhe organizëm;

Vlerësimi i nxënësit:**Nxënësi vlerësohet:**

- për shpjegimin e saktë të koncepteve organ, organizëm, bimë, rrënje, gjethë, kërcell, lule;
- për bashkëpunim dhe qëndrim etik gjatë punës në grup dhe gjatë diskutimeve.

Detyrat dhe puna e pavarur:**Detyrë klase:**

Nxënësi punon në fletë pune ushtrimin 1 dhe 2, faqe 10 -11.

Detyrë shtëpie:

Mësuesi udhëzon nxënësit të punojnë të pavarur për grumbullimin dhe tharjen e disa bimëve.

Kjo veprimtari nxit nxënësit që të njohin nga afër llojet e bimëve. Nxënësit duhet t'i thajnë me kujdes bimët duke i vendosur ndërmjet fletëve të gazetave dhe në një mjedis me errësirë. Mbi bimët nxënësit duhet të vendosin një peshë për ta shtypur gjethen që të hapet sa më mirë.

Me koleksionet e bimëve të thara nxënësit përgatitin herbare.

Situata e të nxënëtit nr. 2**Tematika: Sistemet**

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: 1-Sistemet e organeve te njeriu 2-Sistemet e organeve te njeriu			
Situata e të nxënëtit			
Lidhja midis sistemeve të organeve			
Rezultatet e të nxënëtit sipas kompetencave kyçë			
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Nxënësi shpreh mendimin e tij në lidhje me sistemet e organeve te njeriu duke përdorur terminologji shkencore të pasur. Kompetenca e të menduarit Nxënësi analizon, në mënyrë të pavarur, informacionet e marra nga libri i nxënësit dhe nga fletorja e punës në lidhje me ndërtimin e sistemeve të organeve dhe arsyeton qartë për ndërtimin e tyre. Kompetenca e të nxënëtit: Nxënësi parashtron pyetje për funksionet që kryejnë sistemet e organeve te njeriu dhe jep përgjigje të argumentuara. Kompetenca personale: Nxënësi demonstron vetëbesim dhe shkathtësi personale e ndërpersonale në orën e mësimit, komunikon lirshëm me shokët dhe shpreh mendimin e tij.			
Rezultatet e të nxënëtit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • Dallon konceptet organë nga sistem organesh; • Përshkruan funksionet e sistemit të tretjes dhe të qarkullimit të gjakut; • Sqaron lidhjen që ekziston midis sistemit të tretjes dhe qarkullimit 		Fjalët kyçë: Organe, sisteme organesh, sistemi i tretjes, sistemi i qarkullimit të gjakut, sistemi nervor, sistemi i	

<p>të gjakut;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon funksionet e sistemit nervor; • Argumenton rëndësinë e sistemit të frysëmarrjes për organizmin e njeriut; • Analizon ndërtimin dhe funksionet e sistemeve të organeve. 	<p>frysëmëkbimit, tretje, gjaku, enë gjaku, nerva, organet e shqisave, frysëmëkbim</p>
<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Gjuha dhe komunikimi: Mundëson komunikimin midis nxënësve gjatë diskutimit dhe përshkrimit të koncepteve mbi ndërtimin dhe funksionin e sistemeve të organeve te njeriu duke përdorur një terminologji të pasur shkencore.</p> <p>Teknologjia dhe TIK: Nxënësi përdor sistemet e duhura kompjuterike përgatitjen e prezantimeve të detyrate duke zbatuar në mënyrë krijuese njojuritë që përbajnjë shkencat kompjuterike dhe mediat digitale për ndërtimin e tabelave dhe përgatitjen e detyrate të ndryshme.</p> <p>Arti pamor: Nxënësi, duke shfrytëzuar programet e arteve pamore bëhet një njoħes më i mirë i ndërtimit të sistemeve të organeve dhe organeve përbërëse në hapësirë dhe në plan.</p>	<p>Burimet:</p> <p>Teksti mësimor, mjete shkrimi /fletë kartoni, tabela dhe organe tredimensionale, video-projektor/kompjuter dhe mundësi të përdorimit të internetit</p>

Metodologja dhe veprimtaritë e nxënësve	
Alfabeti i njëpasnjëshëm	Tabela e koncepteve
Veprimitari praktike	Diskutim i drejtuar
Përshkrimi kontekstual i situatës	
Çdo ditë me dietën ushqimore marrim një sasi të konsiderueshme ushqimesh. Si ndërveprojnë sistemet e organeve që ky ushqim të arrijë në qeliza dhe të shërbejë si burim energjie për veprimtaritë që ato kryejnë?	

Veprimet e kryera për trajtimin e situatës					
1-Parashikimi i njoħurive, Alfabeti i njëpasnjëshëm					
Mësuesi i jep secilit nxënës një kopje të alfabetit të njëpasnjëshëm të paplotësuar; Kérkohet nga nxënësit të shkruajnë një koncept që ka lidhje me informacionin e trajtuar në temën: Sistemet e organeve të njeriut, sipas shkronjave të alfabetit;					
Pasi secili nxënës plotëson fletën e tij me alfabetin e njëpasnjëshëm, shkëmben fletën me shokun që ka pranë dhe ky veprim përsëritet disa herë me radhë.					

A Arterie	B Brinjët Bronket Bimët	C	Ç	D Dioksid karboni Diafragma	Dh Dhëmbët Dhëmballët
E Enë gjaku Energi	Ë	F Frysëmëkbim Frysënxjerrje Funksion- (i sistemeve të organeve)	G Goja Gyp I gjatë (i tretjes)	Gj Gjaku	H

I	J	K Kafshët	L	L1	M Mëlçia Mushkëri
N Nervat Ndërtim- (i sistemeve të organeve)	Nj Njeriu	O Organe Oksigjen	P Palca kurrizore Pjesëzat e tretura Përthithje	Q Qelizat e trupit	R Rektumi
Rr	S Syri Stomaku Sisteme organesh	Sh Shqisat	T Tretje Truri Trakeja	Th	U Ushqim
V Venat	X	Xh	Y	Z Zemra Zorra e hollë	Zh

2-Ndërtimi i njohurive/ Veprimitari praktike/ Tabela e koncepteve

Mësuesi ndan nxënësit në 4 grupe dhe ndan detyrat:

Grupet e nxënësve lexojnë materialin e trajtuar në këtë temë dhe prezantojnë njohuritë në mënyra të ndryshme:

Mësuesi udhëzon nxënësit:

Skiconi trupin e njeriut në një fletë të madhe kartoni. Secili nxënës në grupin përkatës vizaton organet e trupit të njeriut dhe në fund i vendosin ato në vendin e duhur në figurë.

Grupi i parë

Prezanton informacionin dhe përqendrohet në çështjet:

- Ndërtimi i sistemit të tretjes;
- Çfarë ndodh me ushqimin në sistemin e tretjes?
- Çfarë quajmë tretje?
- Çfarë ndodh me pjesëzat e tretura të ushqimit?

Grupi i dytë

Prezanton informacionin dhe përqendrohet në çështjet:

- Ndërtimin i sistemit të qarkullimit të gjakut;
- Funksionin e sistemit të qarkullimit të gjakut;
- Funksionin e zemrës;

Grupi i tretë

Prezanton informacionin dhe përqendrohet në temat:

- Ndërtimi i sistemit nervor;
- Si transmetohen sinjalët që nisen nga truri në pjesët e ndryshme të trupit;

Grupi i katërt

- Ndërtimin i sistemit të frysëkëmbimit;
- Funksionin e sistemit të frysëkëmbimit;

- Dallimin midis frysnekembimit dhe frysneñxjerrjes;

Nxenesisit plotesojnë tabelen dhe jalin shpjegimet përkatëse:

1. për ndërtimin dhe funksionet e sistemeve të organeve;
2. për lidhjen midis sistemeve të organeve;

Konceptet e trajtura	Krahasimet përkatëse
1. Sistemi tretës	1. Zbërthen ushqimet. Pjesëzat e tretura kalojnë në gjak.
2. Sistemi i qarkullimit të gjakut	2. Transporton lëndët në të gjithë trupin e njeriut
3. Sistemi nervor	3. Mundëson komunikimin e pjesëve të trupit midis tyre
4. Sistemi i frysnekembimit	4. Mundëson furnizimin e trupit me oksigjen dhe nxjerrjen jashtë të trupit të dioksidit të karbonit

Mësuesi drejton pyetjet për të krahasuar konceptet që jepen në tabelë dhe nxenesisit gjejnë të përbashkëtat dhe dallimet midis tyre:

3-Përforcimi i njohurive/ Diskutim i drejtuar

Nxenesi:

- Përforcion njohuritë dhe përshkruan ndërtimin e sistemeve të organeve;
- Analizon lidhjen midis sistemeve të organeve;
- Shpjegon se si ushqimi tretet në sistemin e tretjes, pjesëzat e tretura transportohen me anë të eneve të gjakut në qelizat e trupit dhe furnizojnë me energji qelizat të cilat thihin oksigjen dhe nxjerrin dioksid karboni gjatë frysneñxjerrjes.

Vlerësimi i nxenesisit

Nxenesi vlerësohet:

- për përdorimin e fjalorit të saktë shkencor gjatë orës së mësimit;
- për saktësinë me të cilën përshkruan ndërtimin dhe funksionet e sistemeve të organeve;
- për bashkëpunim dhe qëndrim etik gjatë punës në grup dhe gjatë diskutimeve.

Detyrat dhe puna e pavarur

Detyrë klase

Nxenesisit punojet ushtrimin 1, 2 faqe 12, në fletoren e punës.

Detyrë shtëpie:

Kërko informacion dhe fakte interesante për një organ të caktuar të trupit të njeriut dhe për ndërtimin dhe funksionin e tij si dhe sëmundjet nga të cilat preken këto organe.

Situata e të nxënxit nr. 3

Tematika: Sistemet

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla:III	Klasa:VII
Tema mësimore: 1-Sistemet e organeve te njeriu-ushtrime 2-Sistemet e organeve te njeriu-ushtrime			
Situata e të nxënxit:			
Ushtrime (Fletë Pune-faqe 12); Fletë pune –Libri i mësuesit –faqe-13/15			
Rezultatet e të nxënxit sipas kompetencave kyçë			
<p>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Nxënësi shpreh mendimin e tij për ndërtimin e sistemeve të organeve si dhe funksionet që ato kryejnë duke përdorur terminologjinë e duhur shkencore.</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Nxënësi analizon, në mënyrë të pavarur, informacionet e marra nga burimet e ndryshme për sistemet e organeve dhe vlerëson rëndësinë që duhet të tregohet për shëndetin e tyre.</p> <p>Kompetenca e të nxënxit: Nxënësi parashtron pyetje në lidhje me sistemet e organeve, organet e tyre, ndërtimin dhe shfaq mendime të strukturuara për dhënien e përgjigjeve të sakta.</p> <p>Kompetenca personale: Nxënësi demonstron vetëbesim dhe shkaktësi personale e ndërpersonele në orën e mësimit, komunikon me shokët dhe punon me kujdes gjatë veprimitarisë praktike në përgatitjen e sistemeve të organeve.</p>			
Rezultatet e të nxënxit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • Liston sistemet e organeve që ndërtojnë trupin e njeriut; • Analizon ndërtimin e sistemeve të organeve; • Evidenton organet përbërëse të sistemeve të organeve; • Shpjegon funksionet që kryen çdo sistem organesh në trupin e njeriut. 		Fjalët kyçë: Sisteme organesh; sistemi i fryshtës; sistemi nervor; sistemi i qarkullimit; sistemi tretës	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi: Aftëson nxënësit në përdorimin terminologjisë së fushave të shkencës gjatë diskutimit për ndërtimin dhe funksionet e sistemeve të organeve. Teknologjia dhe TIK: Nxënësi përdor sistemet e duhura kompjuterike për përgatitjen e prezantimeve të detyrate duke zbatuar në mënyrë krijuuese njohuritë që përbajnjë shkencat kompjuterike për ndërtimin e tabelave dhe përgatitjen e detyrate gjatë orës së biologjisë. Arti pamor: Nxënësi, duke shfrytëzuar programet e arteve pamore bëhet një njohës më i mirë i ndërtimit të sistemeve të organeve dhe organeve përbërëse në hapësirë dhe në plan.		Burimet: Libri i nxënësit, fletore pune, mjete shkrimi, lapsa me ngjyra, gëershëre	
Metodologja dhe veprimitaritë e nxënësve			
Shkrim i lirë Ushtrime		Tabela e koncepteve Organizues grafik i koncepteve	

Veprimet e kryera për trajtimin e situatës

1-Parashikimi i njohurive-Shkrim i lirë

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësuesi shkruan në tabelë konceptet: Sisteme organesh; sistemi i frysëkëmbimit; sistemi i qarkullimit të gjakut; sistemi tretës;

Mësuesi udhëzon nxënësit të formojnë nga një paragraf të shkurtër më këto sisteme organesh.

Pasi nxënësit kanë përfunduar paragrafin, mësuesi nxit disa nxënës të lexojnë punët e tyre. Kjo veprimtari synon të nxisë nxënësit që të shprehen qartë me shkrim dhe të përdorin sa më shumë fjalor shkencor në tekstin e shkruar.

2-Ndërtimi i njohurive/Tabela e koncepteve

Mësuesi ndan klasën në grupe:

Grupi i parë modelon sistemin e qarkullimit. Nxënësit ngjyrosin organet, i presin me gérshërë dhe i vendosin në skicimin e trupit të njeriut në fletët që u shpërndan mësuesi.

Pasi me organet formojnë sistemin e qarkullimit të gjakut, nxënësit e grupit plotësojnë tabelën e koncepteve:

Funksioni	Sistemi i organeve	Disa organe të sistemit
Transporti i lëngjeve në trup	Sistemin e qarkullimit të gjakut	Zemra; Arterie; Venat;

Grupi i dytë modelon sistemin e tretjes së gjakut. Nxënësit ngjyrosin organet, i presin me gérshërë dhe i vendosin në skicimin e trupit të njeriut në fletët që u shpërndan mësuesi.

Pasi me organet formojnë sistemin e tretjes, nxënësit e grupit plotësojnë tabelën e koncepteve:

Funksioni	Sistemi i organeve	Disa organe të sistemit
Zbërthimi i ushqimeve dhe përhithja në gjak	Sistemi i tretjes	Goja; Ezofagu; Stomaku; Pankreasi; Mëlçia; Zorrët e holla; Zorrët e trasha;

Grupi i tretë modelon sistemin e frysëkëmbimit. Nxënësit ngjyrosin organet, i presin me gérshërë dhe i vendosin në skicimin e trupit të njeriut në fletët që ju shpërndan mësuesi.

Pasi me organet formojnë sistemin e frysëkëmbimit, nxënësit e grupit plotësojnë tabelën e koncepteve:

Funksioni	Sistemi i organeve	Disa organe të sistemit
Furnizon trupin me oksigjen dhe largon dioksidin e karbonit	Sistemin i frysëkëmbimit/frysëmarrjes	Trakeja; mushkëria; bronket; brinjët; diafragma;


Grupi i katërt modelon sistemin nervor. Nxënësit ngjyrosin organet, i presin me gérshërë dhe i vendosin në skicimin e trupit të njeriut në fletët që ju shpërndan mësuesi.

Pasi me organet formojnë sistemin nervor, nxënësit e grupit plotësojnë tabelën e koncepteve:

Funksioni	Sistemi i organeve	Disa organe të sistemit
Siguron komunikimin mes pjesëve të ndryshme të trupit	Sistemi nervor	Truri; Palca kurriore; Nervat; Organet e shqisave

Përforcimi i njohurive/ Organizuesi grafik i koncepteve

Nxënësi plotëson një organizues grafik me sistemet e organeve me të cilat punuan të katërt grupet e nxënësve dhe përbledhin funksionet e secilin sistem organesh.



Vlerësimi i situatës

Situata quhet e vlerësuar kur nxënësi:

- modelon saktë Sistemet e organeve;
- përshkruan funksionet që kryejnë sistemet e organeve;
- evidenton organet përbërëse të sistemeve të organeve;
- kuption sistemet e organeve që formojnë organizmin e njeriut;

Vlerësimi i nxënësit:

Nxënësi vlerësohet:

- për mënyrën se si arsyeton dhe bashkëpunon me shokët në grup për modelimin e sistemeve të organeve të njeriut dhe jep përgjigje të sakta mbi ndërtimin dhe funksionet e sistemeve të organeve;
- për qëndrim etik gjatë orës së mësimit dhe pjesëmarrje aktive gjatë punës në grup gjatë punës për modelimin e sistemeve të organeve dhe dhënies së përgjigjes për funksionet e sistemeve të organeve.

Situata e të nxenit nr. 4

Tematika: Sistemet

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla:III	Klasa:VII
Tema mësimore: 1- Skeleti i njeriut 2- Skeleti i njeriut			
Situata e të nxenit:			
Skeleti ndihmon në mbrojtjen e organeve të buta?			
Rezultatet e të nxenit sipas kompetencave kyçë			
<p>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Nxenësi zbaton mënyrat e të arsyetuarit shkencor dhe kupton më mirë informacionin e përshkruar mbi ndërtimin dhe funksionin që kryen skeleti i njeriut.</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Nxenësi përpunon në mënyrë kritike informacionin e mbledhur nga studimi i materialit mbi skeletin e njeriut dhe jep mendimin e tij gjatë diskutimit në grup përfunksionet e tij.</p> <p>Kompetenca e të nxenit: Demontron shkathtësi të përdorimit të TIK-ut në situata të ndryshme përgatitjen e detyrave, ndërtimin e tabelave dhe grafikëve në lidhje me skeletin e njeriut.</p>			
Rezultatet e të nxenit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxenësi: <ul style="list-style-type: none"> përshkruan ndërtimin e skeletit të njeriut; liston funksionet e skeletit të njeriut; emerton kockat që mbrojnë organet e trupit; tregon ndërtimin e kafazit të kraharorit; dallon midis koncepteve shtyllë kurrizore dhe palce e kurrizit; 		Fjalët kyçë: Kafka, shtylla kurrizore, kafazi i kraharorit, legeni, gjymtyrët e sipërme, gjymtyrët e poshtme	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi: Mundëson komunikimin midis nxënësve duke përdorur terminologjinë shkencore përmirësimin e kockave të skeletit të njeriut. TIK-u mbështet hetimin e proceseve në fushën e shkencave dhe lehtëson bashkëpunimin dhe komunikimin e nxënësve me bashkëmoshatarët gjatë procesit të nxenit, duke përfshirë edhe të nxenit në distancë.		Burimet: Teksti mësimor, skeleti i trupit të njeriut, koleksion me kocka kafshësh /shpendësh, pamje me skelete kafshësh	
Arti pamor: Nxenësi, duke shfrytëzuar programet e arteve pamore bëhet një njohës më i mirë i ndërtimit të skeletit të njeriut në hapësirë dhe në plan.			
Metodologja dhe veprimtaritë e nxënësve			
Përvijim i të menduarit/Harta e koncepteve DRTA-Veprimtari e të menduarit dhe të lexuarit të drejtuar		Tabela e koncepteve Diskutim i njohurive	

Përshkrimi kontekstual i situatës

Një pasdite po shikoja një emision për garat e çiklizmit. Çiklistët vendosin skafandra për të siguruar një mbrojtje më të mirë në rast aksidentesh.

Çfarë përparësie i siguron skeleti trupit të njeriut në mbrojtjen e organeve?

Veprimet e kryera për trajtimin e situatës


1-Parashikimi i njohurive- *Përvijim i të menduarit/Harta e koncepteve*

Mësuesi ndan nxënësit në grupe. Shkruan në tabelë konceptin: "Skeleti i njeriut" dhe modelon një hartë konceptesh. Shpjegon se nxënësit duhet të plotësoj në hartën e koncepteve me njohuritë që kanë mbi skeletin. Udhëzon nxënësit të shkruajnë fjalë apo fraza në lidhje me kockat e skeletit;

Nxënësi plotëson hartën e koncepteve për skeletin e njeriut dhe diskuton për funksionet e tij;

"Skeleti i njeriut"

Ndërtimi/Funksionet



2-Ndërtimi i njohurive- *RTA-Veprimitari e të Menduarit dhe të Lexuarit të Drejtuar*

Mësuesi u kërkon nxënësve të lexojnë me kujdes informacionin në tekstin mësimor U demonstron nxënësve skeletin e njeriut si dhe një koleksion me kocka kafshësh. Udhëzon nxënësit të lexojnë dhe vëzhgojnë mjetet didaktike në të njëjtën kohë. Udhëzon nxënësit të vizatojnë një tabelë përbledhëse ku të shkruajnë pjesët dhe funksionet e skeletit të njeriut.

Skeleti i njeriut	Ndërtimi	Funksionet
Kafka	Kockat e kafkës dhe të fytyrës	Mbron trurin
Kafazi i kraharorit dhe shtylla kurrizore	Kafazi i kraharorit përbëhet nga 12 brinjë që përparrë lidhen me dërrasën e kraharorit dhe në pjesën e pasme me shtyllën kurrizore	Mbrojnë zemrën dhe mushkëritë
Kockat e legenit	Përbëhen nga kocka të bashkuara me njëra-tjetër	Mbrojnë organet që gjenden në fundin e barkut

Gjymtyrët	Gjymtyrët e sipërme dhe të poshtme	Sigurojnë lëvizjen dhe mbështetjen e skeletit
------------------	------------------------------------	---

Nxënësi nепërmjet kësaj teknike evidenton ndërtimin dhe funksionet e skeletit të njeriut.

3-Përforcimi i njohurive- *Diskutim i njohurive*

Nxënësit diskutojnë për ndërtimin e skeletit të njeriut; Funksionet e skeletit; Përshtatshmëritë që ka fituar skeleti dhe që shërbejnë për mbrojtjen e organeve të buta; Dallimin midis skeletit të njeriut dhe kafshëve;

Vlerësimi i situatës:

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi:

- Evidenton organet përbërëse të skeletit të njeriut;
- Liston funksionet që kryen skeleti i njeriut;
- Argumenton rëndësinë e skeletit të njeriut në mbrojtjen e organeve të buta;

Vlerësimi i nxënësit:

Nxënësi vlerësohet:

- për mënyrën se si pëershkruan ndërtimin e skeletit të njeriut;
- për mënyrën se si shpjegon funksionet e skeletit;
- për bashkëpunim dhe qëndrim etik gjatë punës në grup dhe gjatë diskutimeve;

Detyra dhe puna e pavarur:

Detyrë klase:

- Nxënësit punojnë ushtrimin 1.3, faqe 13 në fletore pune.

Detyrë shtëpie

Gjeni informacion për skeletin e majmunëve. Sa i ngjashëm apo i ndryshëm është ky skelet nga skeleti i njeriut?

Situata e të nxënëtit nr. 5

Tematika: Sistemet

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: 1-Kyçet e kockave (artikulacionet) 2- Kyçet e kockave (artikulacionet)			

Situata e të nxënëtit:

Dëmtimi i ligamentit të gjurit

Rezultatet e të nxënëtit sipas kompetencave kyçë

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Nxënësi shpreh mendimin e tij për konceptet që kanë lidhje me artikulacionet.

Kompetenca e të menduarit: Nxënësi analizon, në mënyrë të pavarur, informacionet e marra nga burimet e ndryshme për ndërtimin dhe funksionet e artikulacioneve, gjithashtu vlerëson

rëndësinë e tyre në jetën e njeriut.

Kompetenca e të nxënëtit: Nxënësi parashtron pyetje në lidhje llojet e artikulacioneve dhe shfaq mendime të strukturuara për dhënien e përgjigjeve me shembuj konkretnë.

Kompetenca personale: Nxënësi demonstron vetëbesim dhe shkathtësi personale e ndërpersonale në orën e mësimit, komunikon lirshëm dhe vlerëson kujdesin që duhet treguar për t'i mbrojtur artikulacionet gjatë aktiviteteve fizike.

<p>Rezultatet e të nxënëtit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përkufizon konceptin kyçe (artikulacione); • Klasifikon kyçet sipas llojit të lidhjes; • Përshkruan ndërtimin e kyçeve; • Shpjegon rolin e lëngut sinovial tek kyçet; • Analizon dallimet midis llojeve të kyçeve. 	<p>Fjalët kyçe:</p> <p>Kyçe; kyçi sferë-fole, kyçi i fiksuar, kyçi në formë menteshe, forca e fërkimit, kartilagje, tendina, ligamente, lëngu sinovial</p>
<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Gjuha dhe komunikimi: Mundëson komunikimin midis nxënësve gjatë diskutimit dhe përshkrimit të koncepteve shkencore duke përdorur një terminologji të saktë shkencore;</p> <p>Teknologjia dhe TIK: Mbështet hetimin e proceseve në fushën e shkencave dhe lehtëson bashkëpunimin e nxënësve me njeri-tjetrin.</p> <p>Arti pamor: Nxënësi, duke shfrytëzuar programet e arteve pamore bëhet një njohës më i mirë i ndërtimit të kyçeve në hapësirë dhe në plan.</p>	<p>Burimet:</p> <p>Libri i nxënësit, kyçe gjuri të ndonjë kafshe, mjete shkrimi</p>

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

<p>Stuhi mendimesh</p> <p>Pyetja sjell pyetjen</p>	<p>Punë në dyshe</p> <p>Organizues grafik i koncepteve</p>
--	--

Përshkrimi kontekstual i situatës

Gjatë një ndeshje futbolli, Bruno pësoi një dëmtim në gjurin e djathë. Mjeku sportiv i tha se ai kishte këputur ligamentin e kryqëzuar të gjurit. Çfarë e shkakton këtë dëmtim dhe sa kohë i duhet për t'u kuruar nga ky dëmtim?

Veprimet e kryera për trajtimin e situatës

1-Parashikimi i njohurive/Stuhi mendimesh

Mësuesi fillon veprimtarinë duke ju demonstruar një kyç të një kafshe, p.sh. një kyç të gjurit të viçit të pagatuar dhe duke dhënë disa fakte përreth kyçeve: *Kyçet shërbejnë për të lidhur kockat në trupin e njeriut dhe të kafshëve. Funksioni i tyre bazohet në njohuritë e marra në lëndën e fizikës mbi forcat e fërkimit midis lëngut sinovial dhe kockave.*

U kérkon nxënësve të diskutojnë për funksionin e kyçit në trupin e viçit/kafshëve dhe njëkohësisht nxit nxënësit të diskutojnë edhe për llojet e kyçeve që gjenden në trupin e njeriut. Informacionin e diskutuar nga nxënësit e përmbledh në tabelë.

2-Ndërtimi i njohurive/Pyetja sjell pyetjen

Mësuesi u kérkon nxënësve të lexojnë informacionin e dhënë në tekstin mësimor dhe të

punojnë **në dyshe** për të hartuar pyetje pérreth materialit dhe të diskutojnë përgjigjet.

Kjo veprimitari i bën nxënësit të ndjehen më të sigurt dhe të vlefshëm gjatë përforcimit të koncepteve dhe diskutimit në grup.

Nxënësit i drejtojnë pyetje njëri-tjetrit dhe japid përgjigje.

Nxënësi 1: Çfarë është një kyç (artikulacion)?

Nxënësi 2: Një kyç (artikulacion), është vendi ku takohen kockat.

Nxënësi 3: Sa lloj kyçesh dallohen në trupin e njeriut?

Nxënësi 4: Në trupin e njeriut dallohen dy lloje kryesore kyçesh.

Nxënësi 5: Shpjegoni me anë të shembujve dallimin midis kyçeve të fiksuarë dhe të lëvizshme?

Nxënësi 6: Kyçet e fiksuarë janë të palëvizshme –P.sh. kyçet e kafkës dallojnë nga kyçet e lëvizshme të nofullave.

Nxënësi 7: Si funksionon kyçi i llojit sferë -fole?

Nxënësi 8: Koka në formë sfere e një kocke përputhet me folenë zgavrove të kockës tjetër.

Nxënësi 9: A mund të tregoni një kyç në formë menteshe në trupin e njeriut?


Nxënësi 10: Bërryli është një kyç në formë menteshe dhe lëviz në një drejtim.

Nxënësi 11: Si është i ndërtuar një kyç i lëvizshëm?

Nxënësi 12: Kocka në formë sfere e kockës së krahut, futet në folenë zgavrove të kockës së parakrahut. Kockat lubrifikohen nga lëngu sinovial.

Përforcimi i njohurive/Organizues grafik i koncepteve

Nxënësit plotësojnë organizuesin grafik me llojet kryesore të kyçeve duke diskutuar dhe duke dhënë shembuj konkretë.



Vlerësimi i nxënësit

Nxënësi vlerësohet për mënyrën se si arsyeton dhe bashkëpunon me shokët në grup për të dhënë përgjigje të sakta mbi:llojet e kyçeve, ndërtimin dhe funksionimin e tyre.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e vlerësuar kur nxënësi arsyeton drejt për situatën e dhënë dhe jep një përgjigje të argumentuar se cilat janë disa nga arsyet për dëmtimin e kyçeve dhe sa kohë duhet për ta kuruar atë.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Detyrë shtëpie

Ushtrimet 1 dhe 3 në fletore pune, faqe 13.

Gjeni informacion për llojet e ndryshme të kyçeve që përdoren për të vënë në lëvizje robotët.

Situata e të nxenit nr. 6

Tematika: Sistemet

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla:III	Klasa:VII
Tema mësimore: 1-Muskujt, ndërtimi dhe funksioni i tyre 2-Muskujt, ndërtimi dhe funksioni i tyre			
Situata e të nxenit: Loja e mundjes së krahut			
Rezultatet e të nxenit sipas kompetencave kyçë			
<p>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Nxënësi zbaton mënyrat e të arsyetuarit shkencor dhe kupton më mirë informacionin e përshkruar mbi ndërtimin dhe funksionin që kryejnë muskujt në trupin e njeriut.</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Nxënësi përpunon në mënyrë kritike informacionin e mbledhur nga studimi i informacionit mbi muskujt dhe ndërtimin e tyre dhe jep mendimin e tij gjatë diskutimit në grup për mënyrën se si punojnë muskujt.</p> <p>Kompetenca e të nxenit: Nxënësi regjiströn formacionin në formë të shkruar, etiketon pjesët e sistemit të qarkullimit duke përforcuar edhe funksionet përkatëse</p>			
Rezultatet e të nxenit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> Përshkruan funksionet që kryejnë muskujt; Shpjegon si punojnë muskujt për të realizuar tkurrjen e krahut; Analizon veprimtarinë e muskujve antagonistë; 		Fjalët kyçë: Muskuj; tendinë, tkurrje, kocka, energji, muskuj antagonistë	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi: Mundëson komunikimin midis nxënësve duke përdorur terminologjinë shkencore kur përshkruan si realizohet shkëmbimi i gazeve në qeliza. TIK-u mbështet hetimin e proceseve në fushën e shkencave dhe lehtëson bashkëpunimin dhe komunikimin e nxënësve me bashkëmoshatarët gjatë procesit të të nxenit, duke përfshirë edhe të nxenit në distancë.		Burimet: Teksti mësimor, tabela dhe mjete shkrimi, atlase anatomie ose enciklopedi	
Arti pamor: Nxënësi, duke shfrytëzuar programet e arteve pamore bëhet një njohës më i mirë i ndërtimit të kyçeve në hapësirë dhe në plan.			
Metodologja dhe veprimtaritë e nxënësve			
Parashikimi me terma paraprakë Di/Dua të Di /Nxë		Diskutim i njohurive Harta e koncepteve	
Përshkrimi kontekstual i situatës Dy shokë ishin ulur në tavolinë dhe po luanin mundje krahut. Fillimisht ata i kanë krahët të shtrirë mbi tavolinë pastaj ngrenë me kujdes dhe fillojnë lojën e mundjes së krahut. Si do të reagojnë muskujt dykrerësh, trekërësh, tendinat dhe kockat gjatë kësaj veprimtarie?			

Veprimet e kryera për trajtimin e situatës

1-Parashikimi i njohurive/Parashikim me terma paraprakë

Hapi i parë: Mësuesi zgjedh nga tema e mësimit disa koncepte kyçë: tkurrje, kocka, tendina, ligamente, energji;

Hapi i dytë: Shkruan në tabelë konceptet e mësipërme dhe u kërkon nxënësve të përgatitin një tregim të shkurtër që përmban këto fjalë;

Hapi i tretë: Pas pak minutash u kërkon nxënësve të lexojnë krijimin e tyre.

2-Ndërtimi i njohurive-Di/Dua të Di /Nxë

Mësuesi udhëzon nxënësit të lexojnë informacionin në tekstin. Në këtë mënyrë nxitet vëmendja e nxënësit dhe rritet procesi i të nxënët duke u përqendruar te fjalët kyçë.

Nxënësit plotësojnë tabelën:

Di	Dua të Di	Nxë
1-Muskujt janë organe që mundësojnë lëvizjen tonë; 2-Muskujt janë të lidhur me kockat;	1-Si qëndrojnë të lidhur muskujt me kockat? 2-Si punojnë muskujt? 3-Çfarë ndodh me muskujt dhe kockat kur ne përkulim krahun? 4-Kur një muskul është në gjendje qetësie? 5-Çfarë janë muskujt antagonist?	1-Muskujt me kockat lidhen me anë të tendinave. 2-Muskujt mund të shkurtohen, ky proces quhet tkurrje. Kur muskujt tkurren ato shkaktojnë një forcë têrheqëse mbi kockën. 3-Kur ne përkulim krahun,muskuli dykrerësh ushtron forcë têrheqëse mbi rrezorin dhe shpatullën. Kjo forcë têrheqëse i transmetohet kockave përmes tendinëve. Rrezori têrhiqet lart drejt shpatullës dhe krahu përkulet. Muskuli trekërësh mbetet në qetësi. 4-Një muskul është në gjendje qetësie kur ai nuk është i tkurrur. 5-Muskujt antagonist formojnë një çift muskuish që punojnë së bashku dhe têrheqin kockat në drejtime të kundërta.

3-Përforcimi i njohurive/Diagrami i Venit

Nxënësi plotëson diagramin e Venit dhe krahason si veprojnë muskuj dykrerësh dhe trekërësh gjatë përkuljes dhe lëshimit të krahut.

Përkulja e krahut

Lëshimi i krahut

Kur përkulet krahu, muskuli dykrerësh tkurret, ndërsa muskuli trekërësh mbetet në qetësi. Tkurja e muskulit dykrerësh têrheq tendinin e për pasojë rrezori lëviz lart.

Për të drejtuar krahun, muskuli trekërësh tkurret, ndërsa ai dykrerësh mbetet në qetësi. Tkurja e muskulit trekërësh bën të mundur têrheqjen e tendinit, për pasojë fyelli lëviz poshtë.

Si punojnë muskujt dykrerësh dhe trekërësh gjatë tkurrjes dhe lëshimit të krahut?

Vlerësimi i situatës:

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi:

- Shpjegon si realizohet përkulja dhe lëshimi i krahut;
- Analizon si sillen muskujt dykrerësh dhe trekërësh gjatë tkurrjes dhe lëshimit të krahut;

Vlerësimi i nxënësit:

Nxënësi vlerësohet:

- për mënyrën se si përshkruan procesin e tkurrjes dhe lëshimit të muskujve gjatë përkuljes dhe lëshimit të krahut;
- për saktësinë me të cilën shpjegon si punojnë muskujt antagonistë;
- për bashkëpunim dhe qëndrim etik gjatë punës në grup dhe gjatë diskutimeve për punën e muskujve.

Detyrat dhe puna e pavarur:**Detyrë shtëpie:**

Ushtrimet 1 dhe 5, faqe 14.

Situata e të nxënëtit nr. 7**Tematika: Sistemet**

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: 1-Studimi i trupit të njeriut 2- Studimi i trupit të njeriut			
Situata e të nxënëtit:			
Dieta e papërshtatshme e një futbollisti			
Rezultatet e të nxënëtit sipas kompetencave kyçë			
Kompetenca e komunikimit e të shprehurit: Nxënësi zbaton mënyrat e të arsyetuarit shkencor dhe kuption më qartë se shkencëtarët janë në kërkim të vazhdueshëm për të njojur të panjohurat për trupin e njeriut dhe funksionet e tij. Kompetenca e të menduarit: Nxënësi përpunon në mënyrë kritike informacionin mbi punën e mjekëve dhe kirurgëve të cilët aplikojnë në praktikë njojuritë që shkencëtarët kanë zbuluar gjatë studimit të trupit të njeriut dhe jepin mendimin e tyre gjatë diskutimit në grup. Kompetenca e të nxënëtit: Demonstron shkahtësi të përdorimit të TIK-ut në situata të ndryshme mësimore si për gjetjen e informacioneve mbi rëndësinë e studimit të trupit të njeriut.			
Rezultatet e të nxënëtit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • Evidenton rolin e shkencëtarëve në studimin e trupit të njeriut; • Përshkruan mënyrat që përdorin anatomistët për studimin e trupit të njeriut; • Shpjegon se si fiziologët dhe mjekët sportivë studiojnë se si dieta e një sportisti dhe programi i tij trajnues ndikojnë mbi zemrën dhe mushkëritë; • Tregon se si një neurokërkues bën kërkime për mënyrat se si truri dërgon sinjale në pjesë të tjera të trupit. 		Fjalët kyçë: Shkencëtarë; anatomistë, fiziologë sportivë, mjekë sportivë, neurokërkues, mjek, kirurg	

<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Gjuha dhe komunikimi: Mundëson komunikimin midis nxënësve duke përdorur terminologjinë shkencore në gjuhën e folur ose të shkruar për studimin e trupit të njeriut.</p> <p>TIK-u mbështet hetimin e proceseve në fushën e shkencave dhe lehtëson bashkëpunimin e nxënësve me njëri-tjetrin. Për shembull, nëpërmjet përdorimit të TIK-ut nxënësi diskuton dhe ndan idetë e tij me shokët, por ka mundësi të konsultohet edhe me ekspertë të fushës që merren me studimin e trupit të njeriut.</p>	<p>Burimet:</p> <p>Teksti mësimor, fletore pune, tabela dhe mjete shkrimi, informacione nga interneti, revista shkencore ose enciklopedi</p>
---	---

Metodologja dhe veprimtaritë e nxënësve

Stuhi mendimesh

Prezantim me PowerPoint

Punë në grupe

Tabela e koncepteve

Kllaster

Bashkëbisedim

Përshkrimi kontekstual i situatës

Një futbollist, gjatë periudhës së dimrit filloi të konsumonte një dietë të pasur me shumë yndyra. Në muajt pasardhës trupi i tij u shëndosh dhe ai filloi të kishte vështirësi në anën e djathë të organizmit, në drejtim të zemrës. Me cilin mjek duhet të këshillohet futbollisti për të gjetur një zgjidhje për situatën e krijuar?

Veprimet e kryera për trajtimin e situatës

1-Parashikimi i njohurive-Stuhi mendimesh

Mësuesi shkruan në tabelë konceptet: trupi i njeriut, shkencë, shkencëtarë dhe mjekë. U drejton nxënësve pyetje për të nxitur imaginatën e tyre në lidhje me konceptet.

Mësuesi drejton pyetjet: *Cili është roli i shkencës në studimin e trupit të njeriut? Cili është dallimi midis shkencëtarëve dhe mjekëve e kirurgëve?*

Mësuesi përbledh përgjigjet e nxënësve në tabelë dhe diskutojnë për shkencëtarë të fushave të ndryshme që merren me studimin e trupit të njeriut.

2-Ndërtimi i njohurive: Prezantim me PowerPoint / Tabela e koncepteve

Mësuesi ndan klasën në grupe dhe në krye të grupit cakton një nxënës që luan rolin e një "shkencëtar"; Udhëzon grupet e nxënësve të gjejnë informacione nga librat, interneti dhe të përgatisin informacionin për prezantim me një poster ose me PowerPoint; Cakton detyrat në grup: P.sh, një nxënës mund të përzgjedhë informacionin; një nxënës mund të përbledh informacionin; një tjetër mund të përzgjedhë ose vizatojë figura; një nxënës në çdo grup do të prezantojë informacionin e përgatitur në PowerPoint ose me poster.

Prezantimi me poster ose me PowerPoint do të mbështetet në çështjet:

- Roli i shkencëtarëve të ndryshëm në studimin e trupit të njeriut;
- Teknikat që përdorin anatomistët për të parë brenda trupit të njeriut;
- Rolin që luan fiziologu dhe mjeku sportiv në studimin e mënyrës se si ndikon një dietë ushqimore dhe programi trajnues i një futbollisti në veprimtarinë e zemrës dhe të mushkërive;
- Mënyrën se si një neurokërkues bën kërkime për mënyrat se si truri dërgon sinjale në pjesë të tjera të trupit;

- Punën që bëjnë kërkuesit e mëposhtëm shkencorë si: dietologu, psikologu, osteologu dhe gjenetisti për studimin e trupit të njeriut.


Tabela e koncepteve

Pasi nxënësit dëgjojnë materialin e prezantuar shokët tyre, mësuesi i udhëzon nxënësit të plotësojnë tabelën e koncepteve dhe të jepin shpjegimet përkatëse për rolin që luan çdo shkencëtar apo mjek në studimin e trupit të njeriut.

Shkencëtarët dhe mjekët që studiojnë trupin e njeriut	Shpjegimet përkatëse
Shkencëtarët	Studiojnë trupin e njeriut dhe të panjohurat rrëth funksionimit të tij.
Anatomisti	Studion ndërtimin e trupit të njeriut.
Fiziologu sportiv	Studion ndikimin që ka dieta dhe program trajnues i një sportisti mbi veprimtarinë e zemrës dhe mushkërive.
Mjeku sportiv	Ndjek nga afër shëndetin e një sportisti.
Neurokërkuesi	Studion se si punon truri dhe pjesët e tjera të sistemit nervor.
Dietologu	Harton dieta ushqimore bazuar në aktivitetin e përditshëm që kryen çdo njeri, moshën dhe gjininë.
Psikologu	Studion gjendjen psikologjike të njeriut.
Osteologu	Studion kockat.
Gjenetisti	Studion gjenet, sëmundjet gjenetike etj.

3-Përforcimi i njoburive-Kllaster

Nxënësi plotëson kllasterin e mëposhtëm dhe shpjegon se si shkencëtarë të ndryshëm dhe mjekë punojnë për të studiuar të panjohurat rrëth trupit të njeriut dhe trupit të tij:



Vlerësimi i situatës:

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi:

- Përshkruan rolin e shkencëtarëve në studimin e të panjohurave rrëth trupit të njeriut dhe funksionimit të tij;

- Shpjegon se cili shkencëtar mund të analizojë situatën shëndetësore të krijuar tek futbollisti pas konsumimit të një diete të pasur me shumë yndyra.

Vlerësimi i nxënësit:

Nxënësi vlerësohet:

- për shpjegimin e saktë të rolit që luajnë shkencëtarët që studiojnë të panjohurat në trupin e njeriut dhe mënyrën e funksionimit të tij;
- për bashkëpunim dhe qëndrim etik gjatë punës në grup, gjatë prezantimeve të informacioneve me poster ose me PowerPoint dhe gjatë bashkëbisedimeve për punën e shkencëtarëve dhe mjekëve.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Detyrë shtëpie:

Kërkon më shumë informacion për punën e shkencëtarëve dhe mjekëve për studimin e të panjohurave të trupit të njeriut dhe funksionimit të tij.

Situata e të nxënëtit nr. 8

Tematika: Sistemet

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: 1-Di dhe praktikoj 2-Di dhe praktikoj			

Situata e të nxënëtit:

Ushtrime

Rezultatet e të nxënëtit sipas kompetencave kyçë

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Nxënësi shprehet me një terminologji të pasur shkencore kur flet për sistemet te bimët dhe te njeriu.

Kompetenca e të menduarit: Nxënësi analizon, në mënyrë të pavarur, informacionet e marra nga burimet e ndryshme për organet e bimëve dhe sistemet e organeve te njeriu.

Kompetenca e të nxënëtit: Nxënësi parashtron pyetje në lidhje me ndërtimin e skeletit, të kyçeve dhe muskujve dhe jep mendime dhe përgjigje të sakta.

Kompetenca personale: Nxënësi demonstron vetëbesim dhe shkathtësi personale e ndërpersonale në orën e mësimit, komunikon lirshëm me shokët gjatë diskutimit për ndërtimin e trupit të bimëve dhe kafshëve,

Rezultatet e të nxënëtit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi:	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan ndërtimin dhe funksionin e bimëve; • Analizon ndërtimin dhe funksionet e sistemeve të organeve te njeriu; • Shpjegon ndërtimin e skeletit të njeriut; • Liston funksionet e skeletit të njeriut; • Përshkruan ndërtimin e një kyçi; • Dallon funksionet e llojeve të ndryshme të kyçeve; • Interpreton me fjalë si punojnë muskujt e krahut; 	Fjalët kyçë: Organe, sisteme organesh, organizëm, klorofil, tretje, gjaku, nervat, ushqim, frysëkëmbim, rrënje, skeleti, kyçet, muskujt
--	---	---

<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Gjuha dhe komunikimi: Mundëson komunikimin midis nxënësve gjatë diskutimit dhe përshkrimit të koncepteve shkencore. Aftëson nxënësit në përdorimin e terminologjisë së fushave të shkencës.</p> <p>Teknologji dhe TIK: Mbështet hetimin e proceseve në fushën e shkencave dhe lehtëson bashkëpunimin e nxënësve me njeri-tjetrin.</p> <p>Matematika: Interpretimi dukurive nëpërmjet përdorimit të grafikëve, vërteton qartë lidhjen e shkencës së matematikës me shkencat e natyrës.</p>	<p>Burimet:</p> <p>Libri i nxënësit; fletore pune, enciklopedi dhe atlase anatomie, kompjuter, enkarta ose cd</p>
--	--

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Shkrim i lirë

Ushtrime

Bashkëbisedim

Punë në grupe

Rrjeti i diskutimit

Veprimet e kryera për zgjidhjen e ushtrimeve

1-Parashikimi i njohurive-Shkrim i lirë

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësuesi shkruan në tabelë konceptet: organe, sisteme organesh, organizëm, klorofil, tretje, gjaku, nervat, ushqim, frymëkëmbim, rrënje, skelet, kyçet, muskujt.

Mësuesi udhëzon nxënësit të formojnë nga një fjali me këto koncepte.

Pasi nxënësit kanë përfunduar fjalitë, mësuesi i këshillon t'i lexojnë ato. Kjo veprimtari synon të nxisë nxënësit që të shprehen qartë me shkrim dhe të formulojnë fjali duke përdorur konceptet shkencore.

2-Ndërtimi i njohurive – Ushtrime

Punë në grupe.

Mësuesi ndan grupet e nxënësve dhe i udhëzon të punojnë me ushtrime.

Grupi I: Ushtrimi 1.1 faqe 18, në fletore pune;

Veprimet e kryera për plotësimin e ushtrimit:


Hapi i parë: Nxënësit lexojnë me kujdes ushtrimin duke u përqendruar te hapësirat boshe.

Hapi i dytë: Shikojnë me kujdes fjalët e dhëna në hyrje të ushtrimit dhe plotësojnë vendet bosh me fjalët e duhura.

Hapi i tretë: Lexojnë me zë të lartë ushtrimin dhe diskutojnë me shokët për saktësinë me të cilën kanë punuar ushtrimin.

Grupi II: Ushtrimi 1.2, faqe 18 në fletore pune.

Kjo figurë tregon sistemin e organeve në trupin e njeriut.



Hapi i parë: Nxënësit analizojnë të gjitha pikat e ushtrimit, arsyetojnë dhe emërtojnë sistemet e organeve.

Hapi i dytë: Nxënësit japid përgjigje të argumentuara për funksionin e sistemit të organeve.

Hapi i tretë: Nxënësit reflektojnë mbi përgjigjet, paraqesin rezultatet e tyre para shokëve të klasës dhe i diskutojnë.

Grupi III: Ushtimi 1.3 faqe 18, në fletore pune.

Nxënësit analizojnë situatën që jepet në ushtrim.

Kërcejtë e bimëve mund të përkulen. Përkulja i ndihmon bimet nga thyerja, kur mbi to vepron një forcë anësore siç është ajo e erës së fortë. Ana bëri një eksperiment për të krahasuar se sa shumë përkulen kërcejtë e bimëve të ndryshme kur mbi to vepron e njëjtë forcë.

Veprimet e kryera:

Hapi i parë:

Pasi nxënësit lexojnë me kujdes ushtrimin duhet të sqarojnë:

a. Çfarë duhet të mbajë të pandryshuar Ana në eksperimentin e saj?


b. Lidhjen që ekziston midis trashësisë së kërcellit dhe përkuljes që pëson ai.

Hapi i dytë: Nxënësit reflektojnë mbi përgjigjet, plotësojnë tabelën e dhënë në libër dhe paraqesin rezultatet e tyre para shokëve të klasës, ku i diskutojnë së bashku përgjigjet.

Përforcimi i njohurive-Ushtrime/Rrjeti i diskutimit

Çështja që shtrohet për diskutim është:

Të gjitha gjallesat që jetojnë në planetin Tokë e marrin ushqimin dhe oksigjenin nga bimet.



Detyrat dhe puna e pavarur:

Detyrë e pavarur

Nxënësit punojnë të pavarur për të njohur informacionin e dhënë në situatën e grupit të tij, për të gjetur përgjigje të sakta për pyetjet dhe ushtrimet e dhëna duke përdorur koncepte shkencore gjatë punës me ushtrime.

Detyrë shtëpie

Përgatitni një prezantim me poster ose me PowerPoint me temën: Sistemet te bimet dhe njeriu

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e vlerësuar kur nxënësi:

- U jep përgjigje të sakta ushtrimeve të dhëna në librin e nxënësit;
- Nxjerr përfundimin se bimet ashtu si dhe kafshët kanë organë që kryejnë funksione të caktuara;
- Përgjithëson se sistemet e organeve bashkërendojnë punën për kryerjen e funksioneve jetike në organizmin e njeriut.

Vlerësimi i nxënësit:

Nxënësi vlerësohet për mënyrën se si arsyeton dhe bashkëpunon me shokët në grup për të dhënë përgjigje të sakta mbi ndërtimin e bimëve dhe trupit të njeriut.

Situata e të nxënësit nr. 9

Tematika: Sistemet

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<p>Tema mësimore: Përsëritje përbledhëse Kapitulli 1</p>			
<p>Situata e të nxënësit Përsëritje</p>			
<p>Rezultatet e të nxënësit sipas kompetencave kyçë</p> <p>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të reja duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm shkencor.</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Nxënësi përdor krahasimin dhe kontrastin përfundimtare të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis organeve dhe sistemeve të organeve te bimët dhe te kafshët.</p> <p>Kompetenca e të nxënëtit: Nxënësi shfrytëzon portofolin personal për identifikimin e përparësive dhe mangësive në funksion të vetëvlerësimit të përparimit dhe përmirësimit të suksesit në fushën e caktuar.</p> <p>Kompetenca personale: Nxënësi merr pjesë ose drejton punën në grup, bashkëpunon me përfaqësues të komunitetit përfundimtare moshatarët dhe anëtarët e tjerë të komunitetit që kanë probleme përfundimtare mbrojtjen e gjallesave bimore dhe shtazore.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënësit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">Përshkruan ndërtimin e bimës dhe funksionet e organeve;Shpjegon ndërtimin e organizmit të njeriut;Dallon funksionet që kryejnë sistemet e organeve;Tregon funksionet që kryen skeleti i njeriut;Evidenton rolin e kyçeve përfundimtare njeriut;Analizon rolin e muskujve në tkurjen e gjymtyrëve;		<p>Fjalët kyçë: Klorofili, fotosinteza, bimët, organet, sistemet e organeve te njeriut, skeleti i njeriut, kyçet, muskujt</p>	
<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Gjuha dhe komunikimi: Mundëson komunikimin midis nxënësve gjatë diskutimit dhe përshkrimit të koncepteve mbi mënyrën e ushqyerjes së bimëve dhe njeriut duke përdorur një terminologji të pasur shkencore.</p> <p>Teknologjia dhe TIK: Nxënësi përdor sistemet e duhura kompjuterike përgatitjen e detyrate duke zbatuar në mënyrë krijuarës njojuritë që përbajnjë shkencat kompjuterike dhe mediat digitale përfundimtare, tabelave, grafikëve dhe përgatitjen e detyrate të ndryshme.</p>		<p>Burimet: Teksti mësimor, mjete shkrimi, video-projektor/ kompjuter dhe mundësi të përdorimit të internetit</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p> <p>Alfabeti i njëpasnjëshëm Prezantim me PowerPoint</p> <p>Tabela e koncepteve Diagrami i Venit</p>			

Veprimet e kryera për trajtimin e situatës

1-Parashikimi i njohurive/Alfabeti i njëpasnjëshëm

Mësuesi i jep secilit nxënës një kopje të alfabetit të njëpasnjëshëm të paplotësuar. Kërkon nga nxënësit të shkruajnë një koncept që ka lidhje me informacionin e lëndës së biologjisë të trajtuar në kapitullin e parë, sipas shkronjave të alfabetit. Pasi secili nxënës plotëson fletën e tij me alfabetin e njëpasnjëshëm, e shkëmben atë me shokun që ka pranë dhe ky veprim përsëritet disa herë me radhë.

A Arterie Anatomist	B Bronket Brinjët	C	Ç	D Diafragma Dioksid karboni	Dh
E Energji diellore	Ë	F Frymëkëmbim Frymënxitje Femuri	G Goja	Gj Gjethet Gjaku	H Humerusi
I	J	K Klorofil Kërcelli Kyçet Kafka Klavikula Karpalet Kartilagje	L Lulet Legeni Lëngu sinovial	Ll	M Mëlçi Mushkëritë Muskujt
N Nervat	Nj Njeriu	O Oksigjen Organe Organizëm	P Pigment I gjelbër Pankreasi Palca kurriore	Q Qelizat	R Rektumi
Rr Rrënjet Rrezori	S Stomaku Syri Sternumi	Sh Shqisat Shpatulla	T Truri Trakeja Tretje Tkurrje Tendinë	Th Thellim I enzimës	U Uji Ushqimi Ulna
V Vena	X	Xh	Y Yndyra	Z Zorra e hollë Zemra Zgavra e syrit	Zh


2-Ndërtimi i njohurive-Prezantim me PowerPoint/ Tabela e koncepteve

Mësuesi ka ndarë nxënësit në 3 grupe dhe ka ndarë detyrat një orë më parë. Grupet e nxënësve përgatitin materialin e trajtuar në kapitullin e parë dhe prezantojnë njohuritë në mënyra të ndryshme. Prezantimi mund të jetë me PowerPoint ose nxënësit mund të punojnë me fletë formati A3/A2 ku skicojnë ndërtimin e bimës dhe sistemet e organeve te njeriu.

Grupi i parë

Prezanton informacionin dhe përqendrohet në temat:

- Ndërtimi i bimës
- Klorofili dhe fotosinteza
- Organet e bimës dhe funksionet që kryen secili organ



Pasi përfaqësuesi i grupit të parë prezanton informacionin mësuesi shpërndan foto, nxënësit emërtojnë pjesët e bimëve dhe formulojnë një fjali për secilin organ.

Grupi i dytë

Prezanton informacionin dhe përqendrohet në temat:


Sistemi i tretjes te njeriu dhe funksionet që kryen;

Sistemi i qarkullimit të gjakut te njeriu dhe funksionet që kryen;

Sistemi nervor te njeriu dhe funksionet që kryen;

Sistemi i fryshtësimit te njeriu dhe funksionet që kryen;

Pasi nxënësi përfaqësues i grupit prezanton projektin, mësuesi u shpërndan nxënësve fleta me sistemet e organeve. Nxënësit emërtojnë sistemet e organeve dhe shkruajnë në fletore funksionet që kryen secili prej tyre.



Grupi i tretë

Prezanton informacionin dhe përqendrohet në temat:

- Skeleti i njeriut, ndërtimi dhe funksionet që ai kryen
- Kyçet e kockave, ndërtimi dhe funksionet që kryejnë
- Muskujt, ndërtimi dhe funksionet e tyre


Pasi nxënësi përfaqësues i grupit prezanton projektin, mësuesi u shpërndan nxënësve fleta me pamjen e skeletit, të kyçeve dhe të muskujve. Nxënësit emërtojnë pjesët kryesore dhe shkruajnë në fletore funksionet që kryen secili prej tyre.



3-Përforcimi i njohurive - Diagrami i Venit

Nxënësi përforcon njohuritë dhe shpreh mendimin e tij për konceptet e trajtuarë më sipër dhe shkëmbjnë mendime së bashku me shokët e klasës. Krahason mënyrën se si e ushqehen bimët dhe kafshët dhe plotëson diagramin e Venit ku shpreh dallimet dhe të përbashkëtat:

Të përbashkëta



Detyrë e pavarur

Detyrë shtëpie

Kërkoni më shumë informacion për sistemet e organeve te njeriu dhe sëmundjet e organeve si zemra, mushkëritë dhe truri.

Vlerësimi i nxënësit

Nxënësi vlerësohet:

- për përdorimin e fjalorit të saktë shkencor gjatë orës së mësimit;
- për saktësinë e shprehjes së koncepteve për kapitullin Sistemet e organeve;
- për bashkëpunim dhe qëndrim etik gjatë punës në grup dhe gjatë diskutimeve.

Situata e të nxënëtit nr. 10

Tematika: Sistemet

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla: III	Klasa: VII
<p>Tema mësimore: Test përbledhës</p> <p>Kapitulli I</p>			
<p>Situata e të nxënëtit:</p> <p>Test</p>			
<p>Rezultatet e të nxënëtit sipas kompetencave kyçë</p>			
<p>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Nxënësi shpreh mendimin e tij në lidhje me sistemet te bimët dhe te njeriu me shkrim duke përdorur terminologji shkencore të pasur.</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Nxënësi analizon, në mënyrë të pavarur, informacionet e marra nga libri i nxënësit dhe nga fletorja e punës në lidhje me sistemet te bimët dhe te njeriu dhe arsyeton qartë për ndërtimin dhe funksionet që ato kryejnë në organizmat e gjallë.</p> <p>Kompetenca e të nxënëtit: Nxënësi menaxhon emocionet, kohën, shfrytëzimin e materialeve dhe të mjetave gjatë kryerjes së testit që të arrijë rezultate sa më të larta.</p> <p>Nxënësi Kompetenca personale: Nxënësi vlerëson përgatiqen personale për njohuritë mbi sistemet te bimët dhe te njeriu dhe demonstron vetëbesim dhe shkathtësi personale e ndërpersonale në orën e testit dhe shpreh mendimin e tij qartë me shkrim.</p>			

<p>Rezultatet e të nxenit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxenësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan rolin e klorofilit dhe të energjisë diellore për prodhimin e lëndës ushqimore te bimët; • Identifikon organet bimore dhe shpjegon funksionet e tyre; • Analizon ndërtimin e sistemeve të organeve te njeriu dhe tregon funksionin e tyre; • Shpjegon ndërtimin e skeletit të njeriut dhe analizon funksionet që ai kryen; • Argumenton rëndësinë e kyçeve në lëvizjen e kockave të gjymtyrëve; • Krahason sjelljen e muskullit dykrerësh me atë trekrrerësh gjatë tkurrjes së krahut të njeriut. 	<p>Fjalët kyçe: Klorofili, fotosinteza, bimët, organet, sistemet e organeve te njeriu, skeleti i njeriut, kyçet, muskujt</p>
<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Gjuha dhe komunikimi: Mundëson komunikimin midis nxenësve gjatë diskutimit dhe përshkrimit të koncepteve mbi mënyrën e ushqyerjes së bimëve dhe njeriut duke përdorur një terminologji të pasur shkencore.</p> <p>Teknologjia dhe TIK: Nxenësi përdor sistemet e duhura kompjuterike për përgatitjen e detyrave duke zbatuar në mënyrë krijuese njojuritë që përbajnjë shkencat kompjuterike dhe mediat digitale për ndërtimin e tabelave, grafikëve dhe përgatitjen e detyrave të ndryshme.</p>	<p>Burimet: Teza e provimit; mjete shkrimi, lapsa/gomë dhe stilolapsa</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxenësve</p> <p>Punë individuale</p>	
<p>Trajtimi i situatës së të nxenit</p>	
<p>Vlerësimi i situatës:</p>	
<p><i>Situata në test quhet e realizuar nëse nxenësi:</i></p>	
<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan saktë ndërtimin e organeve të bimore; • Analizon ndërtimin e sistemeve të organeve dhe shpjegon funksionin e tyre; • Tregon funksionet e skeletit; • Përshkruan sjelljen e muskujve antagonistë në tkurrjen dhe lëshimin e krahut. 	
<p>Vlerësimi i nxenësit:</p>	
<p>Nxenësi vlerësohet:</p>	
<ul style="list-style-type: none"> • për shpjegimin e saktë të koncepteve shkencore për Sistemet te bimët dhe te njeriu. 	

Situata e të nxënësit nr. 11

Tematika: Sistemet

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla:III	Klasa:VIII		
<p>Projekt. Ora e parë (Koha: 4 orë mësimore)</p>					
<p>Tema mësimore: Ruajtja dhe konservimi i llojeve bimore dhe shtazore</p>					
<p>Situata e të nxënësit:</p>					
<p>Speciet në rrezik zhdukje në Shqipëri</p>					
<p style="text-align: center;">Rezultatet e të nxënësit sipas kompetencave kyçë</p>					
<p>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Nxënësi prezanton temën për ruajtjen e llojeve bimore dhe shtazore në vendin tonë dhe komunikon me shokët e klasës duke përdorur TIK-un dhe mediet e tjera të shkruara elektronike për përgatitjen temës.</p>					
<p>Kompetenca e të menduarit: Nxënësi identifikon burimet e informacioneve të nevojshme për gjetjen e informacionit të saktë mbi ruajtjen e llojeve bimore dhe shtazore në vendin tonë dhe i shfrytëzon ato në mënyrën e duhur për të gjetur shkaqet që çojnë në zhdukjen e llojeve.</p>					
<p>Kompetenca e të nxënësit: Nxënësi bën përpunimin e informacioneve për ruajtjen e llojeve bimore dhe shtazore në vendin tonë, në mënyrë të pavarur dhe efektive, rezultatet e punës i prezanton me shkrim ose me gojë para shokëve dhe mësuesit duke dhënë shpjegime për mënyrën e zgjedhjes dhe të shfrytëzimit të burimeve të informacionit.</p>					
<p>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin: Nxënësi harton një projekt me fazë të menaxhuara mirë (individualisht ose në grup) duke shkëmbyer, konsultuar dhe informuar pjesëtarët e grupit, si dhe duke identifikuar dhe vlerësuar burimet njerëzore, materiale dhe monetare në përputhje me rezultatet e pritshme.</p>					
<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Gjuha dhe komunikimi: Mundëson komunikimin midis nxënësve gjatë diskutimit dhe përshkrimit të koncepteve shkencore. Aftëson nxënësit në përdorimin terminologjisë së fushave të shkencës.</p> <p>Teknologjia dhe TIK: Nxënësi përdor sistemet e duhura kompjuterike për përgatitjen e detyrave duke zbatuar në mënyrë krijuese njohuritë që përbajnjë shkencat kompjuterike dhe mediat digitale për ndërtimin e tabelave, grafikëve dhe përgatitjen e detyrave të ndryshme.</p> <p>Matematika: U siguron nxënësve njohuritë e domosdoshme për një studim shkencor, si dhe për të analizuar dhe vlerësuar rezultatet gjatë studimit mbi ruajtjen e llojeve në vendin tonë.</p>		<p>Burimet:</p> <p>Tabela e zezë/e bardhë; Shkumës/lapustila; Laptop; Informacione nga libri i nxënësit, interneti dhe studime të botuara rrëth llojeve që janë zhdukur dhe janë në rrezik për zhdukje</p>			
<p style="text-align: center;">Metodologja dhe veprimtaritë e nxënësve</p> <p>Stuhi mendimesh</p> <p>Punë në grupe</p> <p>Rrjeti i diskutimit</p>					
<p>Përshkrimi kontekstual i situatës</p> <p>Pelikani kaçurrel është një specie në rrezik për zhdukje. Cilët janë faktorët që përbëjnë rrezik për jetën e tyre? Cilat janë masat për mbrojtjen e tyre?</p>					

Veprimet e kryera për trajtimin e situatës

1-Parashikimi i njohurive-Stuhi mendimesh

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësuesi shkruan në tabelë konceptet: *Konservim i llojeve; Pelikani kaçurrel; Gjeti e paligjshme; Thyerja e vezëve; shtegtim; Ruajtja e habitateve, pakësim i ndotjes; Aktivitet njerëzor; Moratorium përmbrojtjen e kafshëve*. Drejton disa pyetje dhe drejton pyetje për të lidhur temën. Udhëzon nxënësit të diskutojnë për problemet e mësimore dhe përmbledh në tabelë njohuritë kryesore.

2-Veprime paraprake

Mësuesi u prezanton nxënësve rezultatet e të nxënët për temën mësimore dhe burimet, që mund të përdorin për të ndërtuar dhe realizuarin planin e aktiviteteve për projektin.

Nxënësi harton një plan i cili do të realizohet për një periudhë prej 8 muajsh. Ata do të kryejnë një studim përmbrojtjen e kafshëve zhdukjeje në vendin tonë, si dhe faktorët që kanë ndikuar negativisht.

3-Ndërtimi i njohurive-Punë në grupe

Punë në grupe

- Ndahen nxënësit në grupe dhe ndajnë punën;
- Zgjidhen drejtuesit e grupeve dhe hidhen idetë për organizimin e punës;
- Ndahen detyrat për orën e dytë të projektit.

Ky projekt do të nxisë nxënësit që të angazhohen sipas mundësive dhe aftësive që kanë për të bashkëvepruar në grup.

3-Përforcimi i njohurive- Rrjeti i diskutimi

- U njohën me temën e Projektit;
- Formuan grupet e punës;

Ndajnë detyrat për grumbullimin e informacionit shkencor.

Detyrë e pavarur

- Përdorni burime të ndryshme informacioni si teksti mësimor, revista shkencore, internet dhe enciklopedi.

Detyrë shtëpie

Zbatoni strategjitet e grumbullimit të informacionit dhe të regjistrimit me shkrim të të dhënave që grumbullon.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e vlerësuar kur:

- Në orën e parë të projektit përzgjidhet tema, ndahen grupet, përcaktohet drejtuesi i grupit dhe ndahen detyrat për secilin pjesëtar të grupit.
- Nxënësi kuption se çrrëgullimet mjekësore janë sëmundje gjenetike.

Vlerësimi i nxënësit:

Nxënësi vlerësohet:

- për pjesëmarrje aktive në diskutim për temën e përzgjedhur;
- për vlerësimin e situatës bashkëpunim në grup;
- për saktësinë e rezultateve të arritura gjatë eksperimentit.

Situata e të nxënësit nr. 12

Tematika: Diversiteti

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore: 1- Veçoritë e qenieve të gjalla 2-Veçoritë e qenieve të gjalla			
Situata e të nxënësit:			
Rritja e gjallesave dhe sendeve pa jetë			
Rezultatet e të nxënësit sipas kompetencave kyçe			
<p>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Nxënësi prezanton në forma të ndryshme të të shprehurit veçoritë e qenieve të gjalla.</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Nxënësi zbaton mënyrat e të arsyeturit shkencor dhe kupton më mirë informacionin mbi veçoritë e qenieve të gjalla.</p> <p>Kompetenca e të nxënëtit: Nxënësi demonstron shkathtësi të përdorimit të TIK-ut në jetën e përditshme dhe në orën e biologjisë, në përbushjen e kërkesave të ndryshme gjatë të nxënësit si p.sh, për ndërtimin e tabelave ose për gjetjen e informacioneve për veçoritë e gjallesave të ndryshme.</p> <p>Kompetenca personale: Nxënësi merr pjesë në përgatitjen dhe organizimin e një aktiviteti në shkollë apo në komunitet për mbrojtjen e mjedisit natyror dhe atij të krijuar nga njeriu dhe në mënyra të ndryshme kontribuon për zhvillim të qëndrueshëm të tij që gjallesat të ndjehen të sigurta në këtë mjeshtëri.</p>			
Rezultatet e të nxënësit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> Dallon një organizëm të gjallë nga një organizëm i vdekur; Përshkruan veçoritë e qenieve të gjalla. 		Fjalët kyçe: Ushqyerja; rritja, lëvizja, ndjeshmëria, ekskretimi, riprodhimi, frymëmarra	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi: Mundëson komunikimin në mënyrë efektive midis nxënësve duke përdorur terminologjinë shkencore gjatë punës në grup;		Burimet: Teksti mësimor, fletore pune, sende pa jetë, gjallesa të vogla	
Kompetenca e të menduarit: Nxënësi përpunon në mënyrë kritike informacionin në lidhje me veçoritë e qenieve të gjalla dhe jep mendimin e tij gjatë diskutimit në grup.			
Matematika: Interpretimi i dukurive nëpërmjet ndërtimit të tabelave dhe vërteton qartë lidhjen e shkencës së matematikës me shkencat e natyrës.			
Metodologja dhe veprimtaritë e nxënësve			
Parashikimi me terma paraprakë Sistemi ndërveprues i shënimeve - INSERT		Veprimitari praktike Diskutim	
Përshkrimi kontekstual i situatës Është i njojur eksperimenti për rritjen e kristaleve të kripës. Merrni pak ujë çezme, hidheni në një			

enë të pastër dhe në të tretni shumë kripë gjelle dhe vlojeni. Pasi tretësira të ftohet, futeni në një kavanoz shumë të pastër. Lidhni në një laps një fill spango dhe futeni në kavanozin me tretësirë kripe. Vendoseni enën në një vend të qetë me temperaturë të ulët dhe në hije dhe mbulojeni enën me një letër filtri. Pas disa ditësh do shikoni se rrith fijes së spangos rriten kristale kripe.



Cila është ngjashmëria dhe ndryshimi midis rritjes së kristaleve të kripës dhe rritjes së vajzës?

Veprimet e kryera për trajtimin e situatës

1-Parashikimi i njojurive - Parashikimi me terma paraprakë

Mësuesi shkruan në tabelë fjalët kyç: *Ushqyerja; Rritja; Lëvizja; Ndjeshmëria; Ekskretimi; Riprodhimi; Frymëmarrja*; Udhëzon nxënësit të shkruajnë një tregim të shkurtër që përmban këto fjalë. Pas 4-5 minutash u kërkon disa prej nxënësve të lexojnë krijimin e tyre.

2-Ndërtimi i njojurive – Sistemi ndërveprues i shënimave – INSERT

Nxënësit hapin librin, lexojnë informacionin *dhe përqendrohen te veçoritë e qenieve të gjalla* duke vendosur shenjat e teknikës **INSERT**.

Këto shenja janë:

Një “√” (kontrollo) - shënon këtë simbol nëse një informacion që nxënësi lexon e di ose mendon se e di.
Një “-“ (minus) - shënon këtë shenjë nëse një apo disa informacione që lexojnë kundërshtojnë ose janë ndryshe nga ato që mendojnë se dinë.

Një “+” (plus) - shënon këtë shenjë nëse një pjesë e informacionit është e re për nxënësit.

Një “?” (pikëpyetje) - shënon këtë shenjë nëse një pjesë e informacionit që nxënësi lexon është i paqartë ose i duhet të dinë më shumë rrith tij.

Nxënësi plotëson tabelën:

√	-	+	?
-Një njeri i gjallë merr frysë dhe i dëgjohen rrahjet e zemrës në kraharor.	-Bimët nuk marrin frysë si njeriu dhe nuk kanë zemër, megjithatë ato janë qenie të gjalla.	-Ekskretimi - Nxjerrja jashtë e mbetjeve të frysëmarrjes si dioksidi i karbonit. Frymëmarrja - Procesi ku ushqimi zbërthehet brenda qelizave dhe çliron energji.	- Ushqyerja - Bimët ushqehen me anë të fotosintezës kurse kafshët ushqehen me bimë ose me mish. - Ndjeshmëria - qeniet e gjalla janë të ndjeshme ndaj mjedisit rrethues. - Riprodhimi - qeniet e gjalla mund të lindin të vegjël.

Nxënësi pasi përfundon së lexuari informacionin në tekston, pushon për një moment dhe reflekton për informacionin që lexi. Ai diskuton me shokët në grup për informacionin që lexi. Mësuesi së fundi drejton këto pyetje: *Cilat njouri të cilat ju i njihnit më parë, janë pohuar gjatë leximit? Cili është informacioni i ri që ju morët? Çmendeni për veçoritë e qenieve të gjalla që i dallojnë ato nga sendet pa jetë?*

Nxënësit u japid përgjigje pyetjeve. Nga kjo veprimitari synohet që nxënësi të rritë shkallën e të kuptuarit dhe të nxënët gjatë orës së mësimit.

3-Përforcimi i njohurive –Veprimitari praktike (E gjalla nga jo e gjalla).

Mësuesi udhëzon nxënësit se këtë veprimitari duhet ta kryejnë në një mjedis përreth shkollës: Vizatoni një tabelë me tri kolona. Në krye të çdo kolone shkruani:

<i>Gjallesa ose sende jo të gjalla</i>	Është i gjallë tanë.	Ishte i gjallë por tanë është i vdekur.	Nuk ka qenë asnjëherë i gjallë.	

Nxënësit duhet të gjejnë të paktën disa gjallesa dhe disa sende pa jetë.

Vlerësimi i situatës:

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi:

- Përshkruan se ngjashmëria midis eksperimentit me kripën dhe vajzës është se të dyja rriten dhe dallon se rritja e kripës është artificiale kurse rritja e vajzës është natyrale;
- Shpjegon se dallimi midis vajzës dhe kripës është se vajza kur të rritet mund të sigurojë vazhdimësinë e brezit të ri kurse kripa nuk e gjeson këtë veçori.

Vlerësimi i nxënësit:

Nxënësi vlerësohet:

- për bashkëpunim dhe qëndrim etik gjatë punës në grup;
- për saktësinë me të cilën një nxënës përshkruan veçoritë e gjallesave;

Detyrat dhe puna e pavarur:

Në shtëpi:

Nxënësit punojnë me veprimtarinë 2.1 në faqe 33, fletore pune.

Situata e të nxënëtit nr. 13

Tematika: Diversiteti

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: 1- Mikroorganizmat dhe rritja e tyre 2- Mikroorganizmat dhe rritja e tyre			
Situata e të nxënëtit:			
Mikroorganizmat dhe sëmundjet			
Rezultatet e të nxënëtit sipas kompetencave kyçë			
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Nxënësi shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave, fjalëve, koncepteve të reja duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm për ndërtimin e mikroorganizmave.			
Kompetenca e të menduarit: Nxënësi interpreton në mënyra tiparet e mikroorganizmave dhe			

përshkruan se ato rriten e zhvillohen si pjesë e një mjedisit natyror.

Kompetenca e të nxënëtit: Nxënësi përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën mësimore.

Rezultatet e të nxënëtit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:

Nxënësi:

- Përkufizon çfarë janë mikroorganizmat;
- Klasifikon mikroorganizmat në bazë të veçorive të tyre;
- Përshkruan karakteristikat e baktereve;
- Shpjegon karakteristikat e kërpudhave;
- Vëzhgon ndërtimin e algave dhe të njëqelizorëve;

Fjalët kyçe:

Mikroorganizma, qeliza, baktere, kërpudha, alga, protozoarë

Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:

Gjuha dhe komunikimi: Mundëson komunikimin në mënyrë efektive midis nxënësve duke përdorur terminologjinë shkencore gjatë punës në grup;

Shkencat shoqërore: Nëpërmjet tyre nxënësi merr informacion mbi historitë e zhvillimit të gjallesave në periudha të caktuara historike. Duke hedhur vështrimin nga e kaluara historike, ai mund të marrë përgjigje si ka evoluar natyra dhe gjallesat.

Teknologjia dhe TIK-u mbështet hetimin e proceseve në fushën e shkencave dhe lehtëson bashkëpunimin e nxënësve me njëri-tjetrin.

Burimet:

Teksti mësimor, fletore pune, koloni bakteresh të rritura në agar, ujë pellgu, lama dhe lamela, mikroskop

Metodologja dhe veprimtaritë e nxënësve

Vëzhgim

Eksperiment

Punë në grupe

Kllaster

Përshkrimi kontekstual i situatës:

Teani zakonisht hante fruta të palara. Një ditë ai u sëmur rëndë dhe përjetoi disa probleme shëndetësore në organizmin e tij. Cilat mikroorganizma mund të jetojnë në frutat e palarë? Çfarë mund të ketë ndodhur me organizmin e tij?

Veprimet e kryera për trajtimin e situatës

Parashikimi i njohurive -Vëzhgim në mikroskop

Mësuesi përgatit preparate:

1. Merr pak ujë të ndenjur nga një pellg dhe e përdor për të përgatitur një preparat me mikroorganizma të cilët jetojnë në ujë si p.sh, një algë uji ose një mikroorganizmi tjeter që jeton në ujë.
2. Përgatit një preparat me qelizat të majasë;

Pasi nxënësit vëzhgojnë preparatet, mësuesi drejton pyetjet: *Çfarë dallimi vëreni midis një alge dhe një qelize të majasë?*

Nxënësit mbajnë shënim rezultatet në fletore, skicojnë pamjen algës dhe protistëve dhe shpjegojnë tiparet dalluese që vëzhguan.

Mësuesi plotëson se: Alga përmban një pigment me ngjyrë jeshile i cili përthith rrezet e diellit dhe prodhon lëndë ushqimore gjatë procesit të fotosintezës kurse protistët nuk kanë klorofil

dhe nuk mund ta prodhojnë vet ushqimin e tyre.


2-Ndërtimi i njohurive - Tabela e koncepteve

Mësuesi ndan nxënësit në grupe. Secili grup organizon, lexon me kujdes informacionin në tekstin dhe jep sqarimet përkatëse për konceptet e mëposhtme të cilat i plotëson në tabelë.

Mikroorganizmat	Veçoritë e tyre
Bakteret	Bakteret takohen në çdo mjedis. Ato përbëhen nga qeliza të vogla. Çdo bakter është i ndërtuar nga një qelizë e vetme.
Kërpudhat mikroskopike	Kërpudhat mund të janë mikroskopike si majatë e bukës por mund të janë dhe kërpudha të mëdha si kërpudha me kapelë.
Algat	Algat, janë gjallesa që kanë një pigment me ngjyrë të gjelbër.
Protozoarët	Gjallesa shtazore njëqelizore që nuk kanë pigment klorofil.

3-Përforcimi i njohurive - Kllaster

Nxënësi plotëson kllasterin e mëposhtëm për grupet e mikroorganizmave dhe përforcon karakteristikat dhe veçoritë e tyre:



Vlerësimi i situatës:

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi:

- Kuption se ushqimet e palara janë të mbuluara nga mikroorganizma;
- Evidenton se disa mikrogjallesa shkaktojnë sëmundje;

Vlerësimi i nxënësit:

Nxënësi vlerësohet:

- për përdorimin e fjalorit shkencor gjatë orës së mësimit;
- për bashkëpunim dhe qëndrim etik gjatë punës në grup;
- për saktësinë përpunimit të rezultateve të vëzhuara në mikroskop ;

Detyrat dhe puna e pavarur:

Në klasë:

Skicon pamjen e mikrogjallesave që vëzhuuan në mikroskop.

Situata e të nxënësit nr. 14

Tematika: Diversiteti

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla: III	Klasa: VII		
Tema mësimore: 1-Mikroorganizmat dhe shpërbërja 2-Mikroorganizmat dhe shpërbërja					
Situata e të nxënësit:					
Të zbulojmë se si vepron temperatura në shpërbërje.					
Rezultatet e të nxënësit sipas kompetencave kyçë					
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj mbi mikroorganizmat si dhe aftësinë e tyre për të zbërthyer lëndën organike duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm shkencor. Kompetenca e të menduarit: Nxënësi përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet midis kushteve në të cilat zhvillohen më mirë mikroorganizmat; Kompetenca e të nxënësit: Ndërlidh temën e re për mikroorganizmat me njohuritë dhe përvojat paraprake duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit; Kompetenca personale: Nxënësi vlerëson përmbytjen e vlerës ushqimore, ndikimin pozitiv dhe negativ të mikroorganizmave në shëndet për llojet e ushqimeve të cilat konsumohen nga njeriu;					
Rezultatet e të nxënësit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> Evidenton mjediset ku jetojnë mikrogjallesat; Përshkruan si përftohen lëndët organike; Përkufizon konceptin shpërbërje; Shpjegon se mikroorganizmat shpërbëjnë mikroorganizmat e vdekur; Tregon se lëndët ushqyese që përftohen nga shpërbërja konsumohen nga bimët; Analizon kushtet në të cilat rriten mikroorganizmat; 			Fjalët kyçë: Mikroorganizma, shpërbërja, shpërbëje		
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi: Mundëson komunikimin midis nxënësve gjatë diskutimit dhe përshkrimit të koncepteve shkencore. Aftëson nxënësit në përdorimin terminologjisë në fushën e shkencës. Teknologja dhe TIK: Nxënësi përdor sistemet e duhura kompjuterike përgatitjen e prezantimeve të detyrave duke zbatuar në mënyrë krijuese njohuritë që përmbytjnë shkencat kompjuterike dhe mediat digitale.			Burimet: Teksti mësimor, mjete shkrimi dhe lapsa me ngjyra, fletë kartoni		
Metodologja dhe veprimtaritë e nxënësve <table style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="width: 50%; padding: 5px; text-align: center;"> Diskutim i njohurive paraprake Mbajtje e strukturuar e shënimave </td><td style="width: 50%; padding: 5px; text-align: center;"> Punë në dyshe Turi i galerisë </td></tr> </table>				Diskutim i njohurive paraprake Mbajtje e strukturuar e shënimave	Punë në dyshe Turi i galerisë
Diskutim i njohurive paraprake Mbajtje e strukturuar e shënimave	Punë në dyshe Turi i galerisë				
Përshkrimi kontekstual i situatës Emi vendosi dy feta buke në dy mjedise të ndryshme. Fillimisht të dyja fetat e bukës i lagi me ujë, i la për 30 minuta jashtë dhe pastaj i mblodhi me qese plastike. Njëren nga fetat e bukës e					

vendosi në një mjedis të ftohtë në frigorifer kurse fetën tjetër e vendosi në mjedis të ngrohtë. Për disa ditë me radhë ajo i vëzhgoi të dyja fetat e bukës dhe mbajti shënimë. Çfarë ndodhi me fetat e bukës? Cilat ishin kushtet më të përshtatshme për zbërthimin e lëndëve organike në fetat e bukës dhe krijimin e mykut?

Veprimet e kryera për trajtimin e situatës

1-Parashikimi i njojurive-Diskutim i njojurive paraprake

Mësuesi njeh nxënësin me temën të cilën e shkruan në tabelë mikroorganizmat dhe shpërbërja. U kërkon nxënësve të thonë gjithçka që dinë për mikroorganizmat dhe mjediset ku ata jetojnë; Drejton pyetjet: *Cilat ushqime përbajnë lëndë organike? Cilat ushqime mund të shpërbëhen nga mikroorganizmat? Cilat janë mjediset ku jetojnë mikroorganizmat?*


Mësuesi përbledh në tabelë përgjigjet e nxënësve për mjediset ku jetojnë mikroorganizmat.



2-Ndërtimi i njojurive - Mbajtje e strukturuar e shënimave

Ndahen nxënësit në dyshe. Analizojnë informacionin dhe u përgjigjen pyetjeve të drejtuara nga mësuesi: *Çfarë është procesi i shpërbërjes? Kur bëhet shqetësuese procesi i shpërbërjes nga mikroorganizmat? Çfarë shpërbëjnë mikroorganizmat? Cilat janë kushtet në të cilat rriten mikroorganizmat? Në cilat mjedise gjethet shpërbëhen nië shpejt? Shpjegoni një rast kur mikroorganizmat janë të dobishëm? Tregoni përse në ushqimet e paketuara nuk rriten mikroorganizmat?*

Nxënësit lexojnë me kujdes tekstin dhe plotësojnë diagramin me përgjigjet e pyetjeve:



Përforcimi i njojurive -Turi i galerisë

Mësuesi udhëzon nxënësit të përgatitin një poster.

Në këtë poster nxënësi mund të përfshijë:

- lloje të ndryshme mikroorganizmash që marrin pjesë në procesin e shpërbërjes;
- kushtet më të përshtatshme që ndihmojnë procesin e shpërbërjes së lëndëve të ndryshme; Nxënësi paraqet punën e përgatitur në poster; Shpjegon hapat që ndoqën për skicimin e mikroorganizmave që marrin pjesë në zbërthimin e lëndës organike; Vlerëson punën e shokëve në klasë dhe bën vërejtje nëse është e nevojshme; Mësuesi dhe nxënësit përzgjedhin punët më të mira. Mësuesi vlerëson nxënësit për punën e kryer.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e vlerësuar kur nxënësi:

- Shpjegon se kushtet më të përshtatshme për krijimin e mykut të bukës janë lagështia, maledisi i ngrënësira.

Vlerësimi i nxënësit:

Nxënësi vlerësohet:

- për përdorimin e fjalorit të saktë shkencor gjatë orës së mësimit;
- për bashkëveprimin me shokët në grup;
- për saktësinë e përshkrimit të kushteve në të cilat ndodh më mirë zbërthimi i lëndëve organike
- për përgatitjen e posterit më të mirë për mikroorganizmat dhe shpërbërjen.

Detyrë Shtëpie

Kërkon më shumë informacion për shpërbërjen e ushqimeve dhe sëmundjet që shkaktohen te njeriu nga konsumimi i ushqimeve jo të freskëta.

Situata e të nxënëtit nr. 15

Tematika: Diversiteti

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: 1- Mikroorganizmat dhe ushqimi 2-Mikroorganizmat dhe ushqimi			
Situata e të nxënëtit:			
Rëndësia e mikroorganizmave në prodhimin e ushqimeve			
Rezultatet e të nxënëtit sipas kompetencave kyçë			
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Nxënësi shpreh mendimin e tij në lidhje me mikroorganizmat dhe faktorët që ndikojnë në proceset e prodhimit të ushqimit në industrinë ushqimore.			
Kompetenca e të menduarit: Nxënësi analizon, në mënyrë të pavarur, informacionet e marra nga burimet e ndryshme për aktivitetin e mikroorganizmave në prodhimin e lëndëve ushqimore, vlerëson dhe përpunon këtë informacion.			
Kompetenca e të nxënëtit: Nxënësi ndërlidh njohuritë e mëparshme për mikroorganizmat me temën e re mbi mikroorganizmat dhe ushqimin dhe përvojat paraprake duke i përdorur këto njohuri në praktikë.			

Kompetenca personale: Nxënësi demontron vetëbesim dhe shkathtësi personale e ndërpersonale në orën e mësimit dhe përzgjedh mënyrat më efikase për të pasur ushqime të shëndetshme.

Rezultatet e të nxënëtit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:

Nxënësi:

- Përshkruan rolin e mikroorganizmave në industrinë ushqimore;
- Evidenton kushtet e përshtatshme për zhvillimin e majasë së bukës;
- Shpjegon çfarë ndodh me majanë gjatë pjekjes së bukës.

Fjalët kyçë:

Mikroorganizma, ushqimi, industri ushqimore, acidi laktik, maka buke

Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:

Gjuha dhe komunikimi: Mundëson komunikimin midis nxënësve gjatë diskutimit dhe përshkrimit të kushteve që nevojiten për zhvillimin e majasë së bukës;

Gjuhe amtare: Lënda e gjuhës aftëson nxënësit të lexojnë, të shkruajnë dhe të kuptojnë një material shkencor dhe të shprehen saktë me gojë dhe me shkrim.

Teknologjia dhe TIK: Mbështet hetimin e proceseve në fushën e shkencave dhe lehtëson bashkëpunimin e nxënësve me njëri-tjetrin.

Burimet:

Teksti mësimor, mjete shkrimi, enciklopedi dhe burime të tjera informacioni

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Di/Dua të Di/Nxë

Punë në grupe

Bashkëbisedim

Përshkrimi kontekstual i situatës

Në furret e bukës kur përgatitet brumi i bukës, i hidhet maka buke. Majaja ka mikroorganizma të cilat mundësojnë fryrjen e brumit. Cilat janë kushtet për rritjen e majasë dhe cili është roli i saj në fryrjen e bukës?

Veprimet e kryera për trajtimin e situatës

1-Parashikimi i njohurive- Di

Hapi i parë

Mësuesi shkruan në tabelë temën e mësimit: Mikroorganizmat dhe ushqimi; Njeh nxënësit me situatën problemore; U kërkon nxënësve të mendojnë dhe të shkruajnë në fletore çfarë dinë për mënyrën se si mikroorganizmat përdoren në jetën e përditshme për përgatitjen e ushqimeve.

Hapi i dytë

Mësuesi skicon në tabelën: **Di/Dua të Di/Nxë**; U kërkon nxënësve të thonë se çfarë dinë për temën e mësimit.

Hapi i tretë

Mësuesi u kërkon nxënësve të plotësojnë kolonën e parë të tabelës: Di

Di	Dua të Di	Nxë
- Bakteret përdoren për fermentimin e qumështit në kos.		

-Majaja përdoret për fryrjen e brumit të bukës.		
---	--	--

2-Ndërtimi i njohurive- Dua të Di

Hapi i katërt

Mësuesi nxit nxënësit që të lexojnë me kujdes materialin në tekstin mësimor. Udhëzon nxënësit të bëjnë pyetje mbi konceptet kryesore që trajtohen në tekst dhe plotëson kolonën e dytë: Dua të Di

Di	Dua të Di	Nxë
<ul style="list-style-type: none"> - Bakteret përdoren për fermentimin e qumështit në kos. - Majaja përdoret për fryrjen e brumit të bukës. 	<ol style="list-style-type: none"> 1-Si ndikojnë mikroorganizmat në industrinë ushqimore? 2- Përse punëtorët në fabrikat e punimit të qumështit veshin përparëse të bardha? 3- Përse duhet kohë për fryrjen e brumit të bukës? 4-Cilat janë kushtet që mundësojnë zhvillim më të shpejtë të majasë së bukës? 5-Çfarë ndodh me majanë e bukës gjatë pjekjes së bukës? 	

3-Përforcimi i njohurive- Nxë

Hapi i pestë

Nxënësi lexon tekstin në mënyrë individuale.

Mësuesi ndihmon nxënësit për paqartësitë që mund të hasin gjatë leximit të informacionit. Këshillon nxënësit të plotësojnë kolonën e tretë të tabelës: Nxë

Di	Dua të Di	Nxë
<ul style="list-style-type: none"> - Bakteret përdoren për fermentimin e qumështit në kos. - Majaja përdoret për fryrjen e brumit të bukës. 		<ol style="list-style-type: none"> 1-Disa lloje mikroorganizmash kanë një përdorim shumë të gjerë në industrinë ushqimore si P.sh. disa lloje bakteresh shndërrojnë shequerin që gjendet në qumësht, në acid laktik(në kos). Ato ushqehen me shequerin e qumështit. 2-Punonjësit në fabrikat e punimit të qumështit veshin përparëse dhe kapele të bardha për të zvogëluar mundësinë që baktere të tjera nga trupi i tyre të bien në qumësht. 3-Për fryrjen e brumit të bukës duhet kohë sepse majatë prodhojnë dioksid karboni gjatë frymëmarrjes. 4-Majaja e bukës rritet më mirë në temperaturë të ngrohtë. 5-Majaja e bukës është një gjallesë dhe kur buka piqet në temperaturë të lartë, majaja shkatërrohet.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e vlerësuar kur nxënësi:

- Përshkruan kushtet e zhvillimit të majasë së bukës;
- Tregon si ndikon majaja në fryrjen e brumit të bukës.

Vlerësimi i nxënësit:

Nxënësi vlerësohet:

- për shpjegimin e rolit të mikroorganizmave në industrinë ushqimore;
- për mënyrën se si përshkruan kushtet që duhen për zhvillimin e majasë së bukës;
- për bashkëpunim dhe qëndrim etik gjatë punës në grup dhe gjatë diskutimeve për mikroorganizmat dhe rëndësinë e tyre në industrinë ushqimore;

Detyrë shtëpie

Kërkoni informacion për mënyrën se si mikroorganizmat veprojnë në fermentimin e pijeve alkoolike si birra, vera dhe uiski.

Situata e të nxënëtit nr. 16

Tematika: Diversiteti

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla: III	Klasa: VII
<p style="text-align: center;">Tema mësimore: 1. Mikroorganizmat dhe ushqimi 2. Mikroorganizmat dhe ushqimi</p>			
<p>Situata e të nxënëtit:</p>			
Roli i mikroorganizmave në prodhimin e produkteve ushqimore			
<p style="text-align: center;">Rezultatet e të nxënëtit sipas kompetencave kyçë</p>			
<p>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Nxënësi shpreh me fjalë mendimin e tij lidhjen mes organizmave dhe ushqimit.</p>			
<p>Kompetenca e të menduarit: Nxënësi analizon, në mënyrë të pavarur informacionet e marra nga burimet e ndryshme për rëndësinë e mikroorganizmave në jetën e gjallesave dhe vlerëson rëndësinë e tyre për jetën e njeriut.</p>			
<p>Kompetenca personale: Merr pjesë ose udhëheq një grup pune, bashkëpunon me shokët dhe diskuton për rolin e mikroorganizmave në industrinë ushqimore.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënëtit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p>		<p>Fjalët kyçë: Mikroorganizma, bakteret, majaja e bukës, fermentim</p>	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">• Evidenton mikroorganizmat që janë të dobishëm për prodhimin e ushqimit;• Shpjegon ndikimin e mikroorganizmave në industrinë ushqimore;• Analizon përdorimin e baktereve dhe të majasë në prodhimin e produkteve ushqimore.			

<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Gjuha dhe komunikimi: Ndihamon nxënësit për zhvillimin e kompetencës së komunikimit duke përdorur gjuhën dhe terminologjinë e shkencës.</p> <p>Teknologjia dhe TIK: Nxënësi përdor sistemet e duhura kompjuterike përgatitjen e prezantimeve të detyrave duke zbatuar në mënyrë krijuese njohuritë që përmbajnë shkencat kompjuterike.</p>	<p>Burimet:</p> <p>Libri i nxënësit, fletore pune, enë qelqi, kos dhe qumësht, fletë plastike nga fitore, majë buke, miell, uje</p>
<p style="text-align: center;">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p> <p>Diskutim për njohuritë paraprake</p> <p>Punë në grupe</p> <p>Diagrami i Venit</p>	
<p>Përshkrimi kontekstual i situatës</p> <p>Mikroorganizmat jetojnë pothuajse kudo dhe ndikojnë në shumë aktivitete fizike dhe biologjike në Tokë. Ato mund të shihen vetëm nëpërmjet disa pajisjeve të veçanta të cilat janë në gjendje t'i zmadhojnë si mikroskopi. Disa mikroorganizma janë të dëmshëm për shëndetin e njeriut sepse shkaktojnë sëmundje. Disa mikroorganizma të tjerë janë shumë të dobishëm për jetën e njeriut. Si ndikojnë mikroorganizmat në përgatitjen e ushqimeve në jetën e përditshme dhe në industri?</p>	
<p>Veprimet e kryera për trajtimin e situatës</p>	
<p>1-Parashikimi i njohurive – Diskutim për njohuritë paraprake</p> <p>Mësuesi nxit nxënësit të lidhin njohuritë që kanë për bimët me njohuritë e reja. Drejton pyetje që nxënësit të shprehin mendimet e tyre për karakteristikat e mikroorganizmave dhe të diskutojnë për rëndësinë e tyre në përgatitjen e ushqimit në kushte shtëpie dhe në industri.</p> <p>Mësuesi ndan klasën në grupe:</p> <p>Grupi i parë</p> <p>Mësuesi udhëzon nxënësit të shikojnë me kujdes një pamje të baktereve që fermentojnë sheqerin që gjendet te qumështi, në acid laktik.</p> <p>Grupi i dytë</p> <p>Mësuesi u kërkon nxënësve të shikojnë me kujdes majanë e bukës.</p>	
	
<p><i>Bakterë laktobacillus</i></p>	<p><i>Maja buke (kërpudhë njëqelizore)</i></p>
<p>Mësuesi drejton pyetjet: Çfarë vëreni nga këto pamje? Çfarë cilësish të përbashkëta kanë këta mikroorganizma? A dallojnë ato nga njëra-tjetra?</p>	<p>Nxënësit punojnë në grupe dhe diskutojnë mendimet e tyre.</p>
<p>Mësuesi dëgjon mendimet e nxënësve dhe përmbledh njohuritë kryesore në tabelë.</p>	<p>2-Ndërtimi i njohurive – Punë në grupe</p>
<p>Mësuesi udhëzon nxënësit të lexojnë tekstin mësimor, të mbajnë shënimë të rregullta dhe pasi</p>	

të kenë përgatitur materialet të zhvillojnë veprimtarinë e dhënë nga mësuesi:

Grupi i parë-Veprimitari: Përgatitja e kosit

Burimet: kos i freskët, qumësht, gotë sterile, material për të mbuluar kosin.

Nxënësi në fund të veprimitarisë shpjegon përsë është e rëndësishme që gota për përgatitjen e kosit të jetë sterile; Sugjeron pse qumështi duhet lënë në një vend të ngrohtë; Përshkruan ndryshimin që do të vërejnë te qumështi pas disa orësh.


Grupi i parë-Veprimitari praktike-Përgatitja e brumit të bukës

Burimet: maja buke, miell, tretësirë sheqeri, enë të pastër dhe ujë.

Nxënësi në fund të veprimitarisë shpjegon përsë brumi duhet të vendoset në një vend të ngrohtë; Sugjeron se çfarë ndodh me majanë e brumit kur buka piqet.

3-Përforcimi i njohurive-Diagrami i Venit

Nxënësi rishikon dhe shpjegon dallimet midis baktereve dhe kërpudhave dhe plotëson diagramin.



Vlerësimi i situatës:

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi shpjegon rolin e mikroorganizmave në prodhimin e ushqimeve në jetën e përditshme dhe në industrinë ushqimore.

Vlerësimi i nxënësit:

Nxënësi vlerësohet:

- Për saktësinë me të cilën përshkruan rolin e mikroorganizmave në fermentimin e ushqimit.
- Për bashkëpunim dhe qëndrim etik gjatë punës në grup dhe gjatë diskutimeve.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Detyrë shtëpie:

Kërkon informacion nga burime të ndryshme për mikroorganizmat dhe ushqimin.

Situata e të nxënëtit nr. 17

Tematika: Diversiteti

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla: III	Klasa: VII
---------------------------	-----------------	--------------	------------

Tema mësimore: 1. Mikroorganizmat dhe sëmundjet
2. Mikroorganizmat dhe sëmundjet

Situata e të nxënëtit:

Mikroorganizmat që shkaktojnë sëmundje infektive

Rezultatet e të nxënëtit sipas kompetencave kyçë

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Nxënësi komunikon dhe diskuton në grup në mënyrë konstruktive mbi disa nga sëmundjet infektive që shkaktohen nga mikroorganizmat.

Kompetenca e të menduarit: Nxënësi përpunon në mënyrë kritike informacionet përreth

Ilojeve të mikroorganizmave të dëmshëm për shëndetin e njeriut.

Kompetenca e të nxënëtit: Nxënësi përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme për mikroorganizmat dhe i shfrytëzon ato për përgatitjen e detyrave.

Rezultatet e të nxënëtit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:

Nxënësi:

- Identifikon mikroorganizmat e dëmshëm për shëndetin e njeriut;
- Shpjegon se si transmetohen sëmundjet infektive nga një individ te tjetri;
- Tregon përsë antibiotikët nuk mund ta shërojnë gripin;
- Argumenton përsë viruset janë organizma të gjallë.

Fjalët kyçë:

Mikroorganizma,
sëmundje
infektive, baktere,
viruse,
protozoarë,
antibiotikë

Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:

Gjuha dhe komunikimi: Mundëson zhvillimin e kompetencës së komunikimit midis nxënësve duke përdorur gjuhën dhe terminologjinë e shkencës gjatë orës së mësimit.

Teknologjia dhe Tik: Nxënësi përdor sistemet e duhura kompjuterike për përgatitjen dhe prezantimin e detyrave duke zbatuar në mënyrë krijuese njojuritë që përmbajnë shkencat kompjuterike.

Burimet:

Teksti mësimor,
fletore pune,
mjete shkrimi

Metodologja dhe veprimtaritë e nxënësve

Stuhi mendimesh

Tabela e koncepteve

Punë në grupe

Kllaster

Përshkrimi kontekstual i situatës

Disa mikroorganizma mund të shkaktojnë sëmundje te njeriu. Sëmundjet e shkaktuara nga mikroorganizmat quhen sëmundje infektive, kjo do të thotë se ato mund të transmetohen nga një njeri te një tjetër.

Cilat janë disa nga mënyrat e transmetimit të sëmundjeve infektive te njeriu? Cilat janë pasojat e sëmundjeve infektive në trupin e njeriut?

1. Parashikimi i njohive- Stuhi mendimesh

Mësuesi shkruan në tabelë konceptet: baktere, viruse, protozoarë dhe nxit nxënësit të përshkruajnë veçoritë e këtyre mikroorganizmave.

Mësuesi drejton pyetjet: *Cilat janë disa nga sëmundjet që shkaktohen nga këta mikroorganizma? Cilat janë mënyrat e transmetimit të sëmundjeve dhe çfarë pasojash shkaktojnë ato në shëndetin e njeriut? Si mund të kurohen sëmundjet infektive?*

Mësuesi dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve dhe përbledh në tabelë mendimet e tyre.

2. Ndërtimi i njohive-Taksonomitë e Blumit

Nxënësi:

- Evidenton mikroorganizmat që shkaktojnë sëmundje;
- Përshkruan mënyrat e transmetimit të sëmundjeve infektive;
- Shpjegon simptomat e disa sëmundjeve infektive;
- Sugjeron se antibiotikët përdoren për të vrarë bakteret;
- Argumenton se viruset janë organizma të gjallë.

- Tregon se Lui Paster ishte i pari shkencëtar i cili solli prova se mikroorganizmat shkaktojnë sëmundje infektive.

3. Përforcimi i njohurive- Kllaster

Nxënësi plotëson kllasterin me disa nga mikroorganizmat që shkaktojnë sëmundje infektive dhe diskutojnë për pasojat që sëmundjet shkaktojnë në shëndetin e njeriut.



Vlerësimi i situatës:

Situata quhet e realizuar kur nxënësi:

- Tregon cilat janë mikroorganizmat që shkaktojnë sëmundje;
- Shpjegon simptomat e sëmundjeve që shkaktohen nga mikroorganizmat.

Vlerësimi i nxënësit:

Nxënësi vlerësohet për:

- Bashkëpunim dhe qëndrim etik gjatë punës në grup dhe gjatë diskutimeve;
- Saktësinë me të cilën nxënësi shpjegon me anë të shembujve sëmundjet që shkaktohen nga mikroorganizmat.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Detyrë shtëpie

Plotësoni ushtrimin 2, fletore pune në faqen 16.

Situata e të nxënëtit nr. 18

Tematika: Diversiteti

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: 1. Qeliza bimore 2. Qeliza bimore			
Situata e të nxënëtit:			
Ndërtimi dhe funksioni i qelizës bimore			
Rezultatet e të nxënëtit sipas kompetencave kyçë			
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Nxënësi shpreh mendimin e vet për ndërtimin e qelizës me gojë ose me shkrim, si dhe me anë të formave të tjera të komunikimit.			
Kompetenca e të menduarit: Nxënësi analizon, në mënyrë të pavarur, informacionet e marra nga burimet e ndryshme për ndërtimin e qelizave bimore dhe vlerëson rëndësinë e tyre.			
Kompetenca e të nxënëtit: Nxënësi bashkëvepron në mënyrë aktive me shokët për realizimin e një aktiviteti të përbashkët në lidhje me ndërtimin dhe funksionin e qelizave bimore.			

Rezultatet e të nxenit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxenësi: <ul style="list-style-type: none"> Identifikon strukturat e një qelize shtazore; Shpjegon funksionin e secilës pjesë të qelizës bimore. 	Fjalët kyçe: Qeliza bimore, muri qelizor, membrana qelizore, citoplazma, bërthama, kromozomet, vakuola qendrore, kloroplastet
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi: Ndihmon nxenësit për zhvillimin e kompetencës së komunikimit në gjuhën dhe terminologjinë e shkencës. Teknologjia dhe TIK: Mbështet hetimin e proceseve në fushën e shkencave dhe lehtëson përgatitjen e detyrave përlendetë e biologjisë.	Burimet: Teksti mësimor, tabela dhe mjete shkrimi, informacione nga interneti, kompjuter

Metodologja dhe veprimtaritë e nxenësve

Stuhi mendimesh

Ditari dy pjesësh

Kllaster


Përshkrimi kontekstual i situatës

Të gjitha qeniet e gjalla janë të përbëra nga struktura të imta që quhen qeliza. Shumica e qelizave janë kaq të vogla saqë nuk mund të shihen me sy të lirë. Ato mund të shihen vetëm me mikroskop. Përshkruani ndërtimin e qelizës.

Veprimet e kryera për trajtimin e situatës

1-Parashikimi i njojurive-Stuhi mendimesh

Mësuesi paraqet në monitor/me fletë formati, një qelizë bimore dhe nxit nxenësit të diskutojnë për ndërtimin e qelizës.



Mësuesi udhëzon nxenësit të lexojnë informacionin në tekstin mësimor dhe të emërtojnë pjesët e qelizës bimore.

2-Ndërtimi i njojurive-Ditari dy pjesësh

I-Puna në dyshe


Mësuesi udhëzon nxenësit të lexojnë tekstin me kujdes që t`a kuptojnë atë dhe të tregojnë funksionin e pjesëve përbërëse të qelizës.

Pjesët përbërëse të qelizës bimore	Shpjegimet për funksionet përkatëse të pjesëve
1-Muri qelizor 2-Membrana qelizore 3-Bërthama 4-Citoplazma	1-Muri qelizor është i ngurtë dhe i fortë dhe i jep formë qelizës bimore. 2-Membrana qelizore rrethon qelizën dhe shërben për shkëmbimin e lëndëve.

5-Vakuola qendrore 6-Kloroplastet	3-Bërthama përmban kromozomet dhe kontrollon veprimtarinë e qelizës. 4-Citoplazma është një lëndë veshtullore ku zhvillohen reaksionet kimike. 5-Vakuola është e mbushur më një lëng që përmban tretësirë shekeri që quhet lëng qelizor. 6-Kloroplastet shërbejnë për përgatitjen e ushqimit.
--------------------------------------	--

3-Përforcimi i njohurive-Kllaster

Nxënësi plotëson kllasterin me pjesët kryesore të qelizës bimore dhe shpjegon funksionet e tyre.



Vlerësimi i situatës:

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi:

- Përshkruan ndërtimin e qelizës bimore dhe përshkruan funksionet e secilës pjesë.

Vlerësimi i nxënësit:

Nxënësi vlerësohet për saktësinë me të cilën shpjegon ndërtimin e qelizës bimore.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Detyrë shtëpie:

Skiconi qelizën bimore. Emërtoni pjesët dhe tregoni funksionin e secilës organelë.

Situata e të nxënëtit nr. 19

Tematika: Diversiteti

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: 1. Qeliza shtazore 2. Qeliza shtazore			

Situata e të nxënëtit:

Ndërtimi dhe funksioni i qelizës shtazore

Rezultatet e të nxënëtit sipas kompetencave kyçë

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Nxënësi shpreh mendimin e vet për ndërtimin e qelizës me gojë ose me shkrim, si dhe më anë të formave të tjera të komunikimit.

Kompetenca e të menduarit: Nxënësi analizon, në mënyrë të pavarur, informacionet e marra nga burimet e ndryshme për ndërtimin e qelizave shtazore dhe vlerëson rëndësinë e tyre.

Kompetenca e të nxënëtit: Nxënësi bashkëvepron në mënyrë aktive me shokët për realizimin e një veprimtarie të përbashkët në lidhje me ndërtimin dhe funksionin e qelizave shtazore.

<p>Rezultatet e të nxenit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxenësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> Identifikon strukturat e një qelize shtazore; Krahason strukturat e qelizave bimore me ato shtazore. Shpjegon funksionin e secilës pjesë të qelizës shtazore; Tregon karakteristikat e protozoarëve. 	<p>Fjalët kyçe:</p> <p>Qeliza shtazore, membrana qelizore, citoplazma, bërthama, protozoarët, ameba</p>								
<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Gjuha dhe komunikimi: Ndihmon nxenësit për zhvillimin e kompetencës së komunikimit në gjuhën dhe terminologjinë e shkencës.</p> <p>Teknologji dhe TIK: Mbështet hetimin e proceseve në fushën e shkencave dhe lehtëson përgatitjen e detyrave për lëndën e biologjisë.</p>	<p>Burimet:</p> <p>Teksti mësimor, tabela dhe mjete shkrimi, informacione nga interneti, kompjuter</p>								
<p>Metodologji dhe veprimtaritë e nxenësve</p> <p>Stuhi mendimesh</p> <p>Ditari dy pjesësh</p> <p>Diagrami i Venit</p>									
<p>Përshkrimi kontekstual i situatës</p> <p>Të gjitha kafshët janë të përbëra nga qelizat. Askush nuk mund të thotë me saktësi se sa qeliza ka në trupin e njeriut. Përshkruani ndërtimin e qelizës shtazore.</p>									
<p>Veprimet e kryera për trajtimin e situatës</p> <p>1-Parashikimi i njohurive-Stuhi mendimesh</p>									
<p>Mësuesi paraqet në monitor/me fletë formati një qelizë shtazore dhe nxit nxenësit të diskutojnë për ndërtimin e qelizës shtazore. Ai udhëzon nxenësit të lexojnë informacionin në tekstin mësimor dhe të emërojnë pjesët e qelizës shtazore.</p>									
<p>2-Ndërtimi i njohurive-Ditari dy pjesësh</p> <p>I-Puna në dyshe</p>									
<p>Mësuesi udhëzon nxenësit të lexojnë tekstin me kujdes që t'a kuptojnë atë dhe të tregojnë funksionin e pjesëve përbërëse të qelizës.</p>									
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th style="padding: 2px;">Pjesët përbërëse të qelizës shtazore</th> <th style="padding: 2px;">Shpjegimet për funksionet përkatëse të pjesëve</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td style="padding: 2px;">1-Membrana qelizore</td> <td style="padding: 2px;">1-Membrana qelizore rrethon qelizën dhe shërben për shkëmbimin e lëndëve ushqyese.</td> </tr> <tr> <td style="padding: 2px;">2-Bërthama</td> <td style="padding: 2px;">2-Bërthama kontrollon veprimtarinë e qelizës.</td> </tr> <tr> <td style="padding: 2px;">3-Citoplazma</td> <td style="padding: 2px;">3-Citoplazma është lëndë veshtullore ku vendosen organelet.</td> </tr> </tbody> </table>		Pjesët përbërëse të qelizës shtazore	Shpjegimet për funksionet përkatëse të pjesëve	1-Membrana qelizore	1-Membrana qelizore rrethon qelizën dhe shërben për shkëmbimin e lëndëve ushqyese.	2-Bërthama	2-Bërthama kontrollon veprimtarinë e qelizës.	3-Citoplazma	3-Citoplazma është lëndë veshtullore ku vendosen organelet.
Pjesët përbërëse të qelizës shtazore	Shpjegimet për funksionet përkatëse të pjesëve								
1-Membrana qelizore	1-Membrana qelizore rrethon qelizën dhe shërben për shkëmbimin e lëndëve ushqyese.								
2-Bërthama	2-Bërthama kontrollon veprimtarinë e qelizës.								
3-Citoplazma	3-Citoplazma është lëndë veshtullore ku vendosen organelet.								
<p>3-Përforcimi i njohurive-Diagrami i Venit</p> <p>Nxenësi plotëson diagramin e Venit dhe dallon mes qelizës bimore dhe shtazore.</p> <p style="text-align: center;">Qeliza bimore Të përbashkëtat Qeliza shtazore</p>									

Vlerësimi i situatës:

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi përshkruan ndërtimin e qelizës shtazore dhe përshkruan funksionet e secilës pjesë.

Vlerësimi i nxënësit:

Nxënësi vlerësohet për saktësinë me të cilën shpjegon ndërtimin e qelizës shtazore.

Detyrat dhe puna e pavarur:**Detyrë shtëpie:**

Skiconi qelizën shtazore, emërtoni pjesët dhe tregoni funksionin e secilës organelë.

Situata e të nxënëtit nr. 20**Tematika: Diversiteti**

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: 1- Qelizat, indet dhe organet 2-Qelizat, indet dhe organet			
Situata e të nxënëtit: Ndërtimi hierarkik i organizmave			
Rezultatet e të nxënëtit sipas kompetencave kyçë			
Kompetenca e komunikimit e të shprehurit: Nxënësi zbaton mënyrat e të arsyetuarit shkencor për të treguar ndërtimin hierarkik të organizmave duke u shprehur me fjalor të pasur me terminologji shkencore.			
Kompetenca e të menduarit: Nxënësi përpunon në mënyrë kritike informacionin mbi qelizat, indet dhe organet.			
Kompetenca e të nxënëtit: Demonstron shkathtësi të përdorimit të TIK-ut në situata të ndryshme mësimore si për gjetjen e informacioneve mbi ndërtimin e organizmave nga qelizat, indet, organet dhe sistemet e organeve.			
Rezultatet e të nxënëtit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi:		Fjalët kyçë: Qeliza, inde, organe, sisteme organesh, qeliza nervore, qeliza e qimeve thithëse	
<ul style="list-style-type: none"> Tregon se qelizat mund të grupohen dhe specializohen për të kryer funksione të ndryshme; Përshkruan ndërtimin e qelizave të ndryshme; Shpjegon funksionet e qelizave të ndryshme. 			
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi: Mundëson komunikimin midis nxënësve duke përdorur terminologjinë shkencore në gjuhën e folur ose të shkruar për qelizat indet, organet, sistemet e organeve dhe organizmin. TIK-u mbështet hetimin e proceseve në fushën e shkencave dhe lehtëson bashkëpunimin e nxënësve me njëri-tjetrin.		Burimet: Teksti mësimor, fletore pune informacione nga interneti, kompjuter	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Brainstorm-Prezantim me PowerPoint

Tabela e koncepteve

Organizues grafik i përgjigjeve

Përshkrimi kontekstual i situatës

Kafshët dhe bimët janë të përbëra nga shumë qeliza. Qelizat e ndryshme kryejnë funksione të ndryshme.

Çdo qelizë specializohet për të kryer një funksion të veçantë. Qelizat që kryejnë funksione të veçanta kanë dhe ndërtim të veçantë. Qelizat janë përshtatur për të kryer sa më mirë funksionin e tyre.

Shpjegoni ndërtimin hierarkik të organizmave bimorë dhe shtazorë.

Veprimet e kryera për trajtimin e situatës

1-Parashikimi i njohive-Stuhi mendimesh

Mësuesi shkruan në tabelë konceptet qeliza, inde, organe, sisteme organesh dhe organizëm dhe nxnit nxënësit të shprehin mendimin e tyre për mënyrën se si është ndërtuar një organizëm bimor dhe shtazor.

Ndërtimi i njohive-Tabela e koncepteve

Mësuesi udhëzon nxënësit të lexojnë informacionin dhe të plotësojnë tabelën e koncepteve.

Konceptet kryesore	Shpjegimet përkatëse
1-Qelizë	1-Njësia më e vogël e organizmave quhet qelizë.
2-Rruazat e kuqe	2-Rruazat e kuqe transportojnë oksigen në pjesë të ndryshme të trupit.
3-Hemoglobina	3-Hemoglobina është një substancë me ngjyrë të kuqe që shërben për transportin e oksigjenit.
4-Qelizat nervore	4-Qeliza nervore është njësia më e vogël e sistemit nervor e cila transmeton impulsen nervore.
5-Qimet thithëse të rrënëjëve	5-Qimet thithëse që dalin nga rrënjet e bimëve thithin ujin dhe kripërat minerale.
6-Ind	6-Grup qelizash me origjinë, ndërtim dhe funksion të njëjtë.
7-Organ	7-Inde të ndryshme bashkohen për të formuar një organ.
8-Sistem organesh	8-Organet bashkohen për të formuar sisteme organesh.

3-Përforcimi i njohive: Organizues grafik dhe diskutim

Nxënësi Plotëson grafikun me konceptet për ndërtimin hierarkik të një organizmi dhe diskuton për veçoritë e tyre.



Vlerësimi i situatës:

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi shpjegon ndërtimin hierarkik të gjallesave.

Vlerësimi i nxënësit:

Nxënësi vlerësohet për saktësinë me të cilën një nxënës përshkruan ndërtimin e gjallesave nga qeliza-indet-organet-sistemet e organeve.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Në klasë nxënësi punon ushtrimin 8 në faqe 22, fletore pune.

Situata e të nxënëtit nr. 21**Tematika: Ndërveprimet**

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla: III	Klasa: VII		
Tema mësimore: 1. Përshtatja e organizmave të gjalla 2. Përshtatja e organizmave të gjalla					
Situata e të nxënëtit: Përshtatja e gjallesave në mjedise të ndryshme					
Rezultatet e të nxënëtit sipas kompetencave kyçë					
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Nxënësi shpreh mendimin e tij për mënyrat e përshtatjes së gjallesave në habitate të ndryshme. Kompetenca e të menduarit: Nxënësi analizon, në mënyrë të pavarur, informacionet e marra nga burimet e ndryshme për veçoritë që fitojnë gjallesat për t'u përshtatur në mjedise të ndryshme. Kompetenca personale: Nxënësi demonstron vetëbesim dhe shkathësi personale e ndërpersonele në orën e mësimit, komunikon lirshëm me shokët dhe shkëmben mendime me vlerë.					
Rezultatet e të nxënëtit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> Përshkruan përmes shembujve nga mjedise lokale se si organizmat janë përshtatur për të jetuar në habitatet e tyre. 		Fjalët kyçë: Përshtatje, habitat			
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi: Mundëson komunikimin midis nxënësve gjatë diskutimit dhe përshkrimit të koncepteve shkencore duke përdorur një terminologji të saktë shkencore;		Burimet: Teksti mësimor, fletore pune, informacione nga interneti, kompjuter			
Teknologjia dhe TIK: Mbështet hetimin e proceseve në fushën e shkencave dhe lehtëson bashkëpunimin e nxënësve me njeri-tjetrin.					
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve					
Stuhi mendimesh Prezantim me Power-Point		Pyetja sjell pyetjen Shkrim i shpejtë			
Përshkrimi kontekstual i situatës Peshqit jetojnë në ujë. Ata nuk mund të jetojnë në tokë. Krimbat e tokës jetojnë në dhe. Ata nuk					

mund tē jetojnë nē pemë. Gjirafa jeton nē Savanat e Afrikës. Ajo nuk mund tē jetojë nē akujt e Polit tē veriut.

Përse gjallesat jetojnë nē habitate tē ndryshme?

Veprimet e kryera pér trajtimin e situatës

1-Parashikimi i njohurive-Stuhi mendimesh

Mësuesi fillon veprimitarinë duke treguar disa pamje dhe nxit nxënësit tē diskutojnë rrëth mënyrës se si janë përshtatur këto gjalesa nē habitate tē ndryshme.



Çfarë përshtatshmërisht kanë fituar këto gjalesa pér tē mbijetuar nē habitatet e tyre?

Mësuesi shkruan nē tabelë mendimet e nxënësve. Së bashku diskutojnë pér veçoritë që i mundësojnë gjallesave tē mbijetojnë nē habitate tē ndryshme.

2-Ndërtimi i njohurive- Pjetja sjell pyetjen

Mësuesi udhëzon nxënësit tē hartojnë pyetje. Ai këshillon nxënësit se ka shumë rëndësi që ata tē lidhin informacionet. Në këtë mënyrë materiali bëhet më i kuptueshëm dhe mbahet mend më shumë. U qartëson nxënësve se pyetjet "pse" i nxisin ata tē shtojnë njohuritë që po mësojnë dhe që zoterojnë nē mënyrë që tē zbulojnë një lidhje tē mundshme shkak-pasojë.

Nxënësit:

- Studiojnë tekstin gjithashtu përdorin dhe "mendjen e tyre", pér tē dhënë përgjigje tē sakta.
- Studiojnë informacionin nē dyshe, bëjnë pyetje rrëth informacionit dhe shkëmbnjë mendime me njeri-tjetrin pér t'i dhënë një përgjigje tē mundshme pér pyetjet.
- Ushtrohen nē hartimin e pyetjeve tē sakta dhe tē krijojnë pyetje "pse" përreth informacionit.

FORMULA PËR PËRGJIGJET E PYETJEVE PËRSE

Përse	Përse peshqit mund tē jetojnë nē mjedise ujore? -Përshtatshmëritë që ju mundësojnë peshqve jetën nē ujë janë: -Bishti e ndihmon një peshk tē lëvizë para nē ujë; -Pendët e ndihmojnë tē ruajë drejt peshimin; -Velëzat shërbejnë pér tē thithur oksigenin; -Vija anësore ndijon lëvizjen e ujit rrëth peshkut.	+	Përse mund tē jetojnë kaktuset nē mjediset e nxehta tē shkretëtirës? -Përshtatshmëritë që mundësojnë jetën e kaktuseve nē mjedise tē nxehta janë: -Kaktuset kanë një kërcell tē tultë që shërben pér tē ruajtur ujin; -Kaktuset kanë gjemba që pengojnë kafshët e etura t'i hanë; -Kaktuset kanë rrënje tē gjata tē cilat sigurojnë ujin nē thellësinë e nëntokës.	=	Marrëdhëniet shkak-pasojë -Gjallesat përshtaten tē jetojnë nē habitate tē ndryshme duke përfituar, duke fituar disa veçori tē reja.
--------------	---	----------	---	----------	--

Përforcimi i njohurive-Shkrim i shpejtë

Mësuesi udhëzon nxënësit që duke parë figurat në monitor të shkruajnë një paragraf të shkurtër duke përdorur fjalor të pasur shkencor në lidhje me përshtatshmërinë e gjallesave në habitate të ndryshme.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e vlerësuar kur nxënësi arsyeton drejt për situatën e dhënë dhe jep një përgjigje të argumentuar për përshtatshmërinë e gjallesave në habitate të ndryshme.

Vlerësimi i nxënësit:

Nxënësi vlerësohet për mënyrën se si arsyeton dhe bashkëpunon me shokët në grup për të dhënë përgjigje të sakta mbi përshtatjen e organizmave të gjallë.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Detyrë shtëpie:

Ushtrimi 3.1 në fletore pune, faqe 23.

Situata e të nxënëtit nr. 22

Tematika: Ndërveprimet

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: 1. Zinxhirët ushqimorë 2. Zinxhirët ushqimorë			
Situata e të nxënëtit:			
Përse është e nevojshme prania e bimëve për ekzistencën e konsumatorëve?			
Rezultatet e të nxënëtit sipas kompetencave kyçë			
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Nxënësi paraqet mendimin e tij për mënyrën se si kalon energjia nga prodhuesit te konsumatorët.			
Kompetenca personale: Merr pjesë ose udhëheq një grup pune, bashkëpunon me shokët për hartimin e një zinxhiri ushqimor dhe sqaron rolin e gjallesave bimore në formimin e energjisë.			
Rezultatet e të nxënëtit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalët kyçë: Zinxhirë ushqimorë, prodhues, konsumatorë	
Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">• Vizaton dhe modelon zinxhirë të thjeshtë ushqimorë;• Dallon rolin e prodhuesve dhe konsumatorëve në një zinxhir ushqimor.			
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:		Burimet: Libri i nxënësit, fletore pune, informacione nga interneti, kompjuter	
Gjuha dhe komunikimi: Ndihamon nxënësit për zhvillimin e kompetencës së komunikimit në gjuhën dhe terminologjinë e shkencës.			
Teknologjia dhe TIK: Mbështet hetimin e proceseve në fushën e shkencave dhe lehtëson përgatitjen dhe prezantimin e detyrave.			

Metodologja dhe veprimtaritë e nxënësve

Stuhi mendimesh

Ditari dy pjesësh/ Ditarët e të nxënëtit

Ushtrime

Përshkrimi kontekstual i situatës

Njeriu ushqehet me një dietë të pasur me perime, fruta dhe prodhime shtazore. Energjia diellore kalon nga dielli -te bimët dhe më pas te njeriu?

Skiconi një zinxhir ushqimor dhe shpjegoni si rrjedh energjia nga dielli- te bimët dhe në trupin e njeriut

Veprimet e kryera për trajtimin e situatës

1-Parashikimi i njohurive-Stuhi mendimesh

Mësuesi paraqet në monitor/në një fletë formati, një zinxhir ushqimor dhe udhëzon nxënësit që pasi të emërtojnë gjallesat e pranishme në të, të tregojnë rolin e bimëve dhe të gjallesave të tjera.



Mësuesi shënon në tabelë mendimet e nxënësve. Gjatë kësaj kohe nxënësve mund t'i vijnë në mëndje mendime të tjera por edhe mund t'i regjistrohet informacion në kujtesë.

2-Ndërtimi i njohurive-Ditari dy pjesësh/Ditarët e të nxënëtit

Mësuesi udhëzon nxënësit të lexojnë tekstin me kujdes që t'a kuptojnë atë dhe t'iu përgjigjen pyetjeve për konceptet bazë duke plotësuar tabelën.

Konceptet kyçë	Shpjegime përkatëse për konceptet
1. Përse zinxhirët ushqimorë fillojnë me prodhuesit? 2. A mund ta përgatitin vetë ushqimin kafshët? 3. Çfarë quajmë kafshë konsumatore? 4. Çfarë tregojnë shigjetat në një zinxhir ushqimor?	1. Prodhesit, janë bimët të cilat kanë aftësinë të shndërrrojnë energjinë e dritës së diellit në ushqim gjatë procesit të fotosintezës. 2. Kafshët nuk kanë mundësi të përgatisin ushqimin por e marrin të gatshëm nga bimët. 3. Gjallesat që ushqehen me bimë ose me kafshë të tjera quhen gjallesa konsumatore. 4. Shigjetat tregojnë se energjia kalon nga një hallkë në tjetrën në një zinxhir ushqimor.

3-Përforcimi i njohurive-ushtrime

Mësuesi udhëzon nxënësit të modelojnë zinxhirë ushqimorë. Ai i nxit nxënësit të bëjnë dallimin midis rolit të prodhuesve dhe konsumatorëve në një zinxhir ushqimor. Udhëzon nxënësit të tregojnë se si kalon energjia nga një hallkë në tjetrën në një zinxhir ushqimor.

Vlerësimi i situatës:

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi modelon një zinxhir ushqimor dhe tregon si kalon energjia nga prodhuesit te konsumatorët.

Vlerësimi i nxënësit:

Nxënësi vlerësohet për saktësinë me të cilën modelon zinxhirë ushqimorë dhe përshkruan rolin e prodhuesve dhe konsumatorëve.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Detyrë shtëpie:

Ushtrimi 5 në faqe 41 të tekstit mësimor.

Situata e të nxënësit nr. 23

Tematika: Ndërveprimet

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla: III	Klasa: VII		
Tema mësimore: 1. Njerëzit dhe zinxhirët ushqimorë 2. Njerëzit dhe zinxhirët ushqimorë					
Situata e të nxënësit: Ndikimi pozitiv dhe negativ i njeriut në mjedis.					
Rezultatet e të nxënësit sipas kompetencave kyçë					
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Nxënësi komunikon dhe diskuton në grup në mënyrë konstruktive për ndikimin e veprimtarisë njerëzore në ruajtjen e llojeve bimore dhe shtazore. Kompetenca personale: Nxënësi diskuton në grup me argumente për rolin pozitiv dhe negativ të veprimtarisë njerëzore, si dhe ndërmerr iniciativa për hartimin e projekteve për ruajtjen e bimëve dhe të kafshëve.					
Rezultatet e të nxënësit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">Diskuton veprimin negativ të njeriut në mjedis;Sjell shembuj të ndikimit të veprimtarisë njerëzore në pakësimin e llojeve për zinxhirët ushqimorë.		Fjalët kyçë: Veprimtaria njerëzore, zinxhirë ushqimorë			
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi: Mundëson zhvillimin e kompetencës së komunikimit midis nxënësve duke përdorur gjuhën dhe terminologjinë e shkencës gjatë orës së mësimit. Shoqëria dhe mjedisi: Nxënësi merr informacion si ka ndryshuar dhe evoluar natyra dhe biodiversiteti i gjallesave si rezultat i veprimtarisë njerëzore. TIK-u mbështet hetimin e proceseve në fushën e shkencave dhe lehtëson bashkëpunimin e nxënësve me njëri-tjetrin.		Burimet: Teksti mësimor; fletore pune, tabela dhe mjete shkrimi			
Metodologja dhe veprimtaritë e nxënësve Diskutim për njohuritë paraprake Punë në grupe Taksonomia e Blumit					
Përshkrimi kontekstual i situatës Paraardhësit tanë e gjenin ushqimin e tyre në natyrë. Ata gjuanin dhe vritnin kafshë. Njerëzit mblidhnin dhe ushqeheshin me manaferra, fara, gjethë dhe rrënëjë bimësh që rriteshin pranë vendbanimit të tyre. Gjuetarët harxhonin energji për të gjetur dhe vrarë prenë. Ata nuk i vrisnin të gjitha kafshët. Shpjegoni qëndrimin pozitiv të gjuetarëve të lashtësisë ndaj kafshëve?					

Veprimet në situatë

1-Parashikimi i njohurive - Diskutim për njohuritë paraprake

Pasi nxënësit njihen me situatën problemore, mësuesi i nxit të diskutojnë për sjelljen e gjuetarëve të lashtësisë. Njëkohësisht mësuesi ju tregon disa pamje të tjera në monitor/në fletë formati, për ndikimin negativ të veprimitarës njerëzore në mjedis dhe nxit diskutimin e mëtejshëm të nxënësve.



Mësuesi mban shënim në tabelë përgjigjet e nxënësve dhe plotëson njohuritë e tyre me informacione nga burime të ndryshme.

2-Ndërtimi i njohurive- Taksonomia e Blumit

Nxënësi:

- Tregon se njeriu duke shpyllëzuar tokat pyjore për mbjelljen e bimëve të reja, çon në zhdukjen e shumë prodhuesve që mund të ishin hallka e parë e zinxhirëve ushqimorë.
- Shpjegon se gjallesat që jetonin dikur në pyjet e prera, u zhdukën ose migruan në vende të tjera sepse nuk mund të gjenin më ushqim duke dëmtuar hallkat e zinxhirëve ushqimorë.
- Përshkruan se edhe kur njeriu peshkon pa kriter në mjediset ujore ndikon negativisht në zinxhirët ushqimorë sepse pakëson ushqimin e zogjve detarë.
- Analizon se cilat lloje kafshësh janë zhdukur dhe po zhduken edhe sot si rezultat i gjuetisë pa kriter nga njeriu.
- Argumenton se në qoftë se njeriu nuk tregohet i kujdesshëm, veprimitaria e tij do të ndikojë negativisht në ekzistencën e shumë llojeve.

3-Përforcimi i njohurive-Ushtrime

Nxënësi punon me ushtrimin 3.3 në faqen 25, në fletoren e punës.

Vlerësimi i situatës:

Situata quhet e realizuar kur nxënësi:

- Mëson se njeriu ka forcën e jashtëzakonshme për ta mbrojtur por edhe për ta shkatërruar biodiversitetin bimor dhe shtazor.
- Shpjegon përsë qdo veprimitari njerëzore ndikon negativisht te gjallesat që jetojnë në mjediset rreth nesh.

Vlerësimi i nxënësít:

Nxënësi vlerësohet për saktësinë me të cilën diskuton përsë veprimitaria njerëzore mund të prekë gjallesat bimore dhe shtazore që jetojnë rreth nesh.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Detyrë shtëpie

Bëni një kërkim shkencor mbi ndikimin e veprimitarës njerëzore në vendbanimin e tyre. Të dhënat e kërkimit paraqitini me shkrim ose në një formë posteri.

Situata e të nxënësit nr. 24

Tematika: Ndërveprimet

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla: III	Klasa: VII		
<p style="text-align: center;">Tema mësimore: 1-Ndotja 2-Ndotja</p>					
Situata e të nxënësit:					
Ndikimi i njeriut në ndotjen e mjedisit					
Rezultatet e të nxënësit sipas kompetencave kyçë					
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Nxënësi zbaton mënyrat e të arsyetuarit shkencor dhe tregon se veprimtaria njerëzore ndikon në ndotjen e mjedisit.					
Kompetenca e të nxënësit: Nxënësi mëson se nëse ndotja e mjedisit nuk do të reduktohet, pasojat do të jenë fatale përmëdha e njësia e mjedisit.					
Rezultatet e të nxënësit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalët kyçë: Ndotje; dioksid karboni, dioksid squfuri, shiu acid			
Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">Diskuton veprimin negativ të njeriut në mjedis;Sjell shembuj se si ndikon veprimtaria njerëzore në ndotjen e ajrit;Shpjegon se si ndikon prerja ose djegia e pemëve në sasinë e dioksidit të karbonit në atmosferë.					
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi: I ndihmon nxënësit përmes zhvillimin e kompetencës së komunikimit duke përdorur gjuhën dhe terminologjinë e shkencës. Teknologji dhe TIK: Nxënësi përdor sistemet e duhura kompjuterike përmes përgatitjen dhe prezantimin e detyrate. Shoqëria dhe mjedisi: Nxënësi merr informacion si ka ndryshuar dhe evoluar natyra dhe biodiversiteti i gjallesave si rezultat i veprimtarisë njerëzore.		Burimet: Teksti mësimor, fletore pune, informacione nga interneti, revista shkencore ose enciklopedi			
<p style="text-align: center;">Metodologja dhe veprimtaritë e nxënësve</p> <p style="text-align: center;">Parashikimi me terma paraprakë</p> <p style="text-align: center;">Mbajtja e strukturuar e shënimave</p> <p style="text-align: center;">Rrjeti i diskutimit</p>					
Përshkrimi kontekstual i situatës <p>Popullsia botërore po vjen duke u rritur. Njeriu ndikon mbi mjedisin në shumë mënyra. Njeriu hedh në mjedis mbetje që mund të dëmtojnë organizmat e gjallë. Hedhja e mbeturinave të dëmshme në mjedis quhet ndotje.</p> <p>Si ndikon njeriu me veprimtarinë e tij në ndotjen e mjedisit?</p>					
<p>Veprimet e kryera përmes trajtimin e situatës</p> <p>1-Parashikimi i njohurive-Parashikimi me terma paraprakë</p> <p>Mësuesi shkruan në tabelë disa koncepte nga tema si: mjedis, ndotje dhe veprimtari njerëzore</p>					


dhe i nxit nxenësit të shkruajnë një paragraf të shkurtër duke përdorur fjalorin e mësipërm shkencor. Pas disa minutash mësuesi iu kërkon nxenësve të lexojnë krijimin e tyre.

2. Ndërtimi i njojurive-Mbajtja e strukturuar e shënimeve

Metoda e mbajtjes së shënimeve, nxit nxenësit të lexojnë informacionin në tekstin mësimor dhe mbajnë shënimë.

- Është një parakusht për të mbajtur mend dhe për të nxënë një informacion.
- Është një metodë që i orienton nxenësit për të mbajtur shënimë në mënyrë efikase.
- Siguron mundësi të shumta për nxenësit që të bashkëveprojnë.

Metoda përdor organizues grafik si një mënyrë mjaft e rëndësishme për të paraqitur ide dhe informacione. Organizuesit grafikë u sigurojnë nxenësve një strukturë pamore për të marrë vendime se çfarë duhet të përfshijnë në shënimet e tyre.



3-Përforcimi i njojurive-Diskutim i drejtuar

Nxenësi:

- Përshkruan se rritja e dioksidit të karbonit në atmosferë, pengon largimin e dioksidit të karbonit nga atmosfera.
- Shpjegon se shiu acid shkaktohet nga tretja e gazeve acide si dioksidi i squfurit në atmosferë.

Vlerësimi i situatës:

Situata quhet e realizuar nëse nxenësi:

- Shpjegon se si ndikon njeriu në ndotjen e ujtit dhe të ajrit;
- Parashikon pasojat negative që mund të ndodhin nëse akujt e poleve do të shkrijnë.

Vlerësimi i nxenësit:

Nxenësi vlerësohet për saktësinë me të cilën analizon shkaktarët e ndotjes së mjedisit dhe pasojat negative të ngrohjes globale.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Detyrë shtëpie:

Ushtrimet 3 dhe 4 në fletore pune, faqe 26.

Situata e të nxënësit nr. 25

Tematika: Ndërveprimet

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla: III	Klasa: VII		
Tema mësimore: 1. Pakësimi i ozonit 2. Pakësimi i ozonit					
Situata e të nxënësit: Rëndësia e shtresës së ozonit për shëndetin e njeriut					
Rezultatet e të nxënësit sipas kompetencave kyçë Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Nxënësi shprehet përmes një forme komunikimi, për pasojat negative për jetën e gjallesave në Tokë që shkaktohen nga dëmtimi i shtresës së ozonit dhe veçon çështjet kryesore. Kompetenca e të nxënësit: Nxënësi bën përpunimin e informacioneve për temën e mësimit në mënyrë të pavarur dhe efektive, dhe rezultatet e punës i prezanton me shkrim ose me gojë para të tjerëve, duke dhënë shpjegime për mënyrën e zgjedhjes dhe të shfrytëzimit të burimeve të informacionit.					
Rezultatet e të nxënësit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">Diskuton veprimin negativ të njeriut në mëdus, në ndotjen dhe në çarjen e shtresës së Ozonit;Analizon faktorët që dëmtojnë shtresën e ozonit.		Fjalët kyçë: Shtresa e ozonit, rreze ultravjollcë, gazet cfc			
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi: Mundëson zhvillimin e kompetencës së komunikimit midis nxënësve duke përdorur gjuhën dhe terminologjinë e shkencës. TIK-u: Nxënësi përdor sistemet e duhura kompjuterike për përgatitjen e prezantimeve të detyra praktike dhe projekteve kurrikulare.		Burimet: Teksti mësimor, fletore pune, informacione nga interneti, kompjuter			
Metodologja dhe veprimtaritë e nxënësve Stuhi mendimesh Taksonomitë e Blumit Ushtime					
Përshkrimi kontekstual i situatës Në shtresën e sipërme të atmosferës ndodhet një shtresë gazi, ozoni. Dielli lëshon rreze ultravjollcë. Këto rreze mund të shkaktojnë kancerin e lëkurës dhe të dëmtojnë sytë. Gjithashtu ato mund të dëmtojnë edhe bimët. Shtresa e ozonit i mbron gjallesat e tokës nga rrezatimi i dëmshëm ultravjollcë. Çfarë do të ndodhë nëse shtresa e ozonit dëmtohet?					
Veprimet e kryera për trajtimin e situatës 1-Parashikimi i njohurive-Stuhi mendimesh Mësuesi udhëzon nxënësit të shikojnë me kujdes pamjen në figurën e librit dhe drejton pyetjet: <i>Cilat janë shtresat e atmosferës? A e dini se në shtresën e sipërme të atmosferës, gjendet një shtresë që</i>					

përthith rrezet e dëmshme ultravjollcë?

Mësuesi dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve dhe shënon në tabelë informacionin. Ai plotëson përgjigjet e nxënësve me informacion nga burime të tjera.

2-Ndërtimi i njohurive-Taksonomia e Blumit

Punë në grupe:

Mësuesi ndan nxënësit në grupe dhe i udhëzon të lexojnë me vëmendje informacionin në tekst.

Bazuar në situatë drejton disa pyetje për të nxitur nxënësit të jatin përgjigje.

Kur është konstatuar për herë të parë dëmtimi i shtresës së ozonit? Përse janë të shqetësuar popujt që banojnë në hemisferën jugore, për dëmtimin e vrimës së ozonit? Cilat janë substancat që shkaktojnë vrimën e ozonit?

Nxënësi studion materialin në tekstin mësimor dhe përshkruan shtresat e atmosferës. Ai tregon ku ndodhet shtresa e ozonit.

- Tregon se shtresa e ozonit është dëmtuar mbi Antarktidë.
- Shpjegon se shkaktarët e krijuar të shtresës së ozonit janë substancat CFC.
- Analizon se dëmtimi i mëtejshëm i shtresës së ozonit do të ketë pasoja fatale për njerëzimin.
- Argumenton rëndësinë e mospërdorimit të substancave CFC, për mbrojtjen e shtresës së ozonit.

3-Përforcimi i njohurive-Ushtrime

Nxënësi punon ushtrimin 3.5, në fletore pune, faqe 28. Plotëson grafikun dhe analizon përsë numri i njerëzve të prekur me melanoma pësoi rritje gjatë viteve 1983-2000.

Vlerësimi i situatës:

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi përshkruan se dëmtimi i shtresës së ozonit ka pasoja të rrezikshme për shëndetin e njeriut.

Vlerësimi i nxënësit:

Nxënësi vlerësohet për:

- saktësinë me të cilën përshkruan pasojet e dëmtimit të shtresës së ozonit për gjallesat.
- saktësinë me të cilën shpjegon cilët janë substancat që dëmtojnë shtresën e ozonit.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Detyrë shtëpie:

Pyetja 7 në faqen 47, në tekstin shkollor.

Planifikimi ditor nr. 26

Tematika: Ndërveprimet

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: 1. Ruajtja (konservimi) 2. Ruajtja (konservimi)			

Situata e të nxënës:

Përse mbrojtja e mjedisit është jetike për konservimin e llojeve?

<p style="text-align: center;">Rezultatet e të nxënitet sipas kompetencave kyçe</p> <p>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Nxënësi shpreh mendimin e tij në lidhje me mënyrat e ruajtjes dhe të konservimit të llojeve dhe të mjedisit.</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Nxënësi analizon, në mënyrë të pavarur, informacionet e marra nga burimet e ndryshme dhe argumenton rëndësinë e mbrojtjes së habitateve natyrore nga dëmtimi.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënitet të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan se kujdesi për mjedisin dhe ndihma për mbijetesën e llojeve quhet konservim; • Shpjegon se pakësimi i ndotjes dhe ruajta e habitateve janë shumë të rëndësishëm për konservimin e llojeve. 	<p>Fjalët kyçe: Konservim, ruajtja e habitateve, pakësimi i ndotjes</p>
<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Gjuha dhe komunikimi: Mundëson komunikimin midis nxënësve duke përdorur terminologjinë shkencore gjatë diskutimit për konservimin e llojeve.</p> <p>TIK-u mbështet hetimin e proceseve në fushën e shkencave dhe lehtëson bashkëpunimin dhe komunikimin e nxënësve me bashkëmoshatarët gjatë procesit të të nxënitet.</p>	<p>Burimet: Teksti mësimor, fletore pune, mjete shkrimi</p>
<p>Metodologja dhe veprimtaritë e nxënësve</p> <p>Stuhi mendimesh-Parashikimi me terma paraprakë</p> <p>DRTA-Veprimitari e të Menduarit dhe të Lexuarit të Drejtuar</p> <p>Kllaster</p>	
<p>Përshkrimi kontekstual i situatës</p> <p>Ne jetojmë në Tokë bashkë me miliona qenie të tjera të gjalla. Nëse nuk tregohemi të kujdeshëm, shumë nga veprimtaritë tonë do ta bënë të vështirë mbijetesën e llojeve. Kujdesi për mjedisin dhe ndihma për mbijetesën e llojeve quhet konservim. Cilat janë mënyrat më të rëndësishme për mbrojtjen e mjedisit dhe konservimin e llojeve?</p>	
<p>Veprimet e kryera për trajtimin e situatës</p> <p>1-Parashikimi i njohurive-Parashikimi me terma paraprakë</p> <p>Mësuesi udhëzon nxënësit se parashikimi me terma paraprakë është një metodë që shërben për të nxitur kureshtjen, për të lexuarin aktiv, për të zhvilluar imagjinatën dhe për një kuptim më të mirë të informacionit të ndërtuar gjatë leximit. Kjo metodë e vendos nxënësin në rolin e një zbuluesi me një gjëegjëzë që do të zgjidhë.</p> <p>Mësuesi shkruan në tabelë konceptet: konservim, gjallesa bimore, gjallesa shtazore, habitate dhe udhëzon nxënësit të shkruajnë një paragraf të shkurtër për këto koncepte. Pas pak minutash mësuesi nxit disa nxënës të lexojnë krijimin e tyre.</p> <p>2-Ndërtimi i njohurive-Përbledhja pohim/mbështetje</p> <p>Mësuesi udhëzon nxënësit se kjo metodë vendos një përparësi të veçantë për shprehitë e të menduarit kritik dhe i pajis ata më një strukturë për të analizuar një informacion.</p>	

Mësuesi shkruan në tabelë pohimin:

Pakësimi i ndotjes dhe ruajtja e habitateve janë dy mënyra të rëndësishme për mbrojtjen e mjedisit dhe konservimin e llojeve.

Mësuesi ndan nxënësit në grupe dhe secilit grup i cakton një pjesë teksti që i përbahet strukturës pohim/mbështetje.

Analizon së bashku me nxënësit llojin e mbështetjes së paraqitur.

PËRMBLEDHJA E POHIM/MBËSHTETJE MEKANIZMAT MBROJTËS

Pohim

Pakësimi i ndotjes dhe ruajtja e habitateve janë dy mënyra të rëndësishme për mbrojtjen e mjedisit dhe konservimin e llojeve.

Mbështetje

1.Fakte

Është shumë e rëndësishme të mbajmë mjedisin pastër.

2.Shembuj

- Ne kemi ndaluar përdorimin e CFC-ve;
- Ne duhet të përpinqemi të pakësojmë djegien e lëndëve djegëse, që të pakësohet dioksidi i karbonit në atmosferë;
- Ne mund t'i groposim mbeturinat në vendgrumbullime të ndërtuara me kujdes.
- Ne duhet të përpinqemi të parandalojmë shkatërrimin e habitateve të bimëve dhe kafshëve.

3.Autoriteti i ekspertit


Nëse ne shkatërrojmë habitatin, si për shembull duke prerë pemët, disa lloje mund të mos kenë një vend të përshtatshëm për të jetuar. Në këto kushte ato zhduken.

4. Logjika dhe arsyetimi

Pakësimi i ndotjes dhe ruajtja e habitateve janë dy mënyra të rëndësishme për mbrojtjen e mjedisit.

3-Përforcimi i njohive- Kllaster

Nxënësit një përbledhje të mënyrave të mbrojtjes së mjedisit dhe shkëmbijnë mendime me njëri- tjetrin.



Vlerësimi i situatës:

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi shpjegon mënyrat për mbrojtjen e mjedisit.

Vlerësimi i nxënësit:

Nxënësi vlerësohet për mënyrën si shpjegon se njerëzit duhet të gjejnë mënyra të ndryshme përmbrojtjen e mjedisit dhe konservimin e llojeve.

Detyrat dhe puna e pavarur:**Detyrë shtëpie:**

Ushtrimi 2 në faqen 49, të tekstit mësimor.

Planifikimi ditor nr. 28**Tematika: Ndërveprimet**

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: 1. Burimet e energjisë 2. Burimet e energjisë			
Situata e të nxënëtit: Llojet e burimeve të energjisë			
Rezultatet e të nxënënit sipas kompetencave kyçë			
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Nxënësi shpreh mendimin e tij për shpërhapjen e thjeshtë të molekulave përmes membranës qelizore. Kompetenca e të nxënëtit: Nxënësi parashtron pyetje për të kuptuar më mirë se cilat janë burimet e përtëritshme dhe të paripërtëritshme, studion informacionin që jepet në tekstin mësimor dhe punon për të gjetur përgjigje të sakta për pyetjet e shtruara.			
Rezultatet e të nxënënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> Përshkruan burimet e energjisë në planetin tonë; Bën dallimin mes burimeve të ripërtëritshme dhe jo-të përtëritshme të energjisë. 		Fjalët kyçë: Burime energjie; lëndë djegëse fosile; energji e ripërtëritshme	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi: Mundëson komunikimin midis nxënësve gjatë diskutimit dhe përshkrimit të koncepteve në lidhje me burimet e energjisë duke përdorur një terminologji të pasur shkencore. Teknologjia dhe TIK: Mbështet hetimin e proceseve në fushën e shkencave dhe lehtëson bashkëpunimin e nxënësve me njëri-tjetrin.		Burimet: Teksti mësimor, materiale nga interneti, kompjuter	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Përbledhje e strukturuar e informacionit Mbajtja e strukturuar e shënimeve Diagrami i Venit			

Përshkrimi kontekstual i situatës

Bimët përdorin energjinë e drithës së diellit për të prodhuar ushqim. Gjallesat shtazore përdorin energjinë që marrin nga bimët si ushqim. Mjetet e transportit përdorin karburant për të lëvizur. Pajisjet elektro-shtëpiake funksionojnë me anë të energjisë elektrike. Si klasifikohen burimet e energjisë?

Veprimet e kryera për trajtimin e situatës

1-Parashikimi i njojurive- Përbledhje e strukturuar e informacionit

Mësuesi njeh nxënësit me situatën. Ai shpjegon kuptimin e konceptet burim energjje.

Paraqet në tabelë konceptet lëndë djegëse, fosile dhe nxënësit të diskutojnë për mënyrën e formimit të tyre në Tokë miliona vjet më parë. Mësuesi mban shënim në tabelë mendimet e nxënësve dhe i plotëson ato me informacione shtesë.

2-Ndërtimi i njojurive-Mbajtja e strukturuar e shëнимeve

Mbajta e strukturuar e shënimeve është një metodë mjaft efikase në përvetësimin e dijeve. Mësuesi shpjegon konceptet bazë dhe nxënësi mban shënim në mënyrë të strukturuar në fletore informacionin e dhënë.


Mësuesi shpjegon se në ditët e sotme shfrytëzohen me shpejtësi lëndët djegëse fosile të formuara miliona vjet më parë. Lëndët fosile janë burime energjetike të paripërtëritshme. Një ditë ato do të shterojnë. Disa burime energjje nuk shterojnë. Ato quhen burime të ripërtëritshme. Burime të ripërtëritshme janë burimet e erës, bimët dhe energjia diellore.

Mësuesi udhëzon nxënësit që gjatë punës të jenë të kujdeshëm dhe të mbajnë shënimë.

3-Përforcimi i njojurive-Diagrami i venit

Nxënësit plotësojnë diagramin e Venit dhe bëjnë dallimet mes burimeve të energjisë:

Burimet të ripërtëritshme Të përbashkëta Burime të paripërtëritshme



Vlerësimi i situatës:

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi mëson se burimet e energjisë janë të ripërtëritshme dhe të paripërtëritshme.

Vlerësimi i nxënësit:

Nxënësi vlerësohet përsaktësinë me të cilën shpjegon se cilat burime energjje janë të ripërtëritshme dhe cilat janë të paripërtëritshme.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Detyrë shtëpie:

Pyetjet 4, 5, në faqen 51, të tekstit mësimor.

Planifikimi ditor nr. 29

Tematika: Diversiteti

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla: III	Klasa: VII		
Tema mësimore: 1. Çfarë është lloji? 2. Çfarë është lloji?					
Situata e të nxënësit:					
Llojet riprodhuese dhe joriprodhuese					
Rezultatet e të nxënënit sipas kompetencave kyçë					
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Nxënësi shprehet përmes një forme komunikimi, për llojet dhe veçoritë e tyre. Kompetenca e të menduarit: Nxënësi identifikon burimet e informacioneve të nevojshme dhe i shfrytëzon ato në mënyrën e duhur për klasifikimin e llojeve, duke dhënë shembuj konkretnë.					
Rezultatet e të nxënënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> Përkufizon specien; Dallon llojet riprodhuese nga ato joriprodhuese; Përshkruan kontributin e Lineut në klasifikimin e llojeve. 		Fjalët kyçë: Lloje të ndryshme, lloje riprodhuese, lloje sterile, hibridë			
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi: Mundëson zhvillimin e kompetencës së komunikimit midis nxënësve duke përdorur gjuhën dhe terminologjinë e shkencës. TIK-u mbështet hetimin e proceseve në fushën e shkencave dhe lehtëson bashkëpunimin dhe komunikimin e nxënësve me bashkëmoshatarët gjatë procesit të të nxënëtit.		Burimet: Teksti mësimor, fletore pune, informacione nga interneti, kompjuter			
Metodologja dhe veprimtaritë e nxënësve Stuhi mendimesh-Prezantim në PowerPoint DDM (Di. Dua të di. Mësova) Diagrami i Venit					
Përshkrimi kontekstual i situatës Në territorin e Shqipërisë jetojnë shumë një thundrakë si kuajt dhe gomarët. Mushka është pasardhës që përftohet nga kryqëzimi ndërmjet gomarit dhe pelës. Përse mushka konsiderohet si kafshë sterile?					
Veprimet në situatë <ol style="list-style-type: none"> Parashikimi i njohurive-Stuhi mendimesh-Prezantim në PowerPoint <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="text-align: center;">  <p>Kuaj</p> </div> <div style="text-align: center;">  <p>Gomari</p> </div> <div style="text-align: center;">  <p>Mushka</p> </div> </div>					

Mësuesi njeh nxënësit me situatën problemore dhe i udhëzon ata të përkufizojnë çfarë përfaqëson lloji. Nxënësit japid mendimet e tyre. Mësuesi mban shënim në tabelë mendimet e nxënësve dhe plotëson mendimet e tyre për veçoritë e llojit.


2. Ndërtimi i njojurive- DDM

Mësuesi këshillon nxënësit të lexojnë me kujdes informacionin e dhënë në tekstin. Nxënësi mban shënimë për njojuritë e reja dhe plotëson tabelën.

Di	Dua të di	Mësova
Shkencëtarët i grupojnë organizmat në lloje të ndryshme.	<ol style="list-style-type: none"> Çfarë është lloji? Çfarë janë llojet hibride? Çfarë janë llojet joriprodhuase? Cili ishte kontributi i Lineut në klasifikimin e llojeve? 	<ol style="list-style-type: none"> Lloji përfaqëson një grup organizmash që jetojnë së bashku dhe që kanë aftësinë të kryqëzohen dhe të lindin pasardhës pjellorë. Kur dy kafshë që i takojnë llojeve të ndryshme që çiftohen, ata prodhojnë pasardhës hibridë. Të gjithë hibridët që lindin nga dy lloje të ndryshme, nuk mund të lindin pasardhës. Ato janë kafshë joriprodhuase /sterile. Karl Lineu, përdori për herë të parë klasifikimin dy emëror të llojeve në gjuhën latine p.sh. Homosapiens.

3. Përforcimi i njojurive-Diagrami i Venit

Nxënësi plotëson Diagramin e Venit duke krahasuar llojet riproduhuese me llojet joriproduhuese.



Vlerësimi i situatës:

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi:

- Përkufizon konceptin e llojit.
- Dallon llojet riproduhuese nga llojet joriproduhuese.

Vlerësimi i nxënësит:

Nxënësi vlerësohet për:

- Përdorim të saktë të fjalorit shkencor gjatë orës së mësimit.
- Saktësinë me të cilën krahason llojet riproduhuese nga llojet joriproduhuese.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Ushtrimi 4.1 në faqen 32, fletore pune.

Planifikimi ditor nr. 30

Tematika: Diversiteti

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla: III	Klasa: VII		
Tema mësimore: 1. Llojet dhe llojshmëria e tyre 2. Llojet dhe llojshmëria e tyre					
Situata e të nxënësit:					
Veçoritë e ndryshme të llojeve të njëjtë					
Rezultatet e të nxënënit sipas kompetencave kyçe					
<p>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Nxënësi shprehet përmes një forme komunikimi, për llojet dhe llojshmërinë dhe paraqet llojshmërinë e një grupei organizmash përmes diagramit të dendurisë.</p> <p>Kompetenca e të nxënëtit: Nxënësi bën përpunimin e informacioneve për llojin dhe llojshmërinë, në mënyrë të pavarur dhe efektive. Rezultatet e punës i prezanton me shkrim ose me gojë para të tjerëve, duke dhënë shpjegime për mënyrën e zgjedhjes dhe të shfrytëzimit të burimeve të informacionit.</p>					
Rezultatet e të nxënënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> Përkufizon llojshmërinë; Paraqet llojshmërinë e një grupei organizmash me anë të diagramit të dendurisë. 		Fjalët kyçe: Lloji, llojshmëria, diagrami i dendurisë			
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi: Mundëson zhvillimin e kompetencës së komunikimit midis nxënësve duke përdorur gjuhën dhe terminologjinë e shkencës. TIK-u mbështet hetimin e proceseve në fushën e shkencave dhe lehtëson bashkëpunimin dhe komunikimin e nxënësve me bashkëmoshatarët gjatë procesit të të nxënëtit.		Burimet: Teksti mësimor, fletore pune, informacione nga interneti, kompjuter			
Metodologja dhe veprimitaritë e nxënësve					
Stuhi mendimesh Taksonomitë e Blumit Veprimitari praktike					
Përshkrimi kontekstual i situatës Organizmat që kanë karakteristika të përbashkëta dhe që mund të çiftohen lirisht mes tyre, klasifikohen në të njëjtin lloj. Por individët që i takojnë një lloji të caktuar, nuk janë saktësisht të njëjtë. Mes individëve ka gjithmonë ndryshime. Cilat janë ndryshimet mes shokëve tuaj të klasës?					
Veprimet e kryera për trajtimin e situatës 1-Parashikimi i njohurive-Stuhi mendimesh Mësuesi paraqet në monitor/në fletë formati një pamje nga disa lloje macesh:					

Ai udhëzon nxënësit të shikojnë me kujdes macet dhe të gjejnë dallimet mes tyre.

Mësuesi dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve dhe shënon në tabelë informacionin. Njëkohësisht mësuesi shënon në tabelë mendimet e tyre dhe i plotëson se ndryshimet mes individëve të të njëjtit lloj quhen llojshmëri.



2-Ndërtimi i njohive-Taksonomitë e Blumit

Mësuesi ndan nxënësit në grupe dhe i udhëzon të lexojnë me vëmendje informacionin në tekstin.

Nxënësi:

- Përkufizon konceptet lloj dhe llojshmëri;
- Dallon midis koncepteve lloj dhe llojshmëri e llojeve;
- Liston disa ndryshime që vëren te organizmat që i përkasin të njëjtit lloj;
- Tregon cilat janë tiparet e përbashkëta midis organizmave.
- Analizon ndryshimet mes organizmave, grumbullon të dhënat dhe plotëson tabelën e rezultateve.
- Paraqet llojshmërinë e organizmave përmes diagramit të dendurisë.

3-Përforcimi i njohive-Veprimitaria praktike

Nxënësi:

- Plotëson tabelën.
- Zgjedh pesë veçori që i bëjnë shokët të ndryshëm nga njëri-tjetri por dhe që mund të jenë të matshme.
- Plotëson tabelën e rezultateve me të dhënat e grumbulluara.

Individët	Ngjyra e flokëve	Ngjyra e syve	Masa e këmbës	Gjatësia në cm

Pasi grumbullojnë të dhënat dhe plotësojnë tabelën, nxënësit paraqesin llojshmërinë e veçorive përmes diagramit të dendurisë.

Vlerësimi i situatës:

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi përshkruan se ndryshimet që vihen re mes organizmave që i përkasin të njëjtit lloj, quhen llojshmëri.

Vlerësimi i nxënësit:

Nxënësi vlerësohet për saktësinë me të cilën përshkruan llojshmërinë mes llojeve.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Detyrë shtëpie:

Ushtrimet 4 dhe 2 në faqe 34, në fletoren e e punës.

Planifikimi ditor nr. 31

Tematika: Diversiteti

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla: III	Klasa: VII		
Tema mësimore: 1-Kërkime për llojshmërinë 2-Kërkime për llojshmërinë					
Situata e të nxënësit:					
Më shumë kërkime për llojshmërinë					
Rezultatet e të nxënënit sipas kompetencave kyçë					
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Nxënësi prezanton përmes një forme komunikimi, kërkimet që bën për llojshmërinë e llojeve. Kompetenca e të nxënëtit: Nxënësi bën përpunimin e informacioneve për llojshmërinë e llojeve në mënyrë të pavarrur dhe efektive. Rezultatet e punës i prezanton me shkrim ose me gojë para të tjera, duke dhënë shpjegime për mënyrën e zgjedhjes dhe të shfrytëzimit të burimeve të informacionit.					
Rezultatet e të nxënënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> Përkufizon konceptet interval, mesore dhe modë; Llogarit vlerën mesatare për petalet e lulëdeles; Vizaton diagramin e dendurisë. 		Fjalët kyçë: Interval, mesore, modë, numri mesatar, diagram i dendurisë			
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi: Mundëson zhvillimin e kompetencës së komunikimit midis nxënësve duke përdorur gjuhën dhe terminologjinë e shkencës. TIK-u mbështet hetimin e proceseve në fushën e shkencave dhe lehtëson bashkëpunimin dhe komunikimin e nxënësve me bashkëmoshatarët gjatë procesit të të nxënëtit.		Burimet: Teksti mësimor, fletore pune, mjete shkrimi			
Metodologja dhe veprimtaritë e nxënësve					
Stuhi mendimesh Tabela e koncepteve		Punë në grupe Veprimtari praktike			
Përshkrimi kontekstual i situatës Shpesh, llojshmëria që vihet re në një lloj të caktuar mund të shprehet me numra ose me matje të ndryshme. Veçoritë e organizmave për llojshmërinë i paraqesim me anë të diagramit të dendurisë. Rezultatet e grumbulluara në një studim ne mund t'i shfrytëzojmë për të mësuar më shumë përreth llojshmërisë. Përshkruani gjithçka që mundeni për llojshmërinë e llojeve.					
Veprimet e kryera për trajtimin e situatës 1-Parashikimi i njohurive-Stuhi mendimesh Mësuesi nxit nxënësit të përsëritin konceptet për llojin dhe llojshmërinë. Dëgjon me kujdes					

përgjigjet e nxënësve dhe shënon në tabelë informacionin. U tregon nxënësve se gjatë orës së mësimit do të njihen me më shumë kërkime për llojshmérinë e llojeve.

2-Ndërtimi i njojurive-Tabela e koncepteve

Mësuesi ndan nxënësit në grupe dhe i udhëzon të lexojnë me vëmendje informacionin në tekstin dhe të plotësojnë tabelën me konceptet kryesore dhe shpjegimet përkatëse.

Konceptet kryesore	Shpjegimet përkatëse
1. Interval	1. Interval, quhet shtrirja e një vlere nga numri më i vogël te numri më i madh, p.sh. numri i petaleve nga 17-21.
2. Mesorja	2-Mesorja është vlera e mesme e disa rezultateve.
3. Moda	3-Moda është vlera që takohet më shpesh te disa rezultate të grumbulluara.
4. Numri mesatar	4-Numri mesatar gjendet duke mbledhur të gjitha rezultatet individuale dhe pjesëtohen me numrin e tyre.

3-Përforcimi i njojurive-Veprimitari praktike

Mësuesi u shpérndan nxënësve lule të ndryshme dhe i udhëzon të numërojnë numrin e petaleve të secilës lule, të mbajnë shënim të dhënat dhe të përcaktojnë: intervalin, modën, mesoren, numrin mesatar të petaleve.

Vlerësimi i situatës:

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi kryen më shumë kërkime për llojshmérinë dhe përcakton intervalin, modën, mesoren dhe numrin mesatar të petaleve të luleve?

Vlerësimi i nxënësit:

Nxënësi vlerësohet për saktësinë me të cilën bën më shumë kërkime për llojshmérinë e llojeve.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Detyrë shtëpie:

Ushtrimet 3 dhe 4 në faqe 36, në fletore pune.

Planifikimi ditor nr. 32

Tematika: Diversiteti

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: 1-Klasifikimi i bimëve 2- Klasifikimi i bimëve			
Situata e të nxënëtit: Karakteristikat e bimëve			
Rezultatet e të nxënëtit sipas kompetencave kyçë			
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Nxënësi shpreh mendimin e tij për konceptet që kanë lidhje me klasifikimin e bimëve dhe shpreh me gojë ose me shkrim karakteristikat e secilës klasë të bimëve.			

Kompetenca e të nxënëtit: Nxënësi bën përpunimin e informacioneve për klasifikimin e bimëve në mënyrë të pavarur dhe efektive. Rezultatet e punës i prezanton me shkrim ose me gojë para të tjerëve, duke dhënë shpjegime për mënyrën e zgjedhjes dhe të shfrytëzimit të burimeve të informacionit.

Rezultatet e të nxënëtit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:

Nxënësi:

- Klasifikon bimët në grupe në bazë të veçorive;
- Përshkruan veçoritë e bimëve;
- Dallon bimët me lule dhe pa lule.

Fjalët kyçe:

Bimë; myshqe, fiere, halorë, bimë me lule

Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:

Gjuha dhe komunikimi: Mundëson komunikimin midis nxënësve gjatë diskutimit dhe pëershkrimit të koncepteve shkencore duke përdorur një terminologji të saktë shkencore;

Teknologjia dhe TIK: Mbështet hetimin e proceseve në fushën e shkencave dhe lehtëson bashkëpunimin e nxënësve me njëri-tjetrin.

Burimet:

Libri i nxënësit, fletore pune, informacione nga interneti, kompjuter

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Stuhi mendimesh-Prezantim në PowerPoint

Marrëdhënie pyetje-përgjigje(MP-P)

Diagram Veni

Përshkrimi kontekstual i situatës

Të gjithë organizmat që kanë gjethë të gjelbra dhe që mund të kryejnë procesin e fotosintezës, quhen bimë. Të gjithë organizmat që lëvizin gjithandje dhe ushqehen me organizma të tjerë quhen kafshë. Grupet e bimëve dhe të kafshëve quhen mbretëri. Përshkruani veçoritë e bimëve.

Veprimet e kryera për trajtimin e situatës

1-Parashikimi i njohurive-Stuhi mendimesh

Mësuesi fillon veprimtarinë duke shfaqur në monitor/në fletë formati, disa pamje me lloje të ndryshme bimësh.



Ai u kërkon nxënësve të diskutojnë për tiparet e këtyre bimëve dhe t'i klasifikojnë ato në:

Bimë me lule	Bimë pa lule

2-Ndërtimi i njohurive- Marrëdhënie pyetje-përgjigje(MP-P)

Mësuesi u kërkon nxënësve të lexojnë informacionin e dhënë në tekstin mësimor dhe të

punojnë **në dyshe** për të hartuar pyetje përreth materialit mbi klasifikimin e bimëve dhe të përshkruajnë veçoritë e tyre. Kjo veprimitari i bën nxënësit të ndjehen më të sigurt dhe të vlefshëm gjatë përforcimit të koncepteve dhe diskutimit në grup.

Nxënësit i drejtojnë pyetje njëri-tjetrit dhe japid përgjigje.

Nxënësi 1: Cili është dallimi kryesor mes qelizave bimore dhe shtazore?

Nxënësi 2: Qeliza bimore e prodhon ushqimin me anë të procesit të fotosintezës kurse qeliza shtazore e merr gati ushqimin nga qelizat bimore.

Nxënësi 3: Cilat gjallesa përfshihen në mbretërinë bimore?

Nxënësi 4: Në mbretërinë bimore përfshihen miliona lloje bimësh të gjelbra që ndahen në grupe në bazë të veçorive të tyre.

Nxënësi 5: Cilat janë karakteristikat e përgjithshme të myshqeve?

Nxënësi 6: Myshqet janë bimë të vogla, pa lule që shumohen me anë të sporeve. Kanë gjethë të vogla të gjelbra dhe e prodhojnë vet ushqimin.

Nxënësi 7: Cilat janë karakteristikat e përgjithshme të fiereve?

Nxënësi 8: Fieret, kanë rrënje të thjeshta dhe gjethë që quhen fronde. Fieret riprodhohen me spore dhe janë bimë pa lule.

Nxënësi 9: Cilat janë karakteristikat e përgjithshme të halorëve?


Nxënësi 10: Halorët janë pemë të mëdha me gjethë të gjelbra në formë halash. Janë bimë pa lule dhe riprodhohen me fara.

Nxënësi 11: Cilat janë karakteristikat e përgjithshme të bimëve me lule?

Nxënësi 12: Bimet me lule riprodhohen me fara të cilat riprodhohen brenda luleve.

3-Përforcimi i njohurive-Organizues grafik i koncepteve

Nxënësi plotëson Diagramin e Venit me grupet kryesore të bimëve dhe përshkruan karakteristikat e tyre.



Vlerësimi i nxënësit:

Nxënësi vlerësohet për saktësinë me të cilat përshkruan karakteristikat e bimëve me lule dhe pa lule.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e vlerësuar kur nxënësi përshkruan saktë karakteristikat e bimëve me lule dhe pa lule.

Detyrë shtëpie

Grumbulloni bimë dhe krijoni një herbar.

Planifikimi ditor nr. 33

Tematika: Diversiteti

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla: III	Klasa: VII		
Tema mësimore: 1-Klasifikimi i rruazorëve 2- Klasifikimi i rruazorëve					
Situata e të nxënëtit: Karakteristikat e rruazorëve					
Rezultatet e të nxënënit sipas kompetencave kyçë					
<p>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Nxënësi shpreh mendimin e tij për konceptet që kanë lidhje me rruazorët dhe përshkruan saktë karakteristikat e tyre.</p> <p>Kompetenca e të nxënëtit: Nxënësi bën përpunimin e informacioneve për rruazorët në mënyrë të pavarur dhe efektive. Rezultatet e punës i prezanton me shkrim ose me gojë para të tjerëve, duke dhënë shpjegime për mënyrën e zgjedhjes dhe të shfrytëzimit të burimeve të informacionit.</p>					
Rezultatet e të nxënënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • Përkufizon se rruazorët janë kafshë me shtyllë kurrizore; • Klasifikon rruazorët në grupe; • Shpjegon karakteristikat e rruazorëve. 		Fjalët kyçë: Rruazorë, peshqit, amfibët, zvarranikët, shpendët, gjitarët			
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi: Mundëson komunikimin midis nxënësve duke përdorur terminologjinë shkencore gjatë diskutimit për mekanizmat mbrojtës të trupit të njeriut. TIK-u: Mbështet hetimin e proceseve në fushën e shkencave dhe lehtëson bashkëpunimin dhe komunikimin e nxënësve me bashkëmoshatarët gjatë procesit të nxënëtit, duke përfshirë edhe të nxënët në distancë.		Burimet: Teksti mësimor, fletore pune, mjete shkrimi, informacion nga interneti, kompjuter			
Metodologja dhe veprimtaritë e nxënësve Stuhi mendimesh-Prezantim me PowerPoint Tabela e koncepteve Kllaster					
Përshkrimi kontekstual i situatës Gjallesat ndahen në dy grupe të mëdha në jorr rruazorë dhe rruazorë. Përshkruani karakteristikat e rruazorëve të ndryshëm.					
Veprimet e kryera për trajtimin e situatës 1-Parashikimi i njohurive-Prezantim me PowerPoint/me fletë formati ose pamje të ndryshme. Mësuesi Paraqet disa pamje në monitor për rruazorë të ndryshëm.					



Mësuesi udhëzon nxënësit t'i klasifikojnë kafshët në grupe dhe të përshkruajnë karakteristikat e tyre.

Ai shënon në tabelë mendimet e nxënësve dhe plotëson me informacione të reja.

2-Ndërtimi i njohurive-Tabela e koncepteve

Mësuesi udhëzon nxënësit të lexojnë informacionin në tekstin mësimor dhe të plotësojnë tabelën me grupet e rruazorëve dhe të shpjegojnë karakteristikat e tyre.

Rruazorët	Karakteristikat e tyre
1. Peshqit 2. Amfibët 3. Zvarranikët 4. Shpendët 5. Gjitarët	

3-Përforcimi i njohurive- Kllaster

Nxënësi plotëson kllasterin për klasifikimin e rruazorëve dhe përshkruan karakteristikat e tyre.



Vlerësimi i situatës:

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi shpjegon karakteristikat e rruazorëve.

Vlerësimi i nxënësit:

Nxënësi vlerësohet për saktësinë me të cilën shpjegon karakteristikat e rruazorëve.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Detyrë shtëpie:

Ushtrimi 2 në faqen 63, të tekstit mësimor.

Planifikimi ditor nr. 34

Tematika: Diversiteti

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla: III	Klasa: VII		
Tema mësimore: 1-Klasifikimi i jorruazorëve 2- Klasifikimi i jorruazorëve					
Situata e të nxënëtit: Karakteristikat e jo rruazorëve					
Rezultatet e të nxënënit sipas kompetencave kyçë					
<p>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Nxënësi shpreh mendimin e tij për konceptet që kanë lidhje me jorruazorët dhe përshkruan saktë karakteristikat e tyre.</p> <p>Kompetenca e të nxënëtit: Nxënësi bën përpunimin e informacioneve për rruazorët në mënyrë të pavarur dhe efektive. Rezultatet e punës i prezanton me shkrim ose me gojë para të tjerëve, duke dhënë shpjegime për mënyrën e zgjedhjes dhe të shfrytëzimit të burimeve të informacionit.</p>					
Rezultatet e të nxënënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> Përkufizon se jorruazorët janë kafshë pa shtyllë kurrizore; Klasifikon rruazorët në grupe; Shpjegon karakteristikat e jorruazorëve. 		Fjalët kyçë: Jorruazorë, molusqe, krimba, këmbënyjtuar, insekte, araknidë, krustace			
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi: Mundëson komunikimin midis nxënësve duke përdorur terminologjinë shkencore gjatë diskutimit për mekanizmat mbrojtës të trupit të njeriut. TIK-u mbështet hetimin e proceseve në fushën e shkencave dhe lehtëson bashkëpunimin dhe komunikimin e nxënësve me bashkëmoshatarët gjatë procesit të të nxënëtit, duke përfshirë edhe të nxënëtit në distancë.		Burimet: Teksti mësimor, fletore pune, mjete shkrimi, informacion nga interneti, kompjuter			
Metodologja dhe veprimtaritë e nxënësve Stuhi mendimesh-Prezantim me PowerPoint Tabela e koncepteve Kllaster					
Përshkrimi kontekstual i situatës Gjallesat ndahen në dy grupe të mëdha në jorruazorë dhe rruazorë. Përshkruani karakteristikat e jorruazorëve të ndryshëm.					
Veprimet e kryera për trajtimin e situatës 1-Parashikimi i njohurive-Prezantim me PowerPoint/me fletë formati ose pamje të ndryshme. Mësuesi paraqet disa pamje në monitor për jorruazorë të ndryshëm.					



Mësuesi udhëzon nxënësit t'i klasifikojnë kafshët jorruazore në grupe dhe të përshkruajnë karakteristikat e tyre. Ai shënon në tabelë mendimet e nxënësve dhe plotëson me informacione të reja.

2-Ndërtimi i njohurive-Tabela e koncepteve

Mësuesi udhëzon nxënësit të lexojnë informacionin në tekstin mësimor dhe të plotësojnë tabelën me grupet e jorruazorëve dhe të shpjegojnë karakteristikat e tyre.

Jorruazorët	Karakteristikat e tyre
1.Molusqet 2.Krimbat unazorë 3.Këmbënyjtuarit 4.Insekta 5.Araknidët 6.Krustacet 7.Shumëkëmbëshit	

3-Përforcimi i njohurive- Kllaster

Nxënësi plotëson kllasterin për klasifikimin e jorruazorëve dhe përshkruan karakteristikat e tyre.



Vlerësimi i situatës:

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi shpjegon karakteristikat e jorruazorëve.

Vlerësimi i nxënësit:

Nxënësi vlerësohet për saktësinë me të cilën shpjegon karakteristikat e jorruazorëve.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Detyrë shtëpie:

Ushtrimet 4 dhe 6 në faqen 40, të fletores së punës.

Planifikimi ditor Nr. 35

Tematika: Diversiteti

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla: III	Klasa: VII		
Tema mësimore: 1. Di dhe praktikoj 2. Di dhe praktikoj					
Situata e të nxënësit Përsëritje dhe ushtrime					
Rezultatet e të nxënënit sipas kompetencave kyçë					
<p>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuqtimin e termave të reja duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm shkencor.</p> <p>Kompetenca e të nxënësit: Nxënësi përshkruan llojshmérinë dhe klasifikimin e bimëve dhe kafshëve.</p> <p>Kompetenca personale: Nxënësi merr pjesë ose drejton punën në grup, përgatit projekte, bashkëpunon me shokët dhe shkëmbën mendime gjatë orës së mësimit.</p>					
Rezultatet e të nxënënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> Përkufizon konceptet lloj dhe llojshmëri; Klasifikon bimët dhe përshkruan karakteristikat e tyre; Klasifikon kafshët dhe shpjegon karakteristikat e tyre; Dallon vertebrorët nga jovertebrorët. 		Fjalët kyçë: Lloji, llojshmëri, bimë, kafshë, rruazorë, jorrueazorë			
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: <p>Gjuha dhe komunikimi: Mundëson komunikimin midis nxënësve gjatë diskutimit dhe përshkrimit të koncepteve mbi llojshmérinë duke përdorur një terminologji të pasur shkencore.</p> <p>Teknologjia dhe TIK: Nxënësi përdor sistemet e duhura kompjuterike për përgatitjen dhe prezantimin e detyrave duke zbatuar në mënyrë krijuese njohuritë që përbajnjë shkencat kompjuterike.</p>		Burimet: Teksti mësimor, mjete shkrimi, fletore pune			
Metodologja dhe veprimtaritë e nxënësve Alfabeti i njëpasnjëshëm Punë në grupe Ushtrime					
Veprimet e kryera për trajtimin e situatës 1-Parashikimi i njohurive-Alfabeti i njëpasnjëshëm Mësuesi i jep secilit nxënës një kopje të alfabetit të njëpasnjëshëm të paplotësuar. Kërkon nga nxënësit të shkruajnë një koncept që ka lidhje me informacionin e lëndës së biologjisë të trajtuar në kapitullin e llojshmérise dhe klasifikimit të bimëve dhe kafshëve, sipas shkronjave të alfabetit. U kërkon nxënësve të plotësojnë sa më shumë kuti që të mundën. Pasi secili nxënës plotëson fletën e tij me alfabetin e njëpasnjëshëm, e shkëmbën fletën e tij me shokun që ka pranë dhe ky veprim përsëritet disa herë me radhë.					

A Amfibët Artropodë Araknidë	B Bimë me lule Bohçe	C	Ç	D Diagrami i dendurisë	Dh
E	Ë	F Fiere Fronde Fara	G	Gj Gjethe Gjitarët	H Hibride (lloje) Halorë
I Interval Insekte	J Jorruatorë	K Karboni Komunitet Kafshë Krimba Krustace	L Luspa	L1 Lloje Llojshmëri	M Mesorja Moda Myshqe Mbretëri Molusqe
N Numri mesatar	Nj Njëmijëkëmb ëshi	O	P Peshqit Pendë	Q Qime	R
Rr Rruazorë	S Sterile(lloje) Spore	Sh Shpendët Shumëkëmbësh	T	Th	U
V Velëza	X	Xh	Y	Z Zvarranikët	Zh

2-Ndërtimi i njohurive –Ushtime

Punë në grupe.

Mësuesi ndan nxënësit në grupe dhe i udhëzon të punojnë me ushtime.

Grupi i parë- Ushtrimi 4.2 faqe 66, në tekstin mësimor.

- **Veprimet e kryera për dhënien e përgjigjes së saktë:**

Hapi i parë: Nxënësi lexon me kujdes ushtrimin duke u përqendruar te zinxhiri ushqimor.

Hapi i dytë: Nxënësi shikon figurën dhe duke u bazuar në karakteristikat e kafshës ujore e klasifikon atë në grupin e duhur:

Grupi i dytë- Ushtrimi 4.3 faqe 66, në tekstin mësimor.

- **Veprimet e kryera për dhënien e përgjigjes së saktë:**

Hapi i parë: Nxënësi lexon me kujdes ushtrimin duke u përqendruar në pamjet e papagajve.

Hapi i dytë: Nxënësi lexon situatën problemore të dhënë në ushtrim dhe shpjegon kuptimin e termave habitat dhe lloj. Ai shpjegon nëse papagajtë i përkasin të njëjtë lloj apo llojeve të ndryshme.

3-Përforcimi i njohurive-Ushtrime

- **Veprimet e kryera për dhënien e përgjigjes së saktë:**

Hapi i parë: Nxënësi lexon ushtrimin dhe shikon me kujdes pamjet e bimëve që jepen.

Hapi i dytë: Nxënësi klasifikon bimët në grupet përkatëse dhe përshkruan karakteristikat e tyre.

Vlerësimi i nxënësit

Nxënësi vlerësohet për:

- Saktësinë e shprehjes së koncepteve për llojshmërinë, si dhe klasifikimin e bimëve dhe kafshëve.
- Bashkëpunim dhe qëndrim etik gjatë punës në grup dhe gjatë diskutimeve.

Detyrë e pavarur.

Detyrë shtëpie:

Përgatisni një prezantim në PowerPoint për llojshmërinë e llojeve dhe klasifikimin e bimëve dhe kafshëve.

TREMUJORI I PARË
TEST KONTROLI

EMRI _____

GRUPI A

KLASA _____

1. Njësia bazë strukturore dhe funksionale e gjallesave me jetë është: **(1p)**

- a) organ b) qelizë c) ind d) aparat

2. Si në qelizën bimore dhe qelizën shtazore ndodhen: **(1p)**

- a) membrana, citoplazma, bërthama b) membrana, bërthama, muri qelizor
c) membrana, bërthama, kloroplaste d) membrana, kloroplaste, muri qelizor

3. Grupe indesh të ndryshme që kryejnë një funksion të caktuar formojnë: **(1p)**

- a) sistemin b) organin c) aparat d) organizmin

4. Organizmat e gjallë shfaqin shtatë veçori të jetës. **(3p)**

Cilat prej veçorive të jetës përshkruhen më poshtë?

- a) Çlirimi i energjisë prej molekulave të ushqimit ose përbërësve kimikë të depozituar _____.
b) Largimi i produkteve të tepërtë që formohen brenda qelizave të trupit. _____.
c) Prodhimi i individëve të rinj _____.
d) Organizmat _____. janë ndërtuar nga një numër i madh qelizash.

5. Plotësoni vendet bosh duke vendosur fjalën përkatëse: **(4p)**

- a) Mjedisi natyror ku jeton një organizëm i gjallë quhet _____.
b) Tërësia e organizmave të gjallë që jetojnë së bashku në një habitat të caktuar formojnë _____.
c) Qelizat, të cilat ndërtojnë organizmin tonë kanë forma, funksione dhe madhësi të _____.
d) Organizmat _____. janë ndërtuar nga një numër i madh qelizash.

6. Lidh me shigjetë qelizën me sistemin e organit që e përmban atë. **(4p)**

- | | |
|------------------------|-----------------------------|
| qelizë nervore | sistemi riprodhues |
| rruazë e kuqe e gjakut | sistemi skeletor |
| qelizë kockore | sistemi nervor |
| vezore | sistemi qarkullues i gjakut |

7. Përshkruani se për çfarë janë të specializuara qelizat e mëposhtme: **(2p)**

- a) qelizat epiteliale me qerpikë

- b) qelizat polisadike

8. Plotësoni tabelën e mëposhtme, duke treguar organet e bimëve dhe funksionet e tyre.

(3p)

Organi	Funksioni
Gjethe	
	përthithja e ujit dhe kripërave minerale
Lule	

9. Shpjegoni dallimin midis çifteve të strukturave më poshtë:

(4p)

- a) klorofil dhe kloroplaste

- b) membranë qelizore dhe mur qelizor

10. Tregoni ndryshimet midis sistemit tretës dhe sistemit të jashtëqitjes.

(2p)

11. Në verë, balenat blu e shpenzojnë kohën në ujërat e ftohta polare, ku furnizohen me ushqimin e bollshëm të këtyre ujërave. Në dimër ato zhvendosen drejt ujërave më të ngrohtë, në lartësi më të ulëta, ku mund të çiftëzohen dhe të lindin të veglit e tyre.

- a) Arsyetoni pse balenat nuk qëndrojnë në ujërat polare për t'u shumuar, meqë në këto ujëra ato kanë ushqim të bollshëm.

(2p)

- b) Balenat janë gjitarë. Përshkruani dhe shpjegoni dy përshtatje të tyre për të jetuar në oqean.

(2p)

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-7	8-11	12-15	16-19	20-23	24-26	27-29

EMRI _____

GRUPI B

KLASA _____

1. Organelet qelizore ndodhen: (1p)

- a) në membranën qelizore b) në bërthamë c) në citoplazmë d) në paretin qelizor

2. Bashkësitë e qenieve të gjalla me mjedisin fizik ku ato jetojnë quhet: (1p)

- a) biotop b) ekosistem c) habitat d) bashkësi biologjike

3. Indi është bashkësi qelizash me: (1p)

- a) formë dhe funksion të njëjtë b) funksion të njëjtë por forma të ndryshme
c) formë të njëjtë por funksione të ndryshme d) funksion të papërcaktuar

4. Organizmat e gjallë shfaqin shtatë veçori të jetës. (3p)

Cilat prej veçorive të jetës përshkruhen më poshtë?


- a) Marrje e lëndëve kimike për energji dhe rritje _____.
b) Ndryshimi i pozicionit të një pjese apo të të gjithë organizmit _____.
c) Reagimi ndaj ngacmuesve të ndryshëm _____.

5. Plotësoni vendet bosh duke vendllojë fjalën përkatëse: (4p)

- a) Sipërfaqja e tokës ku jetojnë qeniet e gjalla quhet _____.
b) Organizmat _____ janë ndërtuar nga një qelizë e vetme
c) Qelizat bakteriale kanë një kromozon të vetëm, por nuk kanë _____.
d) Transporti i lëndëve te bimët kryhet nëpërmjet _____.

6. Vendllo strukturat e mëposhtme në rend ngjitës sipas përmasave (5p)

sistem tretës
organizmi
qeliza
stomaku
indi muskular



7. Përshkruani funksionet e strukturave qelizore të mëposhtme: (3p)

- a) bërthamë
-
-
-

- b) citoplazmë
-
-
-

c) vakuolë

8. Tregoni tri veçoritë e qelizës bimore që e bëjnë të dallueshme nga qeliza shtazore. (3p)

- a) _____
b) _____
c) _____

9. Përshkruani se për çfarë janë të specializuara qelizat e mëposhtme: (2p)

- a) rruazat e kuqe të gjakut

- b) qelizat nervore

10. Tregoni ndryshimet midis sistemit qarkullimit të gjakut dhe sistemit të frysëkëmbimit (2p)

11. Shumë lloje zogjsh shpenzojnë një pjesë të vitit në një vend dhe gjatë dimrit fluturojnë në vende të tjera.

a) Shpjegoni përsë zogjtë nuk qëndrojnë në të njëtin vend gjatë dimrit. (2p)

b) Shumë kafshë qëndrojnë në Shqipëri gjatë gjithë periudhës së dimrit. Tregoni përshtatjet e mundshme që mund të përdorin këto kafshë për të mbijetuar në dimër. (2p)

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-7	8-11	12-15	16-19	20-23	24-26	27-29

SUKSESE!

TREMUJORI I DYTË
TEST KONTROLI

EMRI _____

GRUPI A


KLASA _____

Pjesa e parë: Qarkoni përgjigjen e saktë në pyetjet e mëposhtme.

1. Cila nga pjesët e mëposhtme e bën një qelizë bimore të ndryshme nga një qelizë shtazore? (1p)
a) citoplazma b) bërthama c) membrana qelizore d) muri qelizor
2. Cila nga qelizat e mëposhtme është e specializuar për të transportuar oksigjenin në pjesë të ndryshme të trupit? (1p)
a) rruazat e bardha të gjakut b) qelizat nervore c) pllakëzat d) rruazat e kuqe
3. Një zinxhir ushqimor përfundon me një: (1p)
a) prodhues b) shpërbërës c) konsumator d) grabitqar

Pjesa e dytë

1. Emërtoni pjesët e qelizës së mëposhtme. (2p)



2. Përshkruani funksionin e:

- a) murit qelizor (1p)
-
- b) membranës qelizore (1p)
-
- c) citoplazmës (1p)
-
- d) vakuolës qendrore (1p)
-
- e) kloroplasteve (1p)
-

f) bërthamës (1p)

3. Veprimtaria njerëzore ndikon te zinxhirët ushqimorë:

a) peshkimi (2p)

b) futja e llojeve të reja (2p)

4. a) Çfarë janë gazet CFC? (1p)

b) Për çfarë i përdorin njerëzit gazet CFC? (1p)

c) Çfarë veprimi negativ ka ozoni në atmosferë? (2p)

5. Çfarë nismash mund të ndërmarrim për pakësimin e ndotjes? (3p)

a) _____

b) _____

c) _____

6. a) Çfarë quajmë zinxhir ushqimor? (1p)

b) Çfarë quajmë prodhues? (1p)

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	1-5	6-8	9-12	13-15	16-18	19-21	22-24


Suksese në provim

Pjesa e parë: Qarkoni përgjigjen e saktë në pyetjet e mëposhtme.

1. Cila nga pjesët e qelizës bimore shërbejnë për përgatitjen e ushqimit? (1p)
a) citoplazma b) bërthama c) kloroplastet d) muri qelizor
2. Grupe qelizash të ngjashme, të cilat kryejnë një funksion të veçantë quhen? (1p)
a) organe b) qeliza c) inde d) organizëm
3. Një zinxhir ushqimor fillon me: (1p)
a) konsumatorët b) prodhuesit c) grabitqarët d) shpërbërësit

Pjesa e dytë

1. Shikoni vizatimin e zinxhiri ushqimor:



- a) Cila gjallesë e këtij zinxhiri ushqimor është një prodhuese?
Cili është roli i prodhuesit në zinxhirin ushqimor? (2p)

- b) Cilat gjallesa të këtij zinxhiri ushqimor janë konsumatore? (1p)

- c) Çfarë tregojnë shigjetat e zinxhirit ushqimor? (1p)

2. Qelizat shtazore dhe bimore janë të specializuara për të kryer funksione të caktuara:
a) përshkruani ndërtimin dhe funksionin e rruazave të kuqe të gjakut. (2p)

- b) përshkruani ndërtimin dhe funksionin e qelizave nervore (2p)

- c) përshkruani ndërtimin dhe funksionin e qimeve thithëse të rrënjeve: (2p)

3. Çdo gjallesë që ka një sërë veçorish, që e ndihmojnë të përshtatet me jetesën në një habitat të caktuar.

a) tregoni si përshtaten peshqit për jetën në ujë: (2p)

b) tregoni si përshtaten dhelprat e shkretëtirës që të jetojnë në shkretëtirat e nxehta: (2p)

c) tregoni si përshtaten kaktuset që të jetojnë në shkretëtirat e nxehta: (2p)

4. Hedhja e mbeturinave të dëmshme në mjedis quhet ndotje:

a) Shpjegoni si ndikon njeriu me veprimtarinë e tij në ndotjen e ujit? (2p)

b) Shpjegoni si ndikon njeriu me veprimtarinë e tij në ndotjen e ajrit? (2p)

c) Çfarë e shkakton shiun acid? (1p)

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	1-5	6-8	9-12	13-15	16-18	19-21	22-24

Suksese në provim

TREMUJORI I TRETË
TEST KONTROLI

EMRI _____

GRUPI A

KLASA _____

Pjesa e parë: Qarkoni përgjigjen e saktë në pyetjet e mëposhtme.

1. Cili nga burimet e mëposhtme të energjisë, shteron me kalimin e kohës? (1p)
a) era b) bimët c) energjia diellore d) lëndët djegëse fosile
2. Cila nga bimët e mëposhtme kanë gjethë që quhen fronda? (1p)
a) myshqet b) luleshtrydhet c) halorët d) fieret
3. Cili nga rruazorët e mëposhtëm e rrisin embrionin në trupin e tyre? (1p)
a) peshqit b) amfibët c) shpendët d) gjitarët
4. Cili nga jorrzuazorët e mëposhtëm ka tetë këmbë të nyjtuarat? (1p)
a) molusqet b) insektet c) araknidët d) krustacet
5. Emërtimi i gjallesave me dy emra, u bë nga: (1p)
a) Darvini b) Lui Paster c) Eduart Xhener d) Lineu

Pjesa e dytë: Lidhni konceptet me shpjegimet përkatëse.

1. Jepen termat: (5p)
a) interval b) halorë c) diagrami i dendurisë d) velëza e) lëndët djegëse fosile

Lidhni termat me shpjegimet përkatëse.

- | | |
|---|--|
| I. bimë pa lule | II. organet e fryshtës te peshqit |
| III. paraqitura e llojshmërisë së një grupi organizmash | |
| IV. shtrirja e një vlore midis dy numrave | V. burime energjie të paripërtëritshme |

Pjesa e tretë:

1. Shkencëtarët i grupojnë organizmat në lloje të ndryshme.

- a) Çfarë përfaqëson një lloj? Jepni një shembull. (2p)
-
-

- b) Çfarë përfaqësojnë llojet hibride? Jepni një shembull. (2p)
-
-

2. Në mbretërinë bimore përfshihen disa milionë lloje bimësh të ndryshme.

- a) Përshkruani veçoritë e myshqeve. (2p)

- b) Përshkruani veçoritë e bimëve me lule. Jepni një shembull. (2p)

3. Të gjitha organizmat që lëvizin gjithandjej dhe ushqehen me organizma të tjerë, janë kafshë.

Përshkruani veçoritë e:

- a) amfibëve (2p)

- b) zvarranikëve (2p)

- c) krustaceve (2p)

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	1-5	6-8	9-12	13-15	16-18	19-21	22-24

Suksese në provim

EMRI _____

GRUPI B

KLASA _____

Pjesa e parë: Qarkoni përgjigjen e saktë në pyetjet e mëposhtme.

1. Cili nga burimet e mëposhtme të energjisë, nuk shteron me kalimin e kohës? (1p)
a) nafta b) gazi natyror c) qymyri i gurit d) era
2. Cilat nga bimët e mëposhtme janë bimë me lule? (1p)
a) halorët b) myshqet c) fieret d) luleshtrydhet
3. Cili nga rruazorët e mëposhtëm, pjellin të vegjël që ushqehen me qumështin e nënës? (1p)
a) peshqit b) amfibët c) shpendët d) gjitarët
4. Cili nga jorrzuazorët e mëposhtëm kanë trupin të ndarë në tri pjesë (koka, gjoksi, barku)? (1p)
a) molusqet b) insektet c) araknidët d) krustacet
5. Cila nga gjallesat e mëposhtme janë lloje sterile? (1p)
a) kali b) gomari c) ligrat d) ketrat

Pjesa e dytë: Lidhni konceptet me shpjegimet përkatëse.

1. Jepen termat: (5p)
a) energjia diellore b) mesorja c) mbretëri d) moda e) spore

Lidhni termat me shpjegimin përkatës:

- I. është vlera e mesme e rezultateve tuaja. II. shërbejnë për riprodhimin e myshqeve.
III. është vlera që takohet më shpesh në rezultatet tuaja.
IV. quhen grupet e bimëve dhe të kafshëve. V. burime të ripërtëritshme të energjisë.

Pjesa e tretë

1. Organizmat kanë karakteristika të përbashkëta dhe mund të çiftohen mes tyre.

- a) Çfarë quajmë llojshmëri? (1p)
-
-

- b) Jepni një shembull, duke listuar të paktën 2 ndryshime që shprehin llojshmërinë. (2p)
-
-

- c) Përse përdoret diagrami i dendurisë? (1p)
-
-

2. Në mbretërinë bimore përfshihen disa milionë lloje bimësh të ndryshme.

- a) Përshkruani veçoritë e fiereve. (2p)

- b) Përshkruani veçoritë e halorëve. (2p)

3. Të gjitha organizmat që lëvizin gjithandjej dhe ushqehen me organizma të tjerë, janë kafshë. Përshkruani veçoritë e:

- a) peshqve (2p)

- b) molusqeve (2p)

- c) krimbave unazorë (2p)

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	1-5	6-8	9-12	13-15	16-18	19-21	22-24

Suksese në provim

PROJEKT 1

BURIMET E ENERGJISË

BURIMET E ENERGJISË



BURIMET E ENERGJISË

Kur ju jeni të uritur ndiheni të lodhur dhe nuk keni dëshirë të luani e të punoni.

Pse ka nevojë për ushqim trupi juaj?

Ne ushqehemi për të sigruuar energjinë.

Qeniet e gjalla si dhe proceset natyrore të Tokës kanë nevojë për energji.

Burimi kryesor i energjisë në Tokë është dielli.

Kur ju jeni të uritur ndiheni të lodhur dhe nuk keni dëshirë të luani e të punoni.



Pse ka nevojë për ushqim trupi juaj?



Ne ushqehemi për të sigruuar **energjinë**.

Qeniet e gjalla si dhe proceset natyrore të Tokës kanë nevojë për energji.

Burimi kryesor i energjisë në Tokë është dielli.



Dielli është burimi kryesor i energjisë

Energjia diellore mund të shfrytëzohet në shumë mënyra.

Energjia e diellit quhet energji diellore.

Energjia diellore shfrytëzohet më mirë në vendet që kanë më shumë diell.

Energjia diellore ruhet në panelet diellore.

Çfarë do të ndodh me ujin nëse do të vendosnit një gotë në dritaren ku bie dielli?

Për çfarë e përdorim energjinë diellore?

Dielli është burimi kryesor i **energjisë**

Energjia diellore mund të shfrytëzohet në shumë mënyra.

Energja e diellit quhet energji diellore.



Energjia diellore shfrytëzohet më mirë në vendet që kanë më shumë diell.



Energjia diellore ruhet në panelet diellore.

Çfarë do të ndodh me ujin nëse do të vendosnit një gotë në dritaren ku bie dielli?



Për çfarë e përdorim energjinë diellore?

Uji mund të ngrohet nga energjia diellore.

Uji mund tē ngrohet nga energjia diellore.

Energjia diellore është burim natyror.

Kjo do tē thotë që burimi i energjisë gjendet në natyrë.

Energjia diellore nuk është i vetmi burim natyror.

Era dhe uji janë gjithashtu burime natyrore.

Ato mund tē përdoren pér tē prodhuar energji.

Era dhe uji janë burime natyrore.

Energjia e erës mund tē shfrytëzohet pér prodhimin e energjisë elektrike.

Energjia e erës mund tē shfrytëzohet vetëm në vendet ky fryn shumë erë.

Era është burim natyror. Ajo gjendet në natyrë.

Energjia diellore është **burim natyror**.



Kjo do tē thotë që burimi i energjisë gjendet në natyrë.

Energjia diellore nuk është i vetmi burim natyror.



**Era dhe uji janë gjithashtu burime natyrore.
Ato mund tē përdoren pér tē prodhuar energji.
Era dhe uji janë burime natyrore.**

- **Energjia e erës** mund tē shfrytëzohet pér prodhimin e energjisë elektrike.
- **Energjia e erës** mund tē shfrytëzohet vetëm në vendet ky fryn shumë erë.



Era është burim natyror. Ajo gjendet në natyrë.

Uji gjithashtu përdoret për prodhim energjisë elektrike.

Hidrocentralet përdoren për prodhimin e energjisë elektrike nga uji.

Uji gjithashtu përdoret për prodhim energjisë elektrike.



Hidrocentralet përdoren për prodhimin e energjisë elektrike nga uji.

Bimët: burim tjetër i energjisë natyrore

Ne sigurojmë ushqimin nga bimët. Ushqimi siguron energjinë pë trupin tonë.

Bimët: burim tjetër i energjisë natyrore



Ne sigurojmë ushqimin nga bimët. Ushqimi siguron energjinë pë trupin tonë.

Ne përmendëm katër burime natyrore të energjisë:

- dielli
- era
- uji
- bimët

Në natyrë ka edhe burime të tjera energjje

Ne përmendëm katër burime natyrore të energjisë:

- **dielli**
- era**
- uji**
- bimët**



Në natyrë ka edhe burime të tjera energjje

Lëndët djegëse fosile janë një burim tjetër natyror i energjisë.

Lëndët djegëse fosile janë formuar nga mbetjet e bimëve dhe kafshëve që kanë jetuar shumë e shumë kohë më parë.

Me kalimin e kohës mbetjet e bimëve dhe kafshëve të vdekura ndryshojnë dhe shndërrohen në lëndët djegëse fosile.

Disa shëmbuj lëndësh djegëse fosile janë:

- Qymyri
- Benzina
- Gazi natyror
- Nafta

ëndët djegëse fosile janë një burim tjetër natyror i energjisë.



Lëndët djegëse fosile janë formuar nga mbetjet e bimëve dhe kafshëve që kanë jetuar shumë e shumë kohë më parë.

Me kalimin e kohës mbetjet e bimëve dhe kafshëve të vdekura ndryshojnë dhe shndërrohen **në lëndët djegëse fosile.**

Disa shëmbuj lëndësh djegëse fosile janë:



Lëndët djegëse natyrore gjenden nën tokë.

Lëndët djegëse natyrore gjinden nën tokë.



PROJEKT 2

LLOJET E ENERGJISË

LLOJET E ENERGJISË

LLOJET E ENERGJISË

Burimet e energjisë ndahan në dy lloje:

- Të ripërtëritshme
- Të paripërtëritshme

Burimet e energjisë ndahan në dy lloje:



- Të ripërtëritshme
- Të paripërtëritshme

- Të ripërtëritshme

Mund të ripërtërihen shumë herë gjatë një jete njerëzore

- Të paripërtëritshme

Duan më shumë se një jetë njerëzore për t'u ripërtëritur

- Të ripërtëritshme
- Të paripërtëritshme

Mund të ripërtërihen
shumë herë gjatë
një jete njerëzore


Duan më shumë se
një jetë njerëzore për
t'u ripërtëritur

- Të ripërtëritshme:

Dielli, uji, era

- Të paripërtëritshme

Lëndët fosile të diegshme



Ne duhet t'i shfrytëzojmë me kujdes lëndët djegëse fosile.

Uji mund të ripërtërihet në ciklin e ujit në natyrë!

Ne duhet t'i shfrytëzojmë me kujdes lëndët djegëse fosile.



- *Uji mund të ripërtërihet në ciklin e ujit në natyrë!*

Ndotja nga lëndët djegëse fosile

- Nga djegia e qymyrit, naftës, benzinës etj. çlrohen gaze që ndotin ajrin.
- Keqpërdorimi i lëndëve djegëse fosile shkakton ndotjen e tokës dhe ujit

Ndotja nga lëndët djegëse fosile

- Nga diegia e qymyrit, naftës, benzinës etj. çlrohen gaze që ndotin ajrin.
- Keqpërdorimi i lëndëve djegëse fosile shkakton ndotjen e tokës dhe ujit

